

**LIGJ**  
**Nr.9817, datë 22.10.2007**

**PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj përcakton objektivat, masat dhe programimin e politikave bujqësore e të zhvillimit rural, të shërbimeve publike bujqësore, të kërkimit dhe trajnimit profesional, si dhe bazën e të dhënave dhe informacionin për politikën në sektorët e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Bujqësia” është veprimtaria ekonomike, e cila ka si objektiv prodhimin e ushqimit për njerëzit, të ushqimit për blegtorinë, të bimëve industriale dhe të karburanteve bio, si dhe të produkteve të tjera, nëpërmjet kultivimit sistematik të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve.
2. “Fermë” është njësia ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen të. Është një sipërfaqe toke apo veprimtari që kryesisht i kushtohet prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit ose prodhimit blegtoral.
3. “Produkt bujqësor” është një produkt bimor apo shtazor, i cili prodhohet në fermë, si dhe produktet që rrjedhin nga faza e parë e përpunimit të këtij produkti bimor apo shtazor.
4. “Produkt agroushqimor” është produkti bujqësor dhe produkte të tjera ushqimore të përpunuara.
5. “Politikat bujqësore” janë politika shtetërore, që përqendrohen në objektivat dhe masat, që veprojnë drejtpërsëdrejti në tregjet agroushqimore dhe të ardhurat nga ferma.

6. “Politikë e zhvillimit rural” është një politikë shtetërore, që përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, në konvergjencën e tyre ekonomike dhe sociale, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.

7. “Plani Kombëtar” është plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

8. “Plani i veprimit” është plani i veprimit të zbatimit të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

9. “Strategjia e bujqësisë dhe strategjia e zhvillimit rural” janë objektivat afatmesme të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, programimi, masat dhe mënyrat se si Qeveria planifikon mbështetjen financiare në një periudhë kohore të dhënë, në të mirë të bujqësisë dhe zonave rurale.

10. “Plan veprimi” është dokumenti i programimit, që përshkruan se si Qeveria do të zbatojë strategjitë në zona të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore.

11. “Masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural” janë instrumentet ligjore dhe financiare për arritjen e objektivave, në përputhje me dokumentet programuese.

12. “Zonat më pak të favorizuara” janë zona malore ose zona të tjera, ku pozicioni gjeografik dhe pengesat natyrore rezultojnë në koston e lartë të prodhimit.

13. “Bujqësi e qëndrueshme” është bujqësia, e cila, nga ana ekonomike dhe sociale, është e aftë të mbijetojë dhe që për një periudhë të gjatë nuk e degradon mjedisin. Koncepti i bujqësisë së qëndrueshme është i bazuar në parimin e shumëfunktionalitetit, duke nënkuptuar se bujqësia, krahas produkteve fitimprurëse (ekonomike), prodhon edhe të mira publike, që lidhen me mjedisin, sigurimin e ushqimit, sigurinë ushqimore dhe konvergjencën rajonale dhe sociale. Këto funksione të jashtme të bujqësisë nuk drejtohen drejtpërdrejt tek tregjet dhe, për këtë arsye, duhen mbështetur me masa gjithëpërfshirëse të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

14. “Shërbime publike në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural” janë politikat qeveritare për garantimin dhe ofrimin e shërbimit, nëpërmjet programeve qeveritare.

15. “Kooperativë” është një bashkim vullnetar personash, për të plotësuar nevoja dhe qëllime të përbashkëta ekonomike, përmes një biznesi të zotëruar bashkërisht. Ligjërisht kooperativa është person juridik.

16. “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

17. “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë.

### Neni 3

#### **Objektivat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural**

Me masat për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit të zonave rurale synohet të arrihen objektivat e përgjithshëm, si më poshtë:

a) rritja e të ardhurave për popullsinë rurale, duke rritur mirëqenien e saj, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë;

b) rritja e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrueshmërisë dhe të progresit teknik, si dhe garantimit të një përdorimi optimal të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të punës;

c) stabiliteti i tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor;

ç) cilësia dhe siguria ushqimore, duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë një cilësi të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve;

d) mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, duke garantuar që bujqësia të ruajë burimet natyrore;

dh) ulja e varfërisë, e cila synon zvogëlimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, si edhe të prapambetjes së zonave rurale, më pak të favorizuara, duke zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese, që gjenerojnë punësim, me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat, si dhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm.

KREU II  
PROGRAMIMI, ZBATIMI DHE FINANCIMI I POLITIKAVE BUJQËSORE DHE TË  
ZHVILLIMIT RURAL

Neni 4  
**Plani Kombëtar**

Plani Kombëtar përbëhet nga:

- a) strategjia e bujqësisë;
- b) strategjia e zhvillimit të zonave rurale.

Plani Kombëtar bazohet në objektivat afatmesëm të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, në masat, programet dhe veprimtaritë për realizimin e këtyre objektiveve, në vlerësimet efektive të mëpasshme, si dhe në fondet publike të nevojshme, të përdorura për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural.

Plani kombëtar hartohet nga ministria, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse për zhvillimin rural dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave për një periudhë 7-vjeçare.

Neni 5  
**Plani i veprimit**

Këshilli i Ministrave, në përputhje me Planin Kombëtar, miraton planin e veprimit dyvjeçar, për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Plani i veprimit përfshin një pjesë ose të tërë paketën e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Plani i veprimit përfshin:

- a) kushtet, kriteret dhe procedurat e paraqitjes e të zbatimit të masave, si dhe të çdo mase specifike të politikave bujqësore e të zhvillimit rural;
- b) planin financiar për zbatimin e masave dhe të çdo mase specifike të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural;
- c) mjetet dhe mënyrat e zbatimit dhe të kontrollit të politikave bujqësore e të zhvillimit rural;
- ç) procedurat e monitorimit dhe të vlerësimit të politikave bujqësore e të zhvillimit rural.

Neni 6  
**Programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural**

1. Krijohet programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural, më poshtë programi, i cili ka si qëllim të mbështesë zhvillimin e bujqësisë në vend, të garantojë, në mënyrë graduale, efektivitetin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, duke i kushtuar vëmendje nevojës së planifikimit të zbatimit të projekteve dhe të masave mbështetëse.

2. Burimet financiare të programit sigurohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) donatorët ndërkombëtarë, sipas marrëveshjeve përkatëse;
- c) buxheti i bashkisë/komunës;

Programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural është i përhershëm dhe administrohet nga ministria, nëpërmjet agjencisë së pagesave.

3. Kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten dhe masa e përfitimit nga fondi i programit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë dhe Ministrit të Financave.

## Neni 7

### **Përfituesit nga fondi i programit**

Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, që ndërmerren në kuadër të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, janë:

- a) fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë veprimtari bujqësore ose veprimtari ekonomike të lidhur me të;
- b) personat fizikë apo juridikë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë në industrinë agroushqimore;
- c) personat fizikë apo juridikë, të cilët ofrojnë shërbime për veprimtari bujqësore dhe veprimtari të tjera rurale.

## Neni 8

### **Aplikimet**

Aplikimet për të përfituar nga programi, nëpërmjet politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, mund të paraqiten nga një fermer, grup fermerësh dhe persona fizikë apo juridikë, siç parashikohet në këtë ligj.

## Neni 9

### **Dokumentet që duhen ruajtur**

Përfituesit që kanë marrë fonde nga programi, duhet të ruajnë të gjithë dokumentacionin për përfitimin e fondeve, për një periudhë 4-vjeçare, duke filluar nga data e livrimit të tyre.

## KREU III

### MASAT E POLITIKAVE BUJQËSORE

## Neni 10

### **Parimet e masave të politikave bujqësore**

Masat e politikave bujqësore duhet të harmonizohen dhe të zbatohen në përputhje me parimet e barazisë dhe të efikasitetit.

## Neni 11

### **Format e mbështetjes së brendshme**

Mbështetja e brendshme për produktet bujqësore dhe agroushqimore zbatohet nëpërmjet:

- a) masave për stabilizimin e tregjeve;
- b) pagesave të drejtpërdrejta.

## Neni 12

### **Masat për stabilizimin e tregjeve**

Masat për stabilizimin e tregjeve synojnë të mbështesin bujqësinë në kohën e kushteve tepër të paqëndrueshme të tregut. Forma dhe llojet e masave propozohen në Planin Kombëtar dhe zbatohen nëpërmjet planit të veprimit. Në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë, mund të zbatohen edhe masa të tjera, veç atyre të parashikuara në këtë ligj.

Neni 13  
**Pagesat e drejtpërdrejta**

1. Pagesat e drejtpërdrejta janë pagesa, që bëhen drejtpërsëdrejti nga Qeveria te prodhuesit, për të arritur objektivat e politikës, kryesisht, për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të mbështetur të ardhurat në fermë.

2. Kriteret e përfitimit, procedura dhe mënyra e administrimit të këtyre pagesave përcaktohen sipas pikës 3 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 14  
**Kriteret për mbështetjen e brendshme**

Masat e mbështetjes së brendshme të prodhimit bujqësor duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. Mbështetja nuk duhet të japë efektin e mbështetjes së çmimit për prodhuesit.
2. Mbështetja e dhënë për një produkt të specifikuar, gjatë vitit në fjalë, nuk duhet të kalojë masën 5 për qind të vlerës së përgjithshme të produktit në prodhimin e përgjithshëm bruto.
3. Mbështetja, e cila jepet për një produkt jo të specifikuar, gjatë vitit në fjalë, nuk duhet të kalojë masën 5 për qind të vlerës së përgjithshme të këtij produkti në prodhimin e përgjithshëm bruto.

KREU IV  
**MASAT E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT RURAL**

Neni 15  
**Objekti i masave**

1. Masat e politikës së zhvillimit rural mbështesin:
  - a) përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore në zonat rurale;
  - b) menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e mjedisit;
  - c) përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në këto zona;
  - ç) përmirësimin e qeverisjes dhe mobilizimin e potencialeve vendore zhvilluese të zonave rurale, si dhe ndërmarrjen e nismave vendore.
2. Masat propozohen nëpërmjet Planit Kombëtar dhe zbatohen nëpërmjet planit të veprimit.
3. Mënyra e zbatimit të këtyre masave dhe kriteret e mbështetjes përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 16  
**Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore**

Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore bazohet në masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve, që përmirësojnë situatën, në lidhje me:

- a) burimet njerëzore;
- b) menaxhimin e tokës;
- c) kapitalin fizik;
- ç) standardet e prodhimit, në lidhje me mjedisin, sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve;
- d) zinxhirin agroushqimor;

#### Neni 17

### **Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e mjedisit**

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e mjedisit bazohet në masa të ndryshme të pagesave të drejtpërdrejta, nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe përmirësojnë situatën, në lidhje me:

- a) kushtet më pak të favorizuara të prodhimit;
- b) ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit;
- c) ruajtjen e peizazhit.

#### Neni 18

### **Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale**

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale ndihmon në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike në zonat më të largëta rurale, që ndeshen me fenomenin e largimit të popullatës. Kjo mbështetje bazohet në masa të ndryshme investuese, nëpërmjet projekteve, të cilat fuqizojnë investimet në ekonominë e gjerë rurale dhe përmirësojnë situatën, në lidhje me:

- a) shumëllojshmërinë e ekonomive rurale në veprimtarinë bujqësore dhe jobujqësore, në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- b) përmirësimin e cilësisë së jetës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe ruajtjes së trashëgimisë rurale;
- c) trajnimet.

#### Neni 19

### **Mbështetja për ndërmarrjen e nismave vendore**

Mbështetja stimulon nismat, që përfshijnë fermerët, punonjësit e pyjeve dhe aktorët e tjerë ruralë, të cilët mund të ruajnë dhe të rrisin më tej trashëgiminë vendore, natyrore dhe kulturore, të rrisin ndërgjegjësimin mjedisor dhe të promovojnë produktet tipike, turizmin dhe burimet e rinovueshme të energjisë. Veprimet kryesore të mbështetjes në këto zona përfshijnë:

- a) krijimin e kapaciteteve vendore të partneritetit, gjallërimin dhe promovimin e aftësive të thitjes, të cilat mund të ndihmojnë në mobilizimin e potencialit vendor;
- b) promovimin e partneritetit publik-privat;
- c) promovimin e bashkëpunimit, nxitjen e aftësisë së sipërmarrjes dhe promovimin e përfshirjes e të shërbimeve vendore.

## KREU V

### **KUADRI INSTITUCIONAL PËR POLITIKAT BUJQËSORE DHE TË ZHVILLIMIT RURAL**

#### Neni 20

### **Komiteti Ndërministror për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural**

1. Komiteti Ndërministror për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural është një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 11 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

2. Komiteti Ndërministror për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, përveç detyrave që i caktohen në aktin e krijimit, jep mendim për vendimet më të rëndësishme, në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, veçanërisht:

- a) bën propozime për Planin Kombëtar;

- b) jep mendim për mënyrën e monitorimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar;
- c) bën propozime për aktet ligjore më të rëndësishme në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- ç) jep mendim për marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- d) jep mendim për vendime të tjera, shumë të rëndësishme, në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

#### Neni 21

### **Agjencia e pagesave**

1. Agjencia e pagesave krijohet si ent publik buxhetor, me statusin e personit juridik, publik, në varësi të ministrit.

2. Agjencia e pagesave ka për detyrë:

- a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural;
- b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
- c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
- ç) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
- d) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;
- dh) të zbatojë masat e kontrollit dhe të auditit të brendshëm;
- e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë dhe juridikë duhet t'i krijojnë mundësi kësaj agjencie për të kryer inspektimet e saj, duke i ofruar dhe vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin, të dhënat, shpjegimet dhe çdo gjë tjetër që kërkohet.

3. Organizimi, funksionimi, shtrirja territoriale, si dhe mënyra e rekrutimit të punonjësve të agjencisë së pagesave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Drejtori i agjencisë së pagesave emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

## KREU VI

### BAZAT E TË DHËNAVE DHE SISTEMET E INFORMACIONIT

#### Neni 22

### **Bazat e të dhënave**

1. Agjencia e pagesave krijon dhe mirëmban:

- a) regjistrin e fermave;
- b) regjistrin e prodhuesve dhe të përpunuesve të produkteve bujqësore ose ushqimore;
- c) regjistrin e aplikimeve për mbështetje financiare;
- ç) regjistrin e përdorimit dhe shfrytëzimit të tokës;
- d) regjistrin e blegtorisë;
- dh) regjistrin e tregtarëve të produkteve agrobujqësore dhe inputeve bujqësore;
- e) regjistrin e zonave më pak të favorizuara.

2. Krahas me bazën e të dhënave, siç përshkruhen në pikën 1 të këtij neni, agjencia e pagesave, nëse gjykohet e nevojshme, mund të mbajë edhe baza të tjera të dhënash.

3. Bazat e të dhënave, të cilave u referohet ligji, duhet të mbahen në formë elektronike.

4. Kushtet dhe mënyra e mbajtjes së tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 23

### **Marrja dhe përdorimi i bazave të tjera të të dhënave**

Për të ngritur dhe mbajtur bazën e të dhënave, agjencia e pagesave mund të përdorë edhe baza të tjera të dhënash, të cilat mbahen nga ente shtetërore të autorizuar, institucionet, agjenci publike, koncesionare dhe autoritete të tjera të autorizuar.

Administruesit e këtyre bazave të të dhënave, të hartave dhe fotove ortodixhitale, janë të detyruar t'ia japin, pa pagesë, çdo informacion të përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji, agjencisë së pagesave, por, nga ana tjetër, i ngarkojnë ministrinë shpenzimet e drejtpërdrejta të materialeve, kopjeve ekstra, si dhe për përpunimin e të dhënave.

#### Neni 24

### **Financimi i bazës së të dhënave**

Baza e të dhënave, që sigurohen dhe menaxhohen nga agjencia e pagesave, në përputhje me përcaktimin e bërë në këtë ligj, financohet nga Buxheti i Shtetit.

#### Neni 25

### **Vënia në dispozicion e të dhënave**

Të dhënat e krijuara, në përputhje me këtë ligj, janë publike, përveç të dhënave që vlerësohen të dhëna personale dhe përbëjnë sekret të biznesit.

Në këtë rast, të dhënat u vihen në dispozicion të tretëve, në përputhje me ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale.

#### Neni 26

### **Sistemi i informacionit për çmimet e tregut**

Sistemi i informacionit për çmimet e tregut përbëhet nga analizat dhe metodologjitë përkatëse, që lidhen me grumbullimin, zbatimin dhe publikimin e të dhënave për çmimet e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Sistemi i informacionit për çmimet e tregut krijohet dhe zbatohet nga ministria, sipas udhëzimit të ministrit.

#### Neni 27

### **Kontabiliteti në fermë**

1. Për miratimin dhe analizimin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, përfituesit nga fondi i programit duhet të mbajnë në mënyrë të detyrueshme kontabilitet.

2. Mbajtja e kontabilitetit bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Të dhënat e përfituara nga mbajtja e kontabilitetit në fermat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mund të përdoren në përputhje me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **KREU VII**

### **FORMAT E ORGANIZIMIT TË PRODHUESVE, TË PËRPUNUESVE DHE TREGTARËVE TË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE AGROUSHQIMORE**

#### Neni 28

### **Organizatave të prodhuesve, të përpunuesve dhe tregtarëve të produkteve bujqësore dhe agroushqimore**

Për të vënë në zbatim objektivat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, nxiten, përmes financimit, organizatat, shoqatat dhe kooperativat e prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.



## Neni 29

### **Kriteret për mbështetjen e organizatave, shoqatave dhe kooperativave**

Kriteret që duhet të përmbushin organizatat, shoqatat dhe kooperativat prodhuese e përpunuese të produkteve bujqësore dhe agroushqimore, për të përfituar mbështetje, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregullat dhe mënyrat e përfitimit të kësaj mbështetjeje përcaktohen me udhëzim të ministrit.

## KREU VIII

### **SHËRBIMET PUBLIKE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË ZHVILLIMIT RURAL**

## Neni 30

### **Objekti i shërbimeve publike**

Objektivi i shërbimeve publike në bujqësi dhe për zhvillimin rural, më poshtë shërbimet publike, është të mbështesin zbatimin e Planit Kombëtar, duke ofruar shërbime afatgjata e të përhershme në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, aty ku nismat private nuk mund të përmbushin nevojat publike.

Shërbimet publike në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural përfshijnë:

- a) shërbimin këshillimor në bujqësi dhe për zhvillimin rural;
- b) kërkimin bujqësor dhe kontrollin/analizat laboratorike;
- c) shërbimin racor në bujqësi e blegtori;
- ç) analizën e politikave bujqësore;
- d) shërbimet në infrastrukturën e tregut (marketingut).

## Neni 31

### **Detyrimet e një shërbimi publik**

Detyrimet e një shërbimi publik janë:

- a) realizimi i vazhdueshëm e pa ndërprerje i veprimtarisë së shërbimit të përcaktuar;
- b) realizimi i këtij shërbimi për çdo fermer, grup fermerësh, person fizik apo juridik, të angazhuar në veprimtarinë bujqësore në përputhje me këtë ligj;
- c) ofrimi i shërbimit me pagesë, me përjashtim të shërbimeve që janë në përputhje me një program të caktuar.

## Neni 32

### **Financimi i shërbimeve publike**

Shërbimet publike në bujqësi financohen nga:

- a) të ardhurat nga pagesat e plota ose të pjeshme të shërbimeve të ofruara;
- b) Buxheti i Shtetit.

## Neni 33

### **Programi i shërbimeve publike**

Programi i shërbimit publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural hartohet dhe miratohet nga ministria, në përputhje me Planin Kombëtar. Ky program duhet të përcaktojë:

- a) tipin dhe vëllimin e shërbimit publik që ofrohet;
- b) mënyrat, rrugët dhe dinamikën e realizimit të shërbimit publik, në zbatim të akteve ligjore;
- c) vëllimin dhe mjetet financiare ose bashkëfinancimin e shërbimit publik.

Neni 34

### **Monitorimi i shërbimit publik**

Monitorimi teknik dhe profesional për ofrimin e shërbimit publik realizohet nga ministria, e cila mund të autorizojë një organizatë ose persona të tjerë për realizimin e kontrollit teknik.

Monitorimi teknik dhe profesional, në rastin e autorizimit publik, realizohet nga personat, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për ushtrimin e kontrollit në një fushë të veçantë të shërbimit publik.

Kushtet që zbatohen dhe që kërkohen për kualifikimin profesional të kontrollorit përcaktohen nga ministri.

## **KREU IX**

### **MBËSHTETJA PËR KËRKIMIN, ARSIMIMIN DHE TRAJNIMIN**

Neni 35

### **Kërkimi bujqësor**

Në përputhje me Planin Kombëtar, ministri ushtron kompetencat, në bashkëpunim me ministrinë respektive, me institucionet e arsimit të lartë dhe me strukturat shkencore të tyre, në bashkëfinancimin e kërkimit dhe të projekteve zhvillimore në fushën e bujqësisë, të zhvillimit rural dhe të infrastrukturës përkatëse.

Neni 36

### **Arsimimi dhe trajnimi për nevojat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural**

1. Ministria duhet të propozojë dhe të ndërmarrë nisma për mënyra të ndryshme të arsimit dhe trajnimit për nevojat e bujqësisë, agroindustrisë dhe zonave rurale, në bashkëpunim me universitetet dhe shkollat e larta me drejtim bujqësor.

2. Ministria mund të bashkëfinancojë nisma për krijimin e stabilimenteve të zbatimit praktik të arsimit dhe të trajnimit për nevojat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

3. Përfitues të këtyre trajnimeve do të jenë fermerët, punonjësit dhe specialistët e bujqësisë dhe të agroindustrisë.

Neni 37

### **Studimet analitike dhe zhvillimore**

Ministria mbështet kryerjen e studimeve analitike dhe zhvillimore nga institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat shkencore të tyre, kryesisht për:

a) realizimin e analizave ekonomike dhe të tjera të impaktit në fushën e bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore;

b) realizimin e analizave dhe të veprimtarive planifikuese në fushën e bujqësisë dhe industrisë agroushqimore;

c) përmbushjen e përgjegjësive të rëndësishme për trajnimin dhe monitorimin e çështjeve zhvillimore në fushën e bujqësisë, të industrisë agroushqimore dhe të zhvillimit rural.

KREU X  
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 38

**Rastet e kundërvajtjeve administrative**

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative rastet e:

1. Mospërdorimit të fondeve të dhëna përfituesve, në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë dhënë.
2. Mosmbajtjes së dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë 4-vjeçare.

Neni 39

**Sanksionet**

1. Kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 38 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 30 000 - 40 000 lekë, si dhe kthimin e financimit të përfituar.

2. Kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 38 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 10 000 - 15 000 lekë.

Dënimet jepen nga inspektorët e agjencisë së pagesave.

Neni 40

**Ankimi**

1. Kundërvajtësi, brenda 10 ditëve nga vënia e gjobës, bën ankim në agjencinë e pagesave, e cila shqyrton ankimin dhe, brenda 5 ditëve, njofton subjektin ankues.

2. Kundër vendimit të titullarit të agjencisë së pagesave subjekti ankues mund të bëjë ankim, brenda 10 ditëve nga marrja njoftim, te ministri, i cili duhet të shprehet për lënien në fuqi të gjobës ose shfuqizimin e saj brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Kundër vendimit të ministrit, subjekti ankues mund t'i drejtohet, brenda 30 ditëve, gjykatës së rrethit gjyqësor.

Neni 41

**Vjelja e gjobave**

1. Gjodat për kundërvajtje administrative, sipas këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi në llogarinë e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, brenda 30 ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë.

2. Për çdo ditë vonesë, pas plotësimit të këtij afati dhe deri në një afat prej 30 ditësh, kundërvajtësi detyrohet të paguajë, përveç gjobës, edhe një shumë të barabartë me 2 për qind të gjobës.

Neni 42

**Të ardhurat nga vendosja e gjobave**

Të ardhurat e krijuara nga vendosja e gjobave kalojnë në masën 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU XI  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 43  
**Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 6 pika 3, 13 pika 2, 21 pika 3 dhe 29 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 3, 13 pika 2, 15 pika 3, 22 pika 4, 26, 29 e 34 të këtij ligji.

Neni 44  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5495, datë 31.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 416, datë 7.4.2011**

**PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR\***

*(Ndryshuar me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013, nr.105/2015, datë 1.10.2015,  
nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

*(I përditësuar, 2019)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbështetjen e prodhimit bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit. Ky ligj përcakton:

a) kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

i) të bimëve bujqësore, të cilat përfshijnë drithërat, foragjeret, patatet, panxharin, bimët e vajit e të fibrave, perimet, pemët drufrutore, hardhitë, humulusit, bimët eterovajore dhe medicinale të kultivuara;<sup>2\*\*</sup>

ii) të bimëve dekorative;

iii) të bimëve pyjore;

b) kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

c) kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

---

\* 32002L0054- Direktivë e Këshillit 2002/54/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së panxharit. OJ L 193, 20.7.2002, p. 12–32, Version i Konsoliduar 25.1.2005

32002L0053 - Direktivë e Këshillit 2002/53/EC, 13 qershor 2002 për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore. OJ L 193, 20.7.2002, p. 1–11, Version i Konsoliduar 18.4.2004.

32002L0055 - Direktivë e Këshillit 2002/55/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farave të perimeve. OJ L 193, 20.7.2002, p. 33–59, Version i Konsoliduar 4.7.2009

32002L0056 – Direktivë e Këshillit 2002/56/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së patates. OJ L 193, 20.7.2002, p. 60–73, Version i Konsoliduar 23.12.2008

31966L0401 - Direktivë e Këshillit 66/401/EEC, 14 qershor 1966 për tregtimin e farës së bimëve foragjere. OJ 125, 11.7.1966, p. 2298–2308, Version i Konsoliduar 4.7.2009

31966L0402 – Direktivë e Këshillit 66/402/EEC, 14 qershor 1966 për marketingun e farave të drithërave. OJ 125, 11.7.1966, Version i Konsoliduar 4.7.2009

31992L0090 – Direktivë e Këshillit 92/90/EEC, 3 nëntor 1992, vendosjen e detyrimeve ndaj të cilave prodhuesit dhe importuesit e bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera, janë objekt dhe rregullimin e detajeve për regjistrimin e tyre. OJ L 344, 26.11.1992, p. 38–39

- d) kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:
- iv) të bimëve bujqësore, të cilat përfshijnë drithërat, foragjeret, patatet, panxharin, bimët e vajit e të fibrave, perimet, pemët drufrutore, hardhitë, humulusit, bimët eterovajore dhe medicinale tëkultivuara;<sup>2\*\*</sup>
  - v) të bimëve dekorative;
  - vi) të bimëve pyjore;
- e) detyrimet e personave të angazhuar në prodhimin, përgatitjen për treg, tregtimin, importimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- f) kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe mënyrat për të garantuar standardet e tij;
- ç) rregullat për regjistrimin e varieteteve të bimëve në Katalogun Kombëtar, në vazhdim KK, mirëmbajtjen e tyre dhe për provën përkatëse të varieteteve të bimëve për t'u regjistruar në të;
- g) mënyrën e përdorimit, të këmbimit të të dhënave dhe marrëdhëniet e sistemit të prodhimit të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me sistemin e informacionit;
- dh) rregullat e veprimtarisë së shërbimit publik në fushën e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- h) rregullat për inspektimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

## Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të të gjitha bimëve, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të nenit 1 të këtij ligji, si dhe për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve të tjera, kur këto prodhohen ose tregtohen për t'u përdorur në prodhimin bujqësor.

2. Ky ligj nuk zbatohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që është importuar për qëllim eksporti, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

## Neni 3 Përkufizime

*(Ndryshuar pikat 6 dhe 7 me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013, shtuar pika 21/1 me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015; ndryshuar pika 11, shtuar pikat 11/1, 11/2 dhe 23 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Cilësi e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor” është identiteti, pastërtia, gjendja shëndetësore, fuqia mbirëse e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbjellje dhe riprodhim.

2. “Certifikim zyrtar” është një procedurë e përcaktuar, që kryhet nga ESHFF-ja, në bazë të kërkesës së paraqitur nga furnizuesi dhe konsiston në:

a) mbikëqyrjen e mbjelljeve ose të plantacioneve për fara dhe material mbjellës dhe shumëzues bimor, të ngastrave të tokës, të pajisjeve për prodhimin, ruajtjen dhe përgatitjen për treg të tyre;

31968L0193 Direktivë e Këshillit 68/193/EEC, 9 prill 1968 për tregtimin e materialit për shtimin vegetativ të hardhisë; OJ L 93, 17.4.1968, p. 15–23, Version i Konsoliduar 14.7.2005

31992L0033 - Direktivë e Këshillit 92/33/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegetativ dhe mbjellës të perimeve, të ndryshëm nga fara. OJ L 157, 10.6.1992, p. 1–9, Version i Konsoliduar 30.10.2007

31992L0034 – Direktivë e Këshillit 92/34/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegetativ të bimëve frutore dhe bimëve frutore të destinuara për prodhimin e frutave. OJ L 157, 10.6.1992, p. 10–18, Version i Konsoliduar 30.11.2007

31998L0056 – Direktivë e Këshillit 98/56/EC, 20 korrik 1998 për tregtimin e materialit të shtimit të bimëve zbukuruese. OJ L 226, 13.8.1998, p. 16–23, Version i Konsoliduar 10.7.2003.

b) kontrollin e evidencave dhe të regjistrave të mbajtur nga furnizuesi, në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

c) marrjen dhe analizimin zyrtar të mostrave.

3. “Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)” është organi që ngrihet dhe funksionon sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. “Farat e përziera” janë material mbjellës dhe shumëzues bimor, i përbërë nga dy ose më shumë specie bimore dhe/ose varietete.

5. “Furnizues” është çdo person, fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që kryen të paktën njëri nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) prodhim;

b) përgatitje për tregtim;

c) tregtim;

ç) import/eksport të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

6. “Inspektim” është çdo lloj kontrolli i kryer nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore të detyrueshme, sipas këtij ligji.

7. “Inspektor” është punonjësi i inspektoratit që mbulon fushën përkatëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, i ngarkuar për kontrollin e zbatimit të këtij ligji.

8. “Kategori të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor” janë nivele të ndryshme cilësie.

9. “Kategori të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor” janë:

a) “Farat bazë (për bimët e arave, si drithëra, perime, patate, foragjere etj.)” janë:

i) farat e prodhuara në përputhje me praktikën e pranuarë për ruajtjen e pastërtisë varietore dhe shëndetësore, të parashikuara për prodhimin e farave të kategorisë “Fara të certifikuar”;

ii) linjat inbreed për prodhimin e hibrideve dy e më shumë linjash;

b) “Material shumëzimi fillestar (për bimët drufrutore)” është materiali për shumim, i cili është prodhuar nën përgjegjësinë e kultivuesit nga bimë që kultivohen në përputhje me praktikën e pranuarë për ruajtjen e pastërtisë varietore dhe ku janë zbatuar masa parandaluese ndaj organizmave të dëmshëm të bimëve, i cili destinohet për prodhimin e materialit bazë të shumëzimit;

c) “Material shumëzimi bazë (për bimët drufrutore)” është materiali për shumim, i cili është prodhuar nën përgjegjësinë e kultivuesit nga bimë që kultivohen në përputhje me praktikën e pranuarë për ruajtjen e pastërtisë varietore dhe ku janë zbatuar masa parandaluese ndaj organizmave të dëmshëm të bimëve dhe i përfutur nga shumëzimi vegjetativ i materialit fillestar të shumëzimit, i cili destinohet për prodhimin e materialit të certifikuar;

ç) “Material i certifikuar (për bimët drufrutore)” është materiali që rrjedh nga shumëzimi direkti i materialit bazë të shumëzimit ose materialit fillestar, i destinuar për prodhimin e bimëve të reja (fidanëve) ose të pjesëve të bimëve të destinuarë për prodhimin e frutave, rrushit, ullinjve dhe agrumeve.

10. “Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar (KVVRRK)” është organ që ngrihet dhe funksionon sipas përcaktimeve të këtij ligji.

11. “Laborator reference” është laborator i akredituar, që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e analizave të kryera nga laboratorët e akredituar dhe jep vlerësimin përfundimtar të testeve të kryera nga këta laboratorë.

11/1. “Laborator i akredituar” është laborator që ka kaluar një procedurë akreditimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e akreditimit.

11/2. “Laborator i miratuar” është laborator testues, i miratuar nga ministri, për kryerjen e analizave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, sipas përcaktimeve të nenit 44 të këtij ligji.

12. “Lot” është një numër ose sasi material mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve, varieteteve ose kategorive të njëjta, të identifikueshme për origjinën dhe për homogjenitetin e tyre, lidhur me cilësinë dhe përbërjen.

13. “Material mbjellës dhe shumëzues bimor” janë farat, fidanët, e gjithë bima ose pjesë të saj, si tuberat, bulbat, rizomat, kalamat, sythat, nënshartesat, shartesat e të tjera, nëse janë përcaktuar për:

- a) shtim ose/dhe riprodhim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- b) mbjellje me qëllim prodhimin e bimëve.

14. “Ministër” është ministri përgjegjës për bujqësinë.

15. “Organizëm i Modifikuar Gjenetiki (OMGJ)” është çdo organizëm i gjallë bimor, që zotëron një ndërthurje të re të materialit gjenetik, që përftohet nëpërmjet përdorimit të bioteknologjisë moderne.

16. “Përgatitja e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për treg” janë procedurat, të cilave u nënshtrohet materiali mbjellës dhe shumëzues bimor për t’u përgatitur për treg.

17. “Prodhim i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor” është sigurimi i materialit mbjellës, shumëzimi me anë të mënyrave të ndryshme të shumimit, që për specie të veçanta janë të ndryshme.

18. “Testim” janë provat krahasuese, që kryhen në dy a më shumë zona, për të vërtetuar aftësitë prodhuese dhe cilësore të një varieteti.

19. “Tregtim i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor” është importimi, eksportimi dhe tregtimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kur këto nuk janë përmendur veçmas, në nene të caktuara të këtij ligji.

20. “Organizata Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve (UPOV)” është organizmi ndërkombëtar, me qendër në Gjenevë, i ngritur sipas përcaktimeve të Konventës për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve.

21. “Varietet” është një grup bimor, brenda një taksoni të vetëm botanik, të nivelit më të ulët të klasifikimit, që mund të jetë: a) i përcaktuar nga shprehja e karakteristikave që rezultojnë nga një gjenotip i dhënë ose kombinim gjenotipesh;

b) i dallueshëm nga një grupim tjetër bimor nga shprehja e të paktën njëres nga karakteristikat e sipërpërmendura;

c) i konsideruar si një grupim, me qëllim përshtatshmërinë e tij për t’u shumuar i pandryshuar.

21/1. “Hibrid” është materiali mbjellës dhe shumëzues bimor, që përftohet nga kryqëzimi i dy prindërve, brenda ciklit bimor. Nga mbjellja e këtyre farave dalin bimët e breznisë së parë hibride ose F1 (Breznia e parë).

22. “Vendndodhja e veprimtarisë së furnizuesit” është një njësi ekonomike e plotë, përfshirë fushat, objektet, makineritë dhe pajisjet ku kryhen veprimtaritë e furnizuesit. 23. “Analiza zyrtare” janë ato analiza që kërkohen nga institucionet e administratës shtetërore, në përmbushje të funksioneve të tyre.

23. “Analiza zyrtare” janë ato analiza që kërkohen nga institucionet e administratës shtetërore, në përmbushje të funksioneve të tyre.

## KREU II KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR

### Neni 4

#### **Kërkesat për tregtim**

*(shfuqizuar pika 8 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i specieve të veçanta të bimëve, të përcaktuara sipas këtij ligji, tregtohet nëse plotëson kërkesat për cilësitë e kategorive të përcaktuara të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Kur kategoria për disa specie bimësh është e papërcaktuar, ato tregtohen pasi plotësojnë kërkesat e cilësisë, për kategoritë e papërcaktuara.



3. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i disa specieve të caktuara duhet të plotësojë kërkesat e gjendjes shëndetësore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

4. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor tregtohet në lote, paketohet dhe etiketohet sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.

5. Kur materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është ose përmban OMGJ, duhet të plotësojë edhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për OMGJ-të, si dhe të jetë shënuar si OMGJ. Në etiketën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor shënohet nëse ai ka të modifikuar gjenetikisht edhe vetëm njërin nga komponentët.

6. Kur materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është i trajtuar me plehrat e përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve, këto përshkruhen sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

7. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i një specieje të përcaktuar tregtohet nëse:

- a) varieteti është i regjistruar në KK;
- b) është prodhuar nën mbikëqyrjen e ESHFF-së;
- c) janë verifikuar për certifikimin kërkesat e pikave 1 dhe 3 të këtij neni;
- ç) janë verifikuar treguesit cilësorë specifikë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të tij;
- d) është vërtetuar gjendja shëndetësore me certifikatë fitosanitare.

8. Shfuqizuar.

9. Kriteret për kategorinë, identitetin, cilësinë, paketimin dhe etiketimin për specie të veçanta dhe grup specimesh të bimëve, sipas këtij ligji, përcaktohen me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, ndërsa për bimët pyjore dhe dekorative me propozim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për bimët pyjore dhe dekorative.

10. Kriteret dhe rregullat e përpunimit, të ambalazhimit, të ruajtjes, të etiketimit dhe të përmbajtjes së etiketës për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të prodhuar brenda vendit për tregtim të brendshëm, përveç sa përcaktohet në pikën 9 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit, ndërsa për bimët pyjore dhe dekorative, me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për bimët pyjore dhe dekorative.

#### Neni 5

### **Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i certifikuar jo përfundimisht**

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i përcaktuar për tregtim, sipas këtij ligji, mund t'u shpërndahet furnizuesve të tjerë si "i certifikuar jo përfundimisht" dhe të tregtohet si i tillë me kusht që:

- a) të jetë i prodhuar nën mbikëqyrjen e ESHFF-së;
- b) të plotësojë kërkesat e përcaktuara për identitetin, pastërtinë varietore dhe gjendjen shëndetësore;
- c) të jetë i etiketuar në mënyrën e përcaktuar.

2. Kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, "i certifikuar jo përfundimisht" dhe për etiketimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

#### Neni 6

### **Kërkesat dhe përjashtimet për një varietet**

1. Speciet e bimëve, varieteti i ri i të cilave duhet të regjistrohet në KK, përcaktohen me urdhër të ministrit.

2. Me kërkesë të furnizuesit, ESHFF-ja mund të lejojë tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që është në proces pranimi për regjistrim në KK.

3. Sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në proces pranimi dhe forma e përmbajtja e kërkesës që paraqet furnizuesi përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 7

### **Kërkesa të veçanta për tregtimin**

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor për prodhim organik tregtohet nëse:
  - a) përputhet me kërkesat e veçanta në lidhje me tregtimin, të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për produktet organike;
  - b) është i etiketuar dhe i certifikuar në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.
2. Kërkesat e veçanta për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për prodhim organik, të pakeluar në pako të vogla, dhe për tregtimin e varieteteve të ruajtura në veçanti përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

#### Neni 8

### **Farat e përziera**

1. Farat mund të tregtohen edhe si “fara të përziera”, me kusht që:
  - a) secili përbërës i farës së përzier të plotësojë kërkesat për tregtim ose përjashtimet e përcaktuara në këtë ligj;
  - b) të plotësohen kërkesat ligjore për tregtimin e farave të përziera;
  - c) të jenë të paketuara dhe të etiketuara në mënyrën e përcaktuar.
2. Kërkesat për tregtimin, mënyrën e paketimit dhe të etiketimit të farave të përziera përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 9

### **Mbajtja e të dhënave për farat e përziera**

1. Regjistrimi i një fare të përzier në regjistrin e farave të përziera bëhet nga ESHFF-ja, sipas një kërkesë të paraqitur nga furnizuesi i interesuar.
2. Forma, përmbajtja e kërkesës, kushtet për përbërjen e farave të përziera, të destinuara për prodhim foragjer, dhe mënyra e regjistrimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 10

### **Përjashtimet për tregtimin**

1. Nuk konsiderohen si produkt për tregtim:
  - a) mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për kontrolle zyrtare/mbikëqyrëse;
  - b) mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për qëllime shkencore, për punë seleksionuese varietore ose për ruajtjen e materialit gjenetik;
  - c) materiali mbjellës dhe shumëzues bimor te persona që përgatisin për treg material mbjellës shumëzues bimor në emër dhe për llogari të furnizuesve të përcaktuar;
  - ç) materiali mbjellës dhe shumëzues bimor te persona që prodhojnë specie të caktuara të bimëve bujqësore në emër dhe për llogari të një furnizuesi, të destinuara për përpunim industrial.
2. Mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, duhet të kenë të shënuar në etiketë, në mënyrë të veçantë dhe të dukshme, qëllimin e përcaktuar të përdorimit.
3. Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, ESHFF-ja lejon paraprakisht tregtimin në bazë të kërkesës së furnizuesit dhe nëse nga verifikimi i kryer rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i shërben këtij qëllimi.
4. Sasitë maksimale të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, që nuk tregtohen, mënyra e etiketimit të mostrave dhe kushtet për autorizimin përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU III  
KËRKESAT PËR PRODHIMIN E MATERIALIT MBJELLËS  
DHE SHUMËZUES BIMOR

Neni 11

**Detyrimet e furnizuesit**

*(ndryshuar pika 1 dhe fjalia e parë e pikës 5 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. Furnizuesi, në cilësinë e prodhuesit, kryen veprimtarinë e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. Furnizuesi, për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) harton planin dhe teknologjitë e prodhimit për çdo specie dhe varietet, përfshirë verifikimin e cilësisë, që lejon prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në përputhje me kërkesat e këtij neni;

b) njofton menjëherë strukturën që kryen inspektimin, pranë AKU-së, për çdo dukuri të shfaqur apo dukuri të dyshimtë, për organizmat e dëmshëm karantinorë në parcelat e prodhimit, të cilët duhet të raportohen sipas ligjislacionit në fuqi për mbrojtjen e bimëve;

c) garanton që çdo lot i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të jetë i kontrollueshëm, i disponueshëm dhe i identifikueshëm në të gjitha fazat e prodhimit, të përgatitjes për treg, të ruajtjes dhe të shitjes;

ç) mban të dhëna dhe ruan evidencat për mirëmbajtjen e një varieteti për sigurimin ose blerjen e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të përdorur për shumim ose riprodhim;

d) mban të dhëna dhe ruan evidencat e prodhimit, furnizimit ose importit për përgatitjen për treg, stoqet dhe shitjet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

dh) lejon verifikimin zyrtar dhe marrjen e mostrave;

e) zbaton masat e përcaktuara dhe të lëna nga verifikimet zyrtare ose/dhe mbikëqyrëse;

ë) përmbush detyrimet e tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

3. Furnizuesi mban të gjitha evidencat dhe të dhënat, sipas pikës 2 të këtij neni, për të paktën 3 vjet, ndërsa për materialin mbjellës dhe shumëzues të pemëve frutore, pyjore, dekorative dhe kacavjerrëse, për të paktën 5 vjet.

4. Furnizuesi mban një listë të varieteteve të drurëve frutorë ose të bimëve dekorative, sipas një forme të përcaktuar, kur ato nuk janë të regjistruara në KK, por është depozituar kërkesa për pranimin e tyre në KK, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e varieteteve të bimëve. Secili varietet pajiset me përshkrimin përkatës varietor.

5. Prodhimi i kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga furnizues publikë të autorizuar nga ministri ose privatë, që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, prodhimin e kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor. Kriteret e prodhimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

6. Furnizuesi mund të prodhojë, por jo të tregtojë, material mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti, i cili nuk është regjistruar në KK, në qoftë se kërkesa për regjistrim është depozituar dhe regjistrimi është në proces.

7. Furnizuesi mund të prodhojë material mbjellës dhe shumëzues bimor të paregjistruar në KK nëse destinacioni i tyre është përdorimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të ndaluar në këtë ligj.

8. Forma dhe përmbajtja e të dhënave, që mban dhe zbaton prodhuesi, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

## Neni 12

### **Deklarimi i prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor**

1. Furnizuesi, që prodhon material mbjellës dhe shumëzues bimor, është i detyruar të njoftojë, me shkrim, çdo vit ESHFF-në për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.
2. Krahas njoftimit për deklarimin e prodhimit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, që do të nxjerrë në treg, furnizuesi përgatit etiketën e furnizuesit dhe dorëzon deklaratën e konformitetit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me kërkesat për tregtim ose përjashtimet, sipas këtij ligji.
3. Etiketa dhe deklarata e konformitetit plotësohen në përputhje me të dhënat e furnizuesit të regjistruara në regjistrin e tij.
4. Forma, përmbajtja, afati dhe mënyra e kërkesës së furnizuesit për deklarimin e prodhimit, si dhe forma e përmbajtja e etiketës dhe deklaratës së konformitetit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

## Neni 13

### **Inspektimi i furnizuesve**

*(Ndryshuar pikat 1, 4 dhe ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013)*

1. Inspektimi i subjekteve përkatëse, sipas këtij ligji, bëhet jo më pak se 2 herë në vit nga inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Nëse nga kontrolli rezulton se furnizuesi nuk ka plotësuar detyrimet e përcaktuara, inspektori urdhëron plotësimin e tyre brenda një afati kohor, por jo më shumë se 15 ditë.
2. Inspektori kontrollon plotësimin e kërkesave për tregtim, ose merr mostra dhe i dërgon për analiza laboratorike.
3. Kur nga inspektimi i kryer ose nga analizat e mostrave të marra rezulton se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor nuk plotëson kërkesat e përcaktuara, furnizuesit i ndalohet nxjerrja në treg e këtij materiali mbjellës dhe shumëzues bimor.
4. Procedura e inspektimit zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
5. Të gjitha shpenzimet për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektori dhe për kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga furnizuesi.
6. Mënyra e mbajtjes së të dhënave, metoda e marrjes së mostrave, analizat laboratorike që kryhen përcaktohen me udhëzim të ministrit.

## KREU IV

### **CERTIFIKIMI ZYRTAR I MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR**

## Neni 14

### **Autoriteti certifikues**

1. ESHFF-ja është organi përgjegjës për kryerjen e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.
2. Procedurat e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të prodhuar në vend, realizohen nga ESHFF-ja ose subjekte publike apo private, sipas përcaktimit të bërë në kreun IX të këtij ligji.
3. Procedurat dhe kriteret e kryerjes së certifikimit për specie të veçanta ose grup specimesh përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

## Neni 15

### **Kërkesa për certifikim zyrtar**

1. Furnizuesi njofton çdo vit organin e certifikimit, në një afat kohor të përcaktuar, për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve të përcaktuara sipas këtij ligji, me anë të kërkesës, së cilës i bashkëlidhet dokumentacioni që vërteton të dhënat për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të përdorur për mbjellje.

2. Furnizuesi paraqet kërkesën me kusht që:

a) në vetëdeklarimin, sipas legjislacionit për licencat, të ketë përcaktuar speciet për të cilat ai ka paraqitur kërkesë për certifikim;

b) varieteti të jetë i regjistruar në KK ose furnizuesit t'i jetë lëshuar një vërtetim për depozitimin e kërkesës për regjistrimin e varietetit.

3. Forma, përmbajtja, afatet kohore dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës për certifikim zyrtar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

## Neni 16

### **Procedurat e certifikimit zyrtar**

1. Procedura për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor ka të bëjë:

a) me kontrollin zyrtar dhe aprovimin e parcelave të prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për zbatimin e kushteve teknike të përcaktuara;

b) me kontrollin zyrtar të makinerive e të pajisjeve për prodhimin dhe përgatitjen për treg;

c) me kontrollin e të dhënave të mbajtura nga furnizuesi për mirëmbajtjen e një varieteti, për sigurimin ose blerjen e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, prodhimin, furnizimin ose importin, përgatitjen për treg, stoqet dhe shitjet;

ç) me marrjen e mostrave zyrtare dhe analizimin e tyre vetëm nga ESHFF-ja për të provuar nëse materiali mbjellës dhe shumëzues bimor plotëson kërkesat për tregtimin dhe certifikimin jopërfundimtar.

2. Shpenzimet për realizimin e procedurave për certifikimin zyrtar, për lëshimin e etiketave dhe etiketimin zyrtar përballohen nga furnizuesi.

3. Tarifat për certifikimin zyrtar, për etiketat dhe etiketimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe të ministrit përgjegjës për financat.

4. Procedura të tjera për certifikimin zyrtar, përmbajtja, ngjyra dhe forma e etiketës zyrtare, përmbajtja dhe forma e certifikatës zyrtare, certifikatës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor jo përfundimisht të certifikuar dhe mënyra e njoftimit të drejtuesit të ESHFF-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

## Neni 17

### **Certifikimi zyrtar i farave të përziara**

1. Certifikimi zyrtar i farave të përziara kryhet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj, me kusht që përzierja e farave të bëhet në përputhje me kërkesat për farat e përziara të përcaktuara në këtë ligj.

2. Furnizuesi paraqet kërkesën pranë ESHFF-së.

3. Në rastin e farave të përziara, të destinuara për prodhimin e foragjereve, furnizuesi paraqet kërkesën vetëm nëse kjo përzierje farash është e regjistruar në regjistrin e farave të përziara.

4. Forma, përmbajtja, afatet kohore dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës për certifikimin zyrtar të farave të përziara, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

## Neni 18

### **Procedurat për certifikimin zyrtar të farave të përziera**

1. Procedurat për certifikimin zyrtar të farave të përziera, përmbajtja, ngjyra dhe forma e etiketës zyrtare, përmbajtja dhe forma e certifikatës zyrtare, mënyra e njoftimit të drejtuesit të ESHFF-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Shpenzimet e procedurës për certifikimin zyrtar të farave të përziera, për lëshimin e etiketave dhe etiketimin zyrtar paguhen nga furnizuesi.

3. Tarifat për certifikimin zyrtar, për etiketat dhe etiketimin zyrtar të farave të përziera përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

## Neni 19

### **Raste të veçanta dhe përjashtime për certifikimin zyrtar**

1. Kryerja e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varietetet e të cilit nuk janë përfshirë në KK, mund të lejohet nga drejtuesi i ESHFF-së pas paraqitjes nga furnizuesitë kërkesës për certifikim dhe të dokumentacionit që vërteton të dhënat për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të përdorur për mbjellje.

2. Furnizuesit i lëshohet një autorizim nga drejtuesi i ESHFF-së:

a) nëse varieteti është në proces pranimi në KK;

b) kur furnizuesi vërteton me dokumente se materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është prodhuar për eksport.

3. ESHFF-ja, në cilësinë e autoritetit certifikues, zbaton procedurën për certifikim zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të përcaktuar në këtë ligj.

4. Nuk i nënshtrohen procedurës për certifikim zyrtar dhe nuk certifikohet materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i prodhuar për vetëfurnizim.

5. Forma e kërkesës, e autorizimit, si dhe forma, madhësia, ngjyra e përmbajtja e etiketës zyrtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

## Neni 20

### **Etiketimi nga furnizuesi**

1. Pavarësisht nga përcaktimet për procedurën për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe të farave të përziera, ESHFF-ja mund të lejojë furnizuesin që, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve të caktuara të bimëve, të zbatojë vetë etiketimin me etiketa zyrtare, me kusht që mbikëqyrja e etiketimit të jetë kryer nga ESHFF-ja, në cilësinë e autoritetit certifikues.

2. Mënyra e zbatimit të mbikëqyrjes së etiketimit zyrtar, të kryer nga vetë furnizuesi, përcaktohet me udhëzim të ministrit.

## Neni 21

### **Riambalazhimi dhe rietiketimi**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013)*

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor, i certifikuar dhe i etiketuar zyrtarisht, me kërkesë të furnizuesit, mund të riambalazhohet dhe të rietiketohet zyrtarisht, kur shikohet e nevojshme nga inspektori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Sipas kërkesës së furnizuesit, etiketat e reja zyrtare lëshohen nga ESHFF-ja dhe etiketimi mund të zbatohet prej këtij enti, me kusht që materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të vazhdojë të plotësojë kushtet për certifikim zyrtar.

2. Shpenzimet për etiketat dhe etiketimin zyrtar përballohen nga furnizuesi.

3. Tarifat për etiketat dhe rietiketimin zyrtar përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 22

### **Të dhënat për prodhimin**

1. ESHFF-ja krijon dhe mban regjistrin për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për vitin në vazhdim. Regjistri përfshin të dhëna për furnizuesin, vendet e prodhimit dhe sipërfaqet e regjistruara për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe sasi të e prodhuara e të certifikuara.

2. ESHFF-ja mban të dhëna për:

- a) materialin mbjellës e shumëzues bimor të bimëve të arave, deri në 3 vjet;
- b) materialin mbjellës e shumëzues bimor të bimëve drufrutore, të bimëve dekorative, të bimëve eterovajore e medicinale të kultivuara dhe sumullbarin (humulusin), deri në 10 vjet.

KREU V

### **IMPORTI I MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR**

Neni 23

#### **Kushtet për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor**

*(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet vetëm nga subjekte, të cilat janë të regjistruara në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24

#### **Procedura e importit**

*(Shfuqizuar pika 1 me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. Shfuqizuar;

2. Inspektimi i ngarkesës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në pikën hyrëse të kalimit kufitar e doganor të Republikës së Shqipërisë, kryhet sipas kërkesave të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi është i regjistruar në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

4. Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, lidhur me plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj, kryhet në magazinat e furnizuesit ose në treg. Për këtë inspektori merr mostrat përkatëse, të cilat i dërgon për analiza laboratorike.

5. Tarifa e marrjes së mostrave dhe e kryesjes së analizave laboratorike përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 25

#### **Përfundime**

1. Inspektori nuk merr mostra për analiza laboratorike, nëse importimi bëhet për rastet e mëposhtme:

- a) për mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të përcaktuara për testim zyrtar, që ruhen në bankën gjenetike për përzgjedhje varietore, për qëllime kërkimore-shkencore ose ekspozimi, me kusht që sasi të tyre të mos kalojnë sasi të përcaktuara në përputhje me pikën 4 të nenit 10 të këtij ligji;

b) për sasi të caktuara të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në paketime origjinale, të destinuara për përdorim vetjak.

2. Sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në paketime origjinale, që mund të importohet për përdorim vetjak, përcaktohet me udhëzim të ministrit.

#### Neni 26

### **Autorizime importi të veçanta**

1. Importi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose/dhe i varieteteve të peregjistruara në KK kryhet me autorizim të veçantë, të lëshuar nga ESHFF-ja, sipas urdhrorit të ministrit, për këtë qëllim.

2. Rastet për autorizimin e importimit të veçantë të materialit të mbjellës dhe shumëzues bimor janë kur ai nevojitet për:

a) përgatitjen për treg dhe certifikim zyrtar, në përputhje me këtë ligj, kur është prodhuar dhe certifikuar jo përfundimisht në një vend tjetër jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nën kontrollin zyrtar, dhe kur ekuivalenca është e njohur;

b) përballimin e nevojave emergjente;

c) riprodhim në Republikën e Shqipërisë, për qëllime eksporti, gjë e cila vërtetohet nga importuesi, duke paraqitur një kopje të kontratës origjinale me furnizuesin apo përdoruesin e një vendi tjetër;

ç) një varietet, i cili është në procedurë pranimi në KK dhe sasia e të cilit nuk e tejkalon sasinë e caktuar sipas nenit 6 të këtij ligji.

3. Furnizuesi, për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht ose të varieteteve të peregjistruara në KK, sipas pikës 1 të këtij neni, paraqet kërkesë në ESHFF.

4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të certifikuar jo përfundimisht ose të peregjistruar në KK, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 27

### **Detyrimet e furnizuesit për importin**

*(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1 me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015)*

1. Përveç detyrimeve të përcaktuara për prodhimin, para nxjerrjes në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, furnizuesi duhet që, krahas etiketave shoqëruese në ambalazh, në gjuhë të huaj, të vendosë etiketë shtesë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i importuar shoqërohet me dokumente në gjuhën shqipe ose angleze.

2. Furnizuesi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti të peregjistruar në KK, për riprodhim për qëllime eksporti, paraqet tek ESHFF-ja kontratën, si provë të eksportit.

#### Neni 28

### **Rietiketimi zyrtar i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor**

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i importuar, që plotëson kërkesat e përcaktuara në pikat 7 e 9 të nenit 4 të këtij ligji, mund të riambalazhohet ose/dhe të rietiketohe me etiketa zyrtare, të lëshuara nga ESHFF-ja me kërkesën e furnizuesit. ESHFF-ja lëshon etiketat zyrtare për rietiketim vetëm pasi të verifikojë nëse materiali mbjellës dhe shumëzues bimor plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj për certifikimin zyrtar.

2. Shpenzimet për etiketat dhe për etiketimin zyrtar përballohen nga furnizuesi.

3. Tarifat për etiketat zyrtare dhe për etiketimin zyrtar përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.



**KREU VI**  
**PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË VARIETETEVE**  
**NË KATALOGUN KOMBËTAR**

**Neni 29**

**Katalogu Kombëtar**

*(ndryshuar shkronja "a" e pikës 4 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. KK-ja është lista zyrtare e varieteteve të specieve të bimëve, të përcaktuara në shkronjën "a" të nenit 1 të këtij ligji, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i të cilave prodhohet, përgatitet për treg, importohet dhe tregtohet në Republikën e Shqipërisë.

2. Procedura për përfshirjen e një varieteti në KK drejtohet nga ESHFF-ja, e cila shqyrton të gjitha kërkesat për pranim, të cilat i boton në buletin e saj zyrtar.

3. Forma, përmbajtja dhe afati i botimit të KK-së përcaktohen me urdhër të ministrit.

4. Kërkesa për regjistrim në KK paraqitet nga aplikuesi kur ai është:

a) person fizik ose juridik, që ka të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie prodhimin/importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

b) seleksioner ose person përgjegjës për mirëmbajtjen e varieteteve.

**Neni 30**

**Kërkesa për regjistrimin e një varieteti në Katalogun Kombëtar**

1. Procedura për regjistrimin e një varieteti në KK fillon me paraqitjen nga aplikuesi të një kërkesë, me shkrim, në ESHFF.

2. Nëse kërkesa bëhet për regjistrimin e një varieteti të një fare bari, që nuk ka destinacion prodhimin foragjer, ose për një varietet të përcaktuar për përdorim vetëm si komponent gjenetik për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve apo i një varieteti, i cili është OMGJ, aplikuesi duhet ta deklarojë qartësisht këtë në kërkesë.

3. Të dhënat e kërkuara nga aplikuesi për origjinën e varietetit trajtohen si konfidenciale.

4. Përmbajtja e kërkesës dhe procedura e regjistrimit të një varieteti në KK përcaktohen me udhëzim të ministrit.

**Neni 31**

**Kushtet për regjistrimin e varietetit në Katalogun Kombëtar**

*(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015)*

1. ESHFF-ja miraton regjistrimin e një varieteti në KK nëse:

a) vërtetohet se është miratuar si varietet i ri dhe është caktuar personi përgjegjës për ruajtjen e tij;

b) vërtetohet e drejta për përdorimin e këtij varieteti;

c) plotëson standardet e pranueshme për kultivim dhe përdorim, të miratuara me vendim të KVVRKK-së.

2. ESHFF-ja regjistron në KK një varietet që është OMGJ vetëm nëse plotëson kushtet e specifikuar në pikën 1 të këtij neni, dhe nëse pranimi ose mbajtja e një varieteti të tillë nuk bie në kundërshtim me legjislacionin përkatës për OMGJ-të.

3. Pavarësisht nga përcaktimi i bërë në pikën 1, të këtij neni, vlera e pranueshme për kultivimin dhe përdorimin nuk kërkohet në rastet e hibrideve:

a) të perimeve, me përjashtim të varieteteve;

b) të farave të barit, nëse nuk kanë qëllim prodhimin e foragjereve;

c) të paracaktuara për t'u përdorur vetëm si komponent prindëror për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të ri.

4. Në rastin e farave të barit, që nuk kanë për qëllim prodhimin e foragjereve, ESHFF-ja mund të kontrollojë përshtatjen e varietetit në lidhje me destinacionin e specifikuar në kërkesë nga aplikuesi.

Neni 32

### **Vlerat e kultivimit dhe të përdorimit të një varieteti**

1. Vlera për kultivim dhe përdorim e një varieteti të paraqitur për regjistrim në KK konsiderohet e përshtatshme nëse, krahasuar në provat e kryera për vlerat e kultivimit e të përdorimit me varietete të tjera, të regjistruara në KK, ofron një përmirësim të qartë të treguesve sasiorë dhe cilësorë të prodhimit.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i bërë në pikën 1 të këtij neni, vlerat e varietetit të paraqitur për regjistrim në KK konsiderohen të përshtatshme për kultivim e përdorim, edhe nëse karakteristikat të veçanta individuale të tij janë inferiore krahasuar me ato të varieteteve të kontrollit, me kusht që në tërësinë e tyre karakteristikat e tij të mbizotërojnë ato të varieteteve të kontrollit.

Neni 33

### **Testimi i varietetit**

*(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015)*

1. Për t'u regjistruar në KK varieteti kalon në provat zyrtare për vlerat e kultivimit dhe duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara për vlerat e kultivimit dhe të përdorimit të një varieteti. Sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të përcaktuar për provat zyrtare të varietetit sigurohet nga aplikanti.

2. Në qoftë se aplikanti deklaron në kërkesë se varieteti është testuar për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet dhe është miratuar si varietet i ri në Republikën e Shqipërisë ose në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian a në një nga shtetet nënshkruese të konventës së UPOV-it, ekzaminimi mundet të mos kryhet me kusht që furnizuesi për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që importon të paraqesë në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dokumentacion zyrtar nga shteti importues, nëpërmjet të cilit vërtetohen karakteristikat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor (Skedën), dhe provën e kryer për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS). Sipas nevojës, ESHFF-ja mund të kërkojë nga subjektet homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose në shtetet nënshkruese të konventës së UPOV-it testet dhe rezultatet për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet për varietetet e paraqitura në kërkesë, për regjistrim në KK.

3. Për varietete, të cilat janë OMGJ, testimi duhet të kryhet sipas procedurës, në përshtatje me këtë ligj dhe me legjislacionin përkatës për OMGJ-të.

4. Testimi i një varieteti mund të kryhet nga ESHFF-ja ose subjekte publike a private, sipas përcaktimit të bërë në kreun IX të këtij ligji.

5. Shpenzimet për testimin e varietetit mbulohen nga aplikanti.

6. Procedura dhe metoda e testimit të varieteteve, sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

7. Tarifat për testimin e varietetit për regjistrim në KK përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 34

### **Emri i varietetit**

1. Në qoftë se varieteti është i regjistruar në KK-në e një shteti anëtar të Bashkimit Europian ose të një shteti nënshkrues të konventës së UPOV-it, pranimi në KK-në e Republikës së Shqipërisë bëhet me emrin e regjistruar në katalogjet e sipërpërmendura, përjashtuar rastet kur emri i varietetit bie në kundërshtim me rregulloret për tiparet dalluese dhe përcaktimin e origjinës dhe, në këtë rast, lind nevoja e përshtatjes së emrit.

2. Në qoftë se përshtatja e emrit është e domosdoshme dhe e justifikueshme, ESHFF-ja thërret aplikantin që të propozojë një emër të ri për varietetin, jo më vonë se 60 ditë nga data e aplikimit.

3. Kërkesat për përshtatjen e emrit të varietetit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 35

### **Regjistrimi i varietetit në Katalogun Kombëtar**

1. Nëse varieteti plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj për regjistrimin në KK, me propozim të KVVRKK-së, ESHFF-ja merr vendim për regjistrimin e varietetit në KK. Vendimi është i formës së prerë dhe botohet në buletin zyrtar të tij.

2. Kostoja financiare e krijuar për regjistrimin e varietetit përballohet nga furnizuesi.

3. Procedura dhe afatet e regjistrimit të varieteteve në KK përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 36

### **Çregjistrimi i varietetit nga Katalogu Kombëtar**

1. Një varietet çregjistrohet nga KK-ja në rastet e mëposhtme:

a) me përfundimin e periudhës, për të cilën një varietet është regjistruar në KK;

b) me kërkesën e personit që ka kërkuar regjistrimin në KK;

c) me kërkesën e KVVRKK-së, kur vërehet se varieteti nuk ruhet e mirëmbahet për uniformitet e stabilitet nga personi përgjegjës dhe ka humbur vlerat për kultivim e përdorim;

ç) kur të dhënat e paraqitura nga aplikanti rezultojnë të falsifikuara.

2. Për çregjistrimin e varietetit nga KK-ja, ESHFF-ja merr vendim të formës së prerë dhe e boton në buletin e saj zyrtar.

3. Procedura e çregjistrimit të varieteteve nga KK-ja përcaktohet me udhëzim të ministrit.

#### Neni 37

### **Rinovimi i regjistrimit të varietetit në Katalogun Kombëtar**

1. Kërkesa për rinovimin e regjistrimit të varietetit në KK depozitohet nga aplikuesi ose personi përgjegjës i autorizuar prej tij.

2. ESHFF-ja miraton kërkesën, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara për vlerat e kultivimit dhe të përdorimit të një varieteti, të konfirmuara nëpërmjet provave zyrtare të testimit. Vendimi është i formës së prerë dhe botohet në buletin zyrtar të tij.

3. Shpenzimet financiare të rinovimit të regjistrimit të varietetit përballohen nga aplikuesi. Tarifat përkatëse përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

4. Procedura e rinovimit të regjistrimit, forma dhe përmbajtja e kërkesës për rinovimin e regjistrimit të varietetit në KK përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### Neni 38

### **Mbajtja e dokumentacionit**

1. ESHFF-ja mban të gjithë dokumentacionin ku bazohet vendimi i tij për regjistrimin e varietetit në KK.

2. ESHFF-ja i mban këto dokumente për të paktën dy vjet nga data e daljes së vendimit për refuzimin e regjistrimit të varietetit në KK dhe për pesë vjet nga data e çregjistrimit të varietetit nga KK-ja.

3. Këto të dhëna janë publike përveç atyre që konsiderohen sekret për biznesin dhe vihen në dispozicion në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave.

Neni 39

**Ruajtja e mostrave standarde të materialit mbjellës e shumëzues bimor të një varieteti**

1. Për secilin varietet, farë apo material tjetër mbjellës dhe shumëzues bimor, të listuar në KK, të prodhuar dhe të certifikuar zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë, mbahet një mostër standarde. Mostrat standarde ruhen për një periudhë 1-vjeçare në mjediset e ESHFF-së.

2. Mbajtja e mostrave standarde të materialit mbjellës e shumëzues bimor të një varieteti financohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 40

**Komisioni i Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogu Kombëtar**

1. KVVRKK-ja ngrihet dhe funksionon në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe kryen detyrat e mëposhtme:

a) vlerësimin e rezultateve të testimit të varietetit në lidhje me plotësimin e standardeve për kultivim e përdorim dhe marrjen e vendimit për regjistrimin ose jo të varietetit të propozuar për regjistrim në KK;

b) hartimin dhe miratimin e metodikave për testimin varietor, sipas këtij ligji;

c) diskutimin e çështjeve të tjera nga fusha e prodhimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor.

2. Përbërja dhe funksionimi i KVVRKK-së, për specie të veçanta ose/dhe grup speciesh të bimëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

KREU VII

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Neni 41

**Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve**

*(Ndryshuar shkronja "e" me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013 dhe nr.105/2015, datë 1.10.2015)*

1. ESHFF-ja është person juridik publik, që funksionon në varësi të ministrit, me financim nga Buxheti i Shtetit. Detyrat e këtij enti për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë si më poshtë:

a) të kryejë procedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin e varieteteve nga KK-ja;

b) të organizojë dhe të drejtojë sistemin e informacionit në fushën e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

c) të organizojë dhe të kryejë testimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të ri, të krijuar ose/dhe të importuar;

ç) të organizojë dhe të drejtojë procedurat e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përgatitjen e etiketës zyrtare dhe administrimin e saj;

d) të lidhë kontrata publike të shërbimeve me subjektet, publike e private, për realizimin e procedurave të certifikimit zyrtar, të testimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe kryerjen e mbikëqyrjes për realizimin e detyrave të tyre;

dh) të bashkëpunojë me struktura dhe organizata të tjera, brenda dhe jashtë vendit, për të marrë pjesë në veprimtari që kanë të bëjnë me materialin mbjellës dhe shumëzues bimor;

e) të verifikojë dhe të analizojë mostrat për të gjitha sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, për çdo specie, varietet dhe lot, të sjella nga inspektorati që mbulon fushën përkatëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Çdo 6 muaj, ESHFF-ja duhet të pranojë për rianalizim në laboratorin e saj për treguesit e fuqisë mbirëse mostrat e çdo specieje, varieteti dhe loti, të importuara apo të prodhuara në vendin tonë.

2. Organizimi dhe funksionimi i ESHFF-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 42

### **Autoriteti inspektues dhe kontrollues**

*(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar shkronja "a" e pikës 1 me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015)*

1. Detyrat e Inspektoratit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë si më poshtë:

a) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai magazinohet, përpunohet, përgatitet për treg e tregtohet. Çdo 6 muaj, inspektorati që mbulon fushën përkatëse pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit duhet të kërkojë që furnizuesit të kryejnë rianalizimin për treguesit e fuqisë mbirëse për çdo specie, varietet dhe lot të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të importuar apo të prodhuar në vendin tonë në laboratorin e ESHFF-së. Mostrat për rianaliza laboratorike duhet të merren nga specialisti i autorizuar i DB-së;

b) të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;

c) të kontrollojë në magazinat e furnizuesve ose në treg materialin mbjellës shumëzues bimor të importuar, për plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj;

ç) të kontrollojë përfituesit e kontratave publike të shërbimeve, sipas këtij ligji.

2. Inspektorati i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për zbatimin e masave administrative dhe kryerjen e detyrës, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 43

### **Masat administrative**

*(Ndryshuar shkronjat "c" dhe "dh" dhe shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar shkronja "a" dhe "c" me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

Kur kryhet kontroll, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, inspektori merr masat administrative të mëposhtme:

a) ndalon kryerjen e veprimtarive për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nga një person që nuk është i regjistruar në regjistrin tregtar.

b) urdhëron marrjen e masave për eliminimin e parregullsive dhe të mangësive në një afat kohor prej 15 ditëve nga data e kryerjes së kontrollit;

c) propozon për ndalimin përkohësisht të ushtrimit të veprimtarisë së furnizuesit, nëse ky i fundit nuk ka të regjistruar në regjistrin tregtar objektin e veprimtarisë për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, deri në përmbushjen e këtij detyrimi, ose propozon ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizuesit për rastet kur detyrat e lëna nga ai nuk janë zbatuar për më shumë se dy herë.

ç) urdhëron korrigjimin e parregullsive dhe ndalon përkohësisht tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili nuk është ambalazhuar dhe etiketuar sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij;

d) ndalon tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të prodhuar në vend dhe të importuar, që nuk plotëson kërkesat e përcaktuara;

dh) i propozon drejtuesit të AKU-së t'i kërkojë pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ndërprerjen e kontratave të shërbimeve të lidhura sipas pikës "d" të nenit 41, nëse nuk janë përmbushur detyrimet e përcaktuara ose ato nuk janë zbatuar sipas përcaktimeve kontraktore;

e) merr masa administrative për shkeljet që dalin gjatë kryerjes së kontrollit për zbatimin e këtij ligji.

Masa e propozimit për heqjen e licencës dhe e ndalimit përkohësisht të tregtimit të materialit mbjellës, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni, janë dënime plotësuese. Masat e tjera të parashikuara në këtë nen janë dënime kryesore.

Neni 44

### **Analizat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor**

*(ndryshuar me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. Analizat laboratorike zyrtare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhen në laborator testues dhe/ose në laborator reference, miratuar nga ministri. Laboratorët miratohen vetëm pasi të jenë akredituar. Lista e analizave të miratuara duhet të jetë e përfshirë në listën e analizave, për të cilin laboratorit është akredituar.

2. Laboratori i referencës kryen analizat e mostrave, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimi të treguesve cilësorë për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

3. Kriteret që duhet të plotësojnë laboratorët testues dhe laboratorët e referencës për t'u miratuar, si dhe procedura për miratimin e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4. Procedura që ndiqet për marrjen e mostrave dhe transporti i tyre për kryerjen e analizave në laborator përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Lista e analizave që kryejnë laboratorët e referencës miratohet me urdhër të ministrit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

## **KREU VIII**

### **MARRJA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMACIONIT**

Neni 45

#### **Marrja dhe përdorimi i të dhënave**

1. ESHFF-ja, për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të furnizuesve të licencuar, të të dhënave të prodhimit, të importit dhe të eksportit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor tëKK-së mund të marrë dhe mund të përdorë të dhëna, të mbajtura nga ente shtetërore të autorizuara, subjekte, agjenci publike, koncesionare dhe autoritete të tjera të autorizuara.

2. Administruesit e këtyre të dhënave, të hartave, të fotove ortodixhitale janë të detyruar t'i japin ESHFF-së çdo informacion, pa pagesë, përjashtuar kostot e drejtëpërdrejta të materialeve, të kopjeve ekstra dhe përpunimit të të dhënave.

3. Mënyra e marrjes së të dhënave nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe administrimi i tyre nga ESHFF-ja bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 46

#### **Komunikimi i të dhënave**

Të dhënat e krijuara dhe të administruara nga ESHFF-ja janë publike, përveç të dhënave që vlerësohen të dhëna personale dhe përbëjnë sekret tregtar. Në këtë rast, të dhënat u vihen në dispozicion të tretëve, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe legjislacionin për shoqëritë tregtare.

Neni 47

#### **Financimi i bazës së të dhënave**

Baza e të dhënave, që sigurohen dhe administrohen nga ESHFF-ja, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, financohet nga Buxheti i Shtetit.

**KREU IX**  
**SHËRBIMET DHE KONTRATAT PUBLIKE TË SHËRBIMEVE NË FUSHËN**  
**E MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR**

Neni 48

**Veprimtaritë dhe financimi publik**

Shërbimi publik në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor financohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 49

**Kryerja e shërbimeve publike**

1. Detyrat e shërbimit publik për testimin e varieteteve për vlerën e kultivimit dhe të përdorimit për praninë në KK, si dhe për procedurat për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor kryhen nga ESHFF-ja ose subjekte, publike e private, që veprojnë në fushën e bujqësisë, me kusht që personeli që kryen këto procedura të plotësojë kërkesat e caktuara të kualifikimit.

2. Kushtet, që duhet të plotësojnë subjektet publike e private, për kryerjen e shërbimit publik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 50

**Shërbime publike me të tretë**

1. ESHFF-ja mund t'ua delegojë shërbimin publik të testimit të varieteteve, për vlerën e kultivimit dhe të përdorimit, me qëllim regjistrimin në KK të procedurave të certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 49 të këtij ligji, sipas rregullave të prokurimit publik.

2. Marrëdhëniet ndërmjet ESHFF-së dhe zbatuesit të shërbimit publik të testimit të varieteteve për vlerën e kultivimit dhe të përdorimit, me qëllim regjistrimin në KK, për procedurat e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor përcaktohen me kontratën publike të shërbimeve.

Neni 51

**Mbikëqyrja për zbatimin e shërbimit publik**

Mbikëqyrja teknike për zbatimin e detyrave të shërbimit publik për testim të varieteteve për vlerën e kultivimit dhe të përdorimit, me qëllim regjistrimin në KK, për procedurat e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga ESHFF-ja.

Neni 52

**Kontratat publike të shërbimeve**

1. Për zbatimin e detyrave të përcaktuara në nenet 49, 50 dhe 51 të këtij ligji, ESHFF-ja lidh kontrata publike të shërbimeve me subjektet, publike dhe private, që përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 49 të këtij ligji.

2. Kontratat publike të shërbimeve lidhen në vijim të procedurave të prokurimit publik.

3. Kontrata publike e shërbimeve zgjidhet nga ESHFF-ja nëse përfituesi i kontratës ndryshon kushtet e përcaktuara ose vepron në kundërshtim me rregullat e vendosura. Kundër vendimit të ESHFF-së, përfituesi i kontratës mund të ankohej te ministri.

KREU X  
KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 53  
**Kundërvajtje administrative**

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

1. Tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me kërkesat e pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 shkronjat “b”, “ç” dhe “d” dhe 8 të nenit 4 të këtij ligji.
2. Tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.
3. Tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji.
4. Tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor i farave të përziara, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.
5. Prodhimi për qëllim tregtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me kërkesat e pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 11 të këtij ligji.
6. Mosdeklarimi i prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, sipas kërkesave të pikave 1 dhe 2 të nenit 12 të këtij ligji.
7. Moszbatimi nga furnizuesi i detyrave të lëna nga inspektori, sipas kërkesës së pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji.
8. Mospërputhja e të dhënave të cilësisë, të deklaruara nga furnizuesi, me të dhënat e rezultuara nga analiza e mostrave të kontrollit, sipas pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.
9. Importimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji.
10. Importimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në kundërshtim me kërkesat e pikave 1 dhe 2 të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 54  
**Sanksionet**

*(Ndryshuar shkronja “b” e pikës 6 dhe shtuar pika 10 me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar me ligjin nr.105/2015, datë 1.10.2015, ndryshuar pika 7, me ligji nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 53, të ligjit, nga inspektori jepen këto ndëshkime:

1. Për shkeljet e parashikuara në pikat 3 dhe 6, gjobë 70 mijë lekë.
2. Për shkeljet e parashikuara në pikën 1:
  - a) gjobë 200 mijë lekë, për shkeljet që parashikohen në pikat 1, 2, 3, 5, 6, 7, shkronjat “b”, “ç” dhe “d”, dhe 8, të nenit 4, të ligjit;
  - b) përveç gjobës, për rastet sipas pikave 2, 3, 5 e 7, shkronjat “b”, “ç” dhe “d”, të nenit 4, të ligjit, merret masë sekuestrimi, asgjësimi e kthimi në vendin e origjinës me shpenzimet e furnizuesit.
3. Për shkeljet e parashikuara në pikën 2, gjobë 70 mijë lekë dhe merret masë sekuestrimi, asgjësimi ose kalimi për konsum, kur materiali është i konsumueshëm.
4. Për shkeljet e parashikuara në pikën 4:
  - a) sanksione të njëjta me ato të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni;
  - b) gjobë 70 mijë lekë, për shkeljet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit.
5. Për shkeljet e parashikuara në pikën 5:
  - a) gjobë 70 mijë lekë, për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 11, të ligjit.
  - b) për shkeljet, sipas pikave 5, 6 dhe 7, të nenit 11, të ligjit, merret masë sekuestrimi, asgjësimi ose kalimi për konsum, kur materiali është i konsumueshëm.
6. Për shkeljet e parashikuara në pikën 7:



- a) gjobë 30 mijë lekë;
- b) në rastet kur furnizuesi nuk plotëson detyrat e lëna nga inspektori në më shumë se dy herë, AKU-ja i propozon ministrit heqjen e licencës së furnizuesit.
7. Për shkeljet e parashikuara në pikën 8, gjobë 40 000 (dyzet mijë) lekë dhe merret masë sekuestrimi, asgjësimi ose kthimi në vendin e origjinës.
8. Për shkeljet e parashikuara në pikën 9, gjobë 70 mijë lekë dhe kthim në vendin e origjinës me shpenzimet e importuesit.
9. Për shkeljet e parashikuara në pikën 10, gjobë 70 mijë lekë dhe bllokim deri në plotësimin e kërkesave ligjore.
10. Gjopa dhe masat e parashikuara në shkronjën “a”, të pikave 5 dhe 6, të këtij neni, janë dënime kryesore. Ndërsa masat ndëshkuese të tjera, të parashikuara në këtë nen, janë dënime plotësuese.

#### Neni 55

### **Procedura e kundërvajtjes administrative**

*(Ndryshuar me ligjin nr.67/2013, datë 14.2.2013)*

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
2. Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

#### Neni 56

### **Ekzekutimi i vendimit**

Ekzekutimi i vendimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

#### Neni 57

### **Të ardhurat nga vjelja e gjobave**

Të ardhurat që krijohen nga vjelja e gjobave kalojnë 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

## KREU XI

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 58

### **Aktet nënligjore**

*(hiqen referenca në pikën 1 dhe shtohen në pikën 2 me ligjin nr. 12/2019, datë 5.3.2019)*

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 pika 9, 5 pika 2, 7 pika 2, 14 pika 3, 15 pika 3, 16 pika 4, 17 pika 4, 18 pika 1, 19 pika 5, 33 pika 6, 40 pika 2, 41 pika 2, dhe 49 pika 2 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 pika 10, 6 pikat 1 e 3, 8 pika 2, 9 pika 2, 10 pika 4, 11 pikat 5 e 8, 12 pika 4, 13 pika 6, 20 pika 2, 25 pika 2, 26 pika 4, 29 pika 3, 30 pika 4, 34 pika 3, 35 pika 3, 36 pika 3 dhe 37 pika 4, 44, pikat 3 dhe 4, të këtij ligji.
3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për financat të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 16 pika 3, 18 pika 3, 21 pika 3, 24 pika 5, 28 pika 3 dhe 33 pika 7 të këtij ligji.
4. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për pyjet dhe bimët dekorative të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 4 pika 10 të këtij ligji.

Neni 59

**Dispozita kalimtare**

1. Regjistrimi i varieteteve në KK bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

a) Aplikuesit për regjistrimin e një varieteti në KK mund të bëjnë një kërkesë për regjistrimin e varieteteve të përfshira aktualisht në katalogun zyrtar të specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe të bimëve pyjore e dekorative, deri në një vit nga hyrja në fuqi e këtijligji.

b) Varietetet, të cilat në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë qenë të regjistruara, do të qëndrojnë të regjistruara deri në 2 vjet e gjysmë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Materiali mbjellës bimor, i cili është prodhuar, përpunuar dhe paketuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të tregtohet deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Laboratorëve shtetërorë u lihet një periudhë 3-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për marrjen e certifikatës së akreditimit. Deri në marrjen e kësaj certifikate ato vazhdojnë të kryejnë shërbimet e parashikuara në këtë ligj.

4. Deri në momentin e daljes së akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

5. Pika 5 e nenit 4, pika 2 e nenit 30, pika 2 e nenit 31 dhe pika 3 e nenit 33 hyjnë në fuqi 5 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Dispozitë kalimtare**

*(e vendosur me ligjin nr. 67/2013, datë 14.2.2013)*

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual derinë krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 60

**Shfuqizime**

Ligji nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”, shfuqizohet.

Neni 61

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6982, datë 20.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr. 106/2016**

**PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK, ETIKETIMIN E PRODUKTEVE BIOLOGJIKE  
DHE KONTROLLIN E TYRE<sup>16</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit biologjik, të sigurojë funksionimin efikas të tregut dhe të garantojë konkurrencë të drejtë, besimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.
2. Ky ligj përcakton objektivat dhe parimet e përgjithshme për:
  - a) të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes e shpërndarjes së produkteve biologjike dhe kontrollit të tyre;
  - b) përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit biologjik në etiketim dhe reklama.

Neni 2  
**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për produktet që vijnë nga bujqësia, përfshirë akuakulturën, kur këto produkte janë vendosur ose kanë për qëllim të vendosen në treg, si më poshtë:
  - a) produktet bujqësore të gjalla ose të papërpunuara;
  - b) produktet bujqësore të përpunuara për t'u përdorur si ushqim;
  - c) ushqimet për kafshë;
  - ç) materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.
2. Ky ligj zbatohet edhe për majatë që përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë.
3. Ky ligj zbatohet për çdo operator të prodhimit, përgatitjes, transportit dhe shpërndarjes së produkteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të operatorëve të cateringut.
4. Ky ligj zbatohet për produktet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, pa cenuar dispozitat ligjore në fuqi për prodhimin, përgatitjen, tregtimin, etiketimin dhe kontrollin, për ushqimin dhe ushqimin për kafshë.
5. Produktet nga gjuetia dhe peshkimi i kafshëve të egra nuk konsiderohen prodhim biologjik.

---

<sup>16</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007, datë 28 qershor 2007, "Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) 2092/91", të ndryshuar. Numri CELEX: 32007R0834, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L Nr. 189, dt. 20.7.2007, faqe 1-23.

### Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Autoriteti kompetent” është ministria përgjegjëse për bujqësinë.
- b) “Akuakulturë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për akuakulturën.
- c) “Aditiv ushqimor për ushqime për kafshë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.
- ç) “Etiketim” ka kuptimin e dhënë në aktet nënligjore në zbatim të ligjit për ushqimin.
- d) “Fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes” është çdo fazë, duke filluar nga prodhimi primar i një produkti biologjik, deri te ruajtja, përpunimi, prodhimi, transporti dhe shitja apo furnizimi te konsumatori i fundit dhe atje ku është e nevojshme, si edhe veprimtaritë e etiketimit, reklamave, importit, eksportit dhe nënkontraktiveve.
- dh) “I prodhuar nga OMGJ” është produkti, i cili vjen tërësisht apo pjesërisht nga OMGJ-të, por që nuk përmban apo përbëhet nga OMGJ-të.
- e) “I prodhuar me OMGJ” është produkti i prodhuar duke përdorur një OMGJ, si organizëm i fundit i gjallë në procesin e prodhimit, por që nuk përmban ose përbëhet nga OMGJ-të dhe as është prodhuar nga OMGJ-të.
- ë) “Kalim” është kalimi nga bujqësia jobiologjike në biologjike, brenda një periudhe të caktuar kohe, gjatë së cilës zbatohen kërkesat për prodhimin biologjik.
- f) “Lëndë ndihmëse e përpunimit” është çdo substancë që nuk konsumohet si përbërës ushqimor në vetvete, e cila përdoret qëllimisht në përpunimin e lëndëve të para, ushqimeve apo përbërësve të tyre, për të arritur një qëllim të caktuar teknologjik gjatë trajtimit ose përpunimit dhe që mund të rezultojë në praninë e paqëllimshme, por teknikisht të pashmangshme, të mbetjeve të vetë substancës ose derivateve të saj në produktin përfundimtar, me kusht që këto mbetje të mos paraqesin rrezik për shëndetin, si dhe të mos kenë ndonjë efekt teknologjik në produktin përfundimtar.
- g) “Operator” është çdo person fizik apo juridik, përgjegjës për të siguruar zbatimin e kërkesave të këtij ligji në veprimtaritë biologjike të kontrolluara prej tij.
- gj) “Organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ)” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.
- h) “Prodhim biologjik” është përdorimi i metodave të prodhimit në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj për të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.
- i) “Prodhim bimor” është prodhimi i produkteve nga bimët bujqësore, përfshirë vjeljen e bimëve të egra për qëllime tregtare.

j) “Produkt biologjik/organik/bio/eko” është produkt i përfutur ose i lidhur me prodhimin biologjik.

k) “Prodhim shtazor” është prodhimi i kafshëve dhe shpendëve shtëpiake apo të zbutura (përfshirë insektet), përjashtuar kafshët ujore.

l) “Përgatitja” janë veprimet për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve biologjike, përfshirë therjen e kafshëve dhe prerjen e mishit, ambalazhimin, etiketimin dhe/ose ndryshimet e bëra në etiketimin për tregimin e metodës së prodhimit biologjik.

ll) “Paraambalazhim” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

m) “Përbërës” ka kuptimin e dhënë në aktet nënligjore në zbatim të ligjit për ushqimin.

n) “Produkte për mbrojtjen e bimëve (PMB)” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

nj) “Produkt i kontaminuar” është produkti që, pas analizimit laboratorik, rezulton me mbetje të inputeve të palejuara për t’u përdorur në prodhimin biologjik ose me çdo mbetje tjetër.

o) “Reklamë” është çdo paraqitje te publiku, me çdo mënyrë tjetër përveç etiketës, që ndikon ose mund të ndikojë dhe përcaktojë qëndrime, bindje e sjellje për të nxitur drejtpërdrejt apo tërthorazi shitjen e produkteve biologjike.

p) “Rrezatim jonizues” është transferim i energjisë në formë grimcash elementare ose valësh elektromagnetike, me gjatësi 100 nanometër apo më të vogël ose me frekuencë 3 x 10<sup>15</sup> Hertz apo më të madhe, në gjendje të prodhojë jone, drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt.

q) “Trupa e kontrollit” është njësi e pavarur private, vendase apo e huaj, e cila kryen inspektimin dhe certifikimin në fushën e prodhimit biologjik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

r) “Ushqim” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

rr) “Ushqim për kafshë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

s) “Vendosje në treg” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për ushqimin.

sh) “Veprimtaritë e kateringut” është përgatitja e produkteve biologjike në restorante, spitale, mensa dhe biznese të tjera të ngjashme ushqimore, në pika shitjeje apo shpërndarjeje për konsumatorin e fundit.

## KREU II

### OBJEKTIVAT DHE PARIMET E PRODHIMIT BIOLOGJIK

#### Neni 4

#### **Objektivat**

Objektivat për prodhimin biologjik janë:

a) vendosja e një sistemi menaxhimi të qëndrueshëm të bujqësisë, i cili:

i) respekton sistemet dhe ciklet e natyrës, ruan e përmirëson shëndetin e tokës, ujit, bimëve dhe kafshëve, si dhe ekuilibrin ndërmjet tyre;

ii) kontribuon për një nivel të lartë të larmisë biologjike;

iii) siguron përdorimin e përgjegjshëm të energjisë e burimeve natyrore, të tilla si uji, toka, lëndët biologjike dhe ajri;

iv) respekton standarde të larta të mirëqenies së kafshëve dhe, në veçanti, plotëson nevojat specifike jetësore, sipas llojeve të kafshëve;

b) prodhimi i produkteve me cilësi të lartë;

c) prodhimi i një larmie të gjerë ushqimesh e produkteve të tjera bujqësore, të cilat i përgjigjen kërkesës së konsumatorëve për produkte të prodhuara nga përdorimi i proceseve që nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin e njerëzve, bimëve ose shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

## Neni 5 Parime të përgjithshme

Prodhimi biologjik mbështetet në këto parime:

- a) Planifikimi dhe menaxhimi i përshtatshëm i proceseve biologjike, bazuar në sistemet ekologjike që përdorin burime natyrore brenda sistemit, me metoda, të cilat:
  - i) përdorin organizma të gjallë dhe metoda mekanike prodhimi;
  - ii) praktikojnë kultivimin e kulturave bujqësore dhe prodhimin shtazor, të bazuara në tokë, ose akuakulturën, në përputhje me parimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm;
  - iii) përjashtojnë përdorimin e OMGJ-ve dhe produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ, por nuk përjashtojnë përdorimin e produkteve mjekësore veterinarë;
  - iv) bazohen në vlerësimin e rrezikut dhe, kur është e nevojshme, në marrjen e masave paraprake dhe parandaluese.
- b) Kufizimi i përdorimit të inputeve që vijnë nga jashtë njësisë. Kur inputet e jashtme janë të nevojshme ose nuk ekzistojnë praktikisht dhe metodat e përshtatshme menaxheriale, të përcaktuara në shkronjën “a”, të këtij neni, atëherë ato kufizohen në:
  - i) inpute nga prodhimi biologjik;
  - ii) substanca natyrore apo me prejardhje natyrore;
  - iii) plehra minerale me tretshmëri të ulët.
- c) Kufizimi i rreptë i përdorimit të inputeve të sintetizuara kimikisht vetëm në rastet përjashtimore kur:
  - i) nuk ekzistojnë praktikisht e përshtatshme të menaxhimit;
  - ii) inputet e jashtme, të përcaktuara në shkronjën “b”, të këtij neni, nuk gjenden në treg;
  - iii) përdorimi i inputeve të jashtme, të përcaktuara në shkronjën “b”, çon në krijimin e efekteve të papranueshme mjedisore.
- ç) Përshtatja, kur është e nevojshme dhe brenda përcaktimeve të këtij ligji, e rregullave të prodhimit biologjik, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore, ndryshimet klimatike rajonale dhe të kushteve lokale, fazat e zhvillimit, si dhe praktikisht e veçanta të mbarështimit.

## Neni 6 Parimet e veçanta për bujqësinë

Përveç parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, bujqësia biologjike bazohet në këto parime të veçanta:

- a) ruajtja, zhvillimi i jetës, pjellorisë natyrore të tokës, qëndrueshmërisë e larmisë biologjike në tokë, duke parandaluar e luftuar erozionin, ngjeshjen e tokës dhe të ushqyerit e bimëve kryesisht përmes ekosistemit të tokës;
- b) minimizimi i përdorimit të burimeve të paripërtëritshme dhe të inputeve nga jashtë fermës;
- c) riciklimi i mbetjeve dhe nënprodukteve me prejardhje bimë e shtazore si inpute në prodhimin bimor e shtazor;
- ç) marrja parasysh e ekuilibrit ekologjik lokal apo rajonal në marrjen e vendimeve për prodhimin;
- d) ruajtja e shëndetit të kafshëve, duke nxitur mbrojtjen imunologjike natyrore të tyre, si dhe përzgjedhjen e racave e praktikave të përshtatshme të mbarështimit;
- dh) mbrojtja e shëndetit të bimëve nëpërmjet masave parandaluese, siç janë përzgjedhja e specieve të përshtatshme, varieteteve të qëndrueshme ndaj dëmtuesve e sëmundjeve, qarkullimet e përshtatshme të kulturave bujqësore, metodat mekanike e fizike, si dhe mbrojtja e armiqve natyrorë të dëmtuesve;
- e) zbatimi i praktikave të prodhimit shtazor që i përshtaten vendit dhe që lidhen me tokën;
- ë) sigurimi i një niveli të lartë të mirëqenies së kafshëve, duke respektuar kërkesat e veçanta sipas specieve;

f) prodhimi i produkteve blegtorale biologjike, nga kafshë të rritura në ferma biologjike që nga lindja ose çelja dhe gjatë gjithë jetës së tyre;

g) zgjedhja e racave, bazuar në aftësinë e kafshëve për t'iu përshtatur kushteve lokale, vitalitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre ndaj sëmundjeve ose problemeve shëndetësore;

gj) ushqimi i kafshëve me ushqim biologjik për kafshë, të përbërë nga lëndë të para që vijnë nga bujqësia biologjike dhe nga substanca natyrore jobujqësore;

h) zbatimi i praktikave të mbarështimit të kafshëve, të cilat forcojnë sistemin imunitar dhe fuqizojnë mbrojtjen natyrore kundër sëmundjeve, duke përfshirë, sidomos, ushtrime fizike të rregullta dhe, kur është e përshtatshme, qasjen ndaj vendeve të hapura e në kullota;

i) përjashtimi i mbarështimit të kafshëve poliploide, të krijuara në rrugë artificiale;

j) ruajtja e larmisë biologjike të ekosistemeve natyrore ujore, e shëndetit të vazhdueshëm të mjedisit ujor, e cilësisë së ekosistemeve ujore dhe tokësore përreth tyre, në prodhimin nga akuakultura;

k) ushqimi i organizmave ujorë me ushqim për kafshë që vjen nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i peshkimit, në mënyrë që popullata ujore të mos ndikohet e të mos ushtrojë ndikim negativ në mjedis, ose me ushqime biologjike për kafshë, të përbëra nga përbërës bujqësorë biologjikë dhe substanca natyrore jobujqësore.

#### Neni 7

### **Parimet e veçanta për përpunimin e ushqimeve biologjike**

Përveç parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, prodhimi i ushqimeve biologjike të përpunuara bazohet në këto parime të veçanta:

a) prodhimi i ushqimeve biologjike nga përbërës që vijnë nga bujqësia biologjike, përveç rasteve kur një përbërës i tillë nuk gjendet në treg në formë biologjike;

b) kufizimi i përdorimit të aditivëve ushqimorë, i përbërësve jobiologjikë, me funksione kryesisht teknologjike e shqisore, si dhe i mikroelementeve e lëndëve ndihmëse në përpunim, në mënyrë që të përdoren në sasi minimale dhe vetëm në rast nevojë të domosdoshme teknologjike ose për qëllime të veçanta ushqimore;

c) përjashtimi i substancave dhe metodave përpunuese që mund të keqinformojnë lidhur me natyrën e vërtetë të produktit;

ç) përpunimi me kujdes i ushqimit, duke i dhënë përparësi përdorimit të metodave biologjike, mekanike dhe fizike.

#### Neni 8

### **Parimet e veçanta për përpunimin e ushqimeve biologjike për kafshë**

Përveç parimeve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, prodhimi i ushqimeve të përpunuara biologjike për kafshë bazohet në këto parime të veçanta:

a) prodhimi i ushqimeve biologjike për kafshë nga përbërës ushqimorë biologjikë për kafshë, përveçse kur përbërës të tillë nuk gjenden në treg në formë biologjike;

b) kufizimi i përdorimit të aditivëve të ushqimit për kafshë dhe lëndëve ndihmëse për përpunim në sasi minimale dhe vetëm në rast nevojë të domosdoshme teknologjike apo zooteknike ose për qëllime të veçanta të ushqyerit;

c) përjashtimi i substancave dhe metodave përpunuese që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të produktit;

ç) përpunimi me kujdes i ushqimit për kafshë, duke i dhënë përparësi përdorimit të metodave biologjike, mekanike dhe fizike.

KREU III  
RREGULLAT E PRODHIMIT

SEKSIONI 1  
NDALIMET NË PRODHIMIN BIOLOGJIK

Neni 9  
**Ndalimi i përdorimit të OMGJ-ve**

1. Në prodhimin biologjik ndalohet përdorimi i OMGJ-ve dhe i produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ, si ushqim, ushqim për kafshë, lëndë ndihmëse në përpunim, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehra të përdorimit bujqësor, përmirësues të tokës, material mbjellës dhe shumëzues bimor, mikroorganizma dhe kafshë.

2. Për qëllim të ndalimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për OMGJ-të ose produktet e prodhuara nga OMGJ-të, si ushqime dhe ushqime për kafshë, operatorët mund të bazohen tek etiketa që shoqëron produktin ose në çdo dokument tjetër shoqërues, sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin, lidhur me gjurmueshmërinë dhe etiketimin e organizmave gjenetiki të modifikuar dhe gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore dhe ushqimit për kafshë, të prodhuara nga organizmat gjenetiki të modifikuar.

Operatorët mund të konsiderojnë se asnjë OMGJ ose produkt i prodhuar nga OMGJ-të nuk është përdorur gjatë prodhimit të ushqimeve ose ushqimeve për kafshë, nëse etiketa ose dokumenti shoqërues nuk tregon që përmban OMGJ, përveç kur ka informacione se etiketimi i produkteve në fjalë nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi për ushqimin.

3. Për ndalimet, sipas pikës 1, të këtij neni, për produktet që nuk janë ushqim ose ushqim për kafshë apo produktet e prodhuara nga OMGJ, operatorët që përdorin produkte të tilla jobiologjike, të blera nga palë të treta, duhet t'i kërkojnë shitësit dokumentacionin që vërteton se produktet e ofruara nuk janë prodhuar nga ose me OMGJ.

4. Masat për ndalimin e përdorimit të OMGJ-ve dhe produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 10  
**Ndalimi i përdorimit të rrezatimit jonizues**

Ndalohet përdorimi i rrezatimit jonizues në trajtimin e ushqimeve biologjike ose ushqimeve biologjike për kafshë, apo të lëndëve të para që përdoren në ushqimet biologjike ose në ushqimet biologjike për kafshë.

SEKSIONI 2  
PRODHIMI BUJQËSOR

Neni 11  
**Rregulla të përgjithshme për prodhimin bujqësor**

1. Ferma bujqësore menaxhohet në përputhje me kërkesat që zbatohen për prodhimin biologjik.

2. Në kushte të veçanta, ferma mund të ndahet në njësi prodhimi bujqësor ose vende prodhimi të akuakulturës, të ndara qartësisht nga ato të prodhimit jobiologjik. Për kafshët, kjo zbatohet për specie të ndryshme; për akuakulturën mund të përdoren të njëjtat specie, me kusht që të sigurohet ndarje e përshtatshme e vendeve të prodhimit; për bimët, për të shmangur prodhimin paralel, përdoren varietete të ndryshme, lehtësisht të dallueshme.

3. Në përputhje me përcaktimin në pikën 2, të këtij neni, në rastet kur prodhimi biologjik nuk kryhet në të gjitha njësitë e fermës, fermeri e ndan veçmas tokën, kafshët dhe produktet që përdoren



për njësitë biologjike, ose që prodhohen nga këto njësi, nga ato që përdoren ose prodhohen nga njësitë jobiologjike, dhe mban dokumentacionin e duhur, që e vërteton këtë ndarje.

## Neni 12

### **Rregullat për prodhimin bimor**

1. Përveç rregullave të përgjithshme të prodhimin bujqësor, të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, për prodhimin biologjik bimor zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

a) për prodhimin biologjik bimor përdoren praktika punimi dhe kultivimi që ruajnë ose rrisin përmbajtjen e lëndës biologjike në tokë, qëndrueshmërinë dhe larminë biologjike të tokës dhe parandalojnë ngjeshjen dhe erozionin e saj;

b) pjelloria dhe aktiviteti biologjik i tokës ruhen dhe rriten nëpërmjet qarkullimeve shumëvjeçare të kulturave, përfshirë bimët bishtajore e kultura të tjera për plehërim të gjelbër, dhe përdorimit të plehut të kafshëve ose materialeve biologjike të përfuara nga prodhimi biologjik, që të dyja mundësisht të kompostuara;

c) lejohet përdorimi i preparateve biodinamike;

ç) plehrat dhe përmirësuesit e tokës përdoren vetëm nëse përcaktohen sipas nenit 16 të këtij ligji;

d) nuk përdoren plehrat minerale azotike;

dh) të gjitha teknikat e prodhimit bimor të parandalojnë ose minimizojnë mundësinë e ndotjes së mjedisit;

e) parandalimi i dëmit të shkaktuar nga dëmtuesit, sëmundjet dhe barërat e këqija mbështetet, kryesisht, në mbrojtjen me anë të armiqve natyrorë, zgjedhjen e specieve dhe varieteteve, në qarkullimet bujqësore, në teknikat e kultivimit dhe në proceset termike;

ë) në rast të një rreziku real për një kulturë, përdoren vetëm produktet për mbrojtjen e bimëve, sipas përcaktimit në nenin 16, të këtij ligji;

f) për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farat dhe materialit mbjellës e shumëzues bimor përdoret vetëm farë dhe material mbjellës dhe shumëzues bimor i prodhuar në mënyrë biologjike. Për këtë qëllim, bimët mëmë, në rastin e farërave, dhe bimët prindërore, në rastin e materialit shumëzues bimor, prodhohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, për të paktën një brezni, dhe në rastin e kulturave shumëvjeçare, dy cikle vegetative;

g) në prodhimin biologjik bimor përdoren vetëm produktet për pastrim dhe dezinfektim, të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji.

2. Mbledhja e bimëve të egra dhe pjesëve të tyre, që rriten në mënyrë natyrore në pyje dhe zonat bujqësore, konsiderohet metodë e prodhimit biologjik, me kusht që:

a) këto zona të mos jenë trajtuar me produkte të tjera, përveç atyre të përcaktuara sipas nenit 16, të këtij ligji, për një periudhë, të paktën, trevjeçare para mbledhjes;

b) mbledhja të mos ndikojë në ekuilibrin e habitatit natyror apo ruajtjen e specieve në zonën e mbledhjes dhe të realizohet nëse është në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor.

## Neni 13

### **Rregullat për prodhimin e algave të detit**

1. Mbledhja e algave të egra dhe pjesëve të tyre, të cilat rriten në mënyrë natyrore në det, konsiderohet si një metodë e prodhimit biologjik, me kusht që:

a) zonat e rritjes së tyre të kenë cilësi të larta ekologjike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ujërat dhe cilësinë e ujërave për rritjen e molusqeve që nuk rezultojnë të papërshtatshme nga ana shëndetësore;

b) algat detare natyrore të ngrënshme të mos mblidhen në zona, të cilat nuk plotësojnë kriteret e vendosura për zonat A e B, të përcaktuara në legjislacionin për produktet ujore, në fuqi, për rregullat dhe normat specifike për organizimin e kontrolleve zyrtare të produkteve me origjinë shtazore të destinuara për konsum njerëzor;

c) mbledhja të mos ndikojë në ekuilibrin afatgjatë të mjedisit natyror ose ruajtjen e specieve në zonën e mbledhjes dhe të realizohet nëse është në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor.

2. Kultivimi i algave të detit konsiderohet biologjik kur bëhet në zonat bregdetare me karakteristika mjedisore dhe shëndetësore që janë, të paktën, ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) përdorimin e praktikave të qëndrueshme në të gjitha fazat e prodhimit, që nga mbledhja e algave të reja për kultivim deri te vjelja e tyre;

b) për të siguruar ruajtjen e një rezerve gjenetike me bazë të gjerë, mbledhja e algave të reja të detit në gjendje natyrore bëhet në mënyrë të rregullt, për të furnizuar zonat e kultivimit;

c) nuk përdoren plehrat kimike, përveçse në zonat e kultivimit të brendshëm dhe vetëm nëse janë të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji.

3. Rregullat e hollësishme për prodhimin bimor dhe prodhimin e algave të detit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

#### Neni 14

### Rregullat për prodhimin blegtoral

Përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit bujqësor, të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, për prodhimin blegtoral zbatohen edhe këto rregulla:

a) Në lidhje me origjinën e kafshëve:

i) kafshët biologjike të jenë lindur dhe rritur në ferma biologjike;

ii) për qëllim riprodhimi, në një fermë biologjike mund të sillen kafshë të rritura në mënyrë jobiologjike, por në kushte të veçanta. Kafshë të tilla dhe produktet e tyre mund të konsiderohen biologjike pas plotësimit të periudhës së kalimit, të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 17, të këtij ligji.

iii) kafshët e pranishme në fermë prej fillimit të periudhës së kalimit, si dhe produktet e tyre, konsiderohen biologjike pas plotësimit të periudhës së kalimit, të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 17, të këtij ligji.

b) Në lidhje me praktikën e mbarështimit dhe kushtet e strehimit:

i) personeli që kujdeset për kafshët të ketë eksperiencë dhe përvojë minimalisht trevjeçare lidhur me nevojat shëndetësore dhe mirëqenien e kafshëve;

ii) praktikën e mbarështimit, përfshirë dendësinë e tufës dhe kushtet e vendstrehimit, të sigurojnë plotësimin e nevojave fiziologjike të sjelljes dhe zhvillimit të kafshëve;

iii) kafshët të kenë qasje të përhershme në sipërfaqe të hapura, mundësisht në kullota, sa herë që e lejojnë kushtet klimatike dhe gjendja e tokës, përveç rasteve të kufizimeve dhe detyrimeve të lidhura me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve e kafshëve, të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi;

iv) numri i kafshëve të kufizohet për të minimizuar mbikullotjen, ngjeshjen e tokës, erozionin ose ndotjet e shkaktuara nga kafshët ose nga shpërndarja e plehrit të tyre;

v) kafshët biologjike të mbahen të veçuara nga kafshët e tjera, megjithatë, në kushte të caktuara kufizuese, lejohet kullotja e kafshëve biologjike në kullota të përbashkëta dhe e kafshëve jobiologjike në toka biologjike;

vi) ndalohet lidhja apo izolimi i kafshëve, përveçse për kafshë të veçanta, për një periudhë të kufizuar kohe dhe aq kohë sa është e nevojshme për arsye sigurie, mirëqenieje ose arsye veterinare;

vii) kohëzgjatja e transportit të kafshëve duhet të jetë sa më e shkurtër;

viii) gjatë gjithë jetës së tyre, kafshëve u shmangen, sa më shumë të jetë e mundur, çdo lloj vuajtje, përfshirë gjymtimin dhe çastet e therjes;

ix) parqet e bletëve duhet të vendosen në zona që sigurojnë burime të mjaftueshme nektari e pjalmi, kryesisht nga kultura bujqësore biologjike ose, sipas rastit, nga bimësia spontane apo pyje të menaxhuara në mënyrë jobiologjike ose nga kultura bujqësore të trajtuara vetëm me metoda me ndikim të ulët në mjedis. Këto parqe të mbahen në distancë të mjaftueshme nga burimet që mund të çojnë në ndotjen e produkteve të bletarisë ose të dëmshme për shëndetin e bletëve;

x) zgjojet dhe materialet që përdoren në bletari të jenë të ndërtuara, kryesisht, prej materialeve natyrore;

xi) ndalohet vrasja e bletëve në hoje, si metodë e vjeljes së produkteve të bletarisë.

c) Në lidhje me riprodhimin:

i) riprodhimi duhet të bëhet me metoda natyrore, por lejohet edhe inseminimi artificial;

ii) riprodhimi nuk duhet të nxitet me trajtime me hormone ose me substanca të ngjashme, përveçse në formën e trajtimit kurues veterinar për kafshë të veçanta;

iii) nuk lejohen format e tjera të riprodhimit artificial, si klonimi dhe transferimi embrional;

iv) duhet të zgjidhen raca të përshtatshme, që të kontribuohet në parandalimin e çfarëdo vuajtjeje dhe për të shmangur nevojën për gjymtimin e kafshëve.

ç) Në lidhje me ushqimin për kafshë:

i) ushqimi për kafshë sigurohet, kryesisht, nga vetë ferma ku mbahen kafshët ose nga fermat e tjera biologjike në të njëjtin rajon;

ii) kafshët duhet të ushqehen me ushqim biologjik për kafshë, i cili plotëson kërkesat ushqyese në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre. Një pjesë e racionit ushqimor mund të përmbajë ushqim për kafshë nga ferma që janë në periudhë kalimi drejt bujqësisë biologjike;

iii) me përjashtim të bletëve, kafshët duhet të kenë qasje të përhershme në kullota apo ushqime voluminoze natyrore;

iv) lëndët e para jobiologjike, bimore e shtazore për ushqim për kafshë, dhe ato minerale, aditivët ushqimorë, produkte të caktuara që përdoren në të ushqyerit e kafshëve dhe si ndihmëse në përpunim përdoren vetëm nëse janë të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji;

v) nuk lejohen të përdoren stimulantët e rritjes dhe aminoacidet sintetike;

vi) të vegjlit e gjitarëve duhet të ushqehen me qumësht natyral, mundësisht me qumështin e nënës.

d) Në lidhje me parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimet veterinare:

i) parandalimi i sëmundjeve bazohet në përzgjedhjen e racave dhe të linjave, në praktikat menaxhuese të mbarështimit, në ushqimin për kafshë me cilësi të lartë dhe në ushtrime, në dendësinë e përshtatshme të tufës, si dhe në kushte strehimi dhe higjiene të përshtatshme;

ii) sëmundja duhet të trajtohet menjëherë, për të shmangur vuajtjet e kafshëve, dhe produktet mjekësore veterinare alopatiche, të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, përdoren kur është e nevojshme dhe nën kushte të rrepta mbikëqyrjeje dhe në rastet kur përdorimi i produkteve fitoterapeutike, homeopatike e produkteve të tjera është i papërshtatshëm. Në veçanti, në lidhje me ciklet dhe periudhat e ndërprerjes së trajtimeve, përcaktohen kufizime, sipas legjislacionit në fuqi;

iii) lejohet përdorimi i medikamenteve veterinare imunizuese;

iv) lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve sipas legjislacionit në fuqi.

dh) Produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve e pajisjeve blegtorale përdoren vetëm nëse përcaktohen sipas nenit 16 të këtij ligji.

## Neni 15

### Rregullat e prodhimit për speciet nën akuakulturë

Përveç rregullave të përgjithshme për prodhimin bujqësor, të përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, për prodhimin e specieve nën akuakulturë zbatohen edhe rregullat e mëposhtme:

a) Për origjinën e specieve të akuakulturës:

i) akuakultura biologjike bazohet në rritjen e pasardhësve të rinj me origjinë nga qendra prindërore biologjike për riprodhim dhe ferma biologjike;

ii) kur nuk mund të sigurohen pasardhësit e rinj nga qendra prindërore apo ferma biologjike, atëherë sillen specie të prodhuara në rrugë jobiologjike, në kushte të përcaktuara.

b) Për praktikat të mbarështimit:

i) personeli që kujdeset për mbarështimin duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë minimalisht trevjeçare, lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e specieve;

ii) praktikat e mbarështimit, përfshirë ushqyerjen, projektimin e instalimeve, dendësinë e kafshëve dhe cilësinë e ujit duhet të sigurojnë plotësimin e nevojat fiziologjike, zhvillimore dhe të sjelljes së specieve;

iii) praktikat e mbarështimit duhet të minimizojnë ndikimin negativ të fermës në mjedis, përfshirë largimin e specieve nga mjediset e fermës;

iv) speciet biologjike duhet të mbahen të ndara nga speciet e tjera ujore;

v) gjatë transportit duhet të sigurohet ruajtja e mirëqenies së specieve ujore;

vi) duhet të minimizohet çdo vuajtje e specieve, përfshirë edhe momentin e fundit jetësor.

c) Për riprodhimin:

i) nuk përdoren induksioni artificial i poliploidisë, hibridizimi artificial, klonimi dhe prodhimi i individëve njëgjjinorë, përveç zgjedhjes me dorë;

ii) përzgjidhen individë të përshtatshëm;

iii) përcaktohen kushtet specifike sipas specieve, për menaxhimin e qendrave prindërore për shtimin dhe prodhimin e pasardhësve të rinj.

ç) Për ushqimin e peshqve dhe krustaceve:

i) speciet duhet të ushqehen me ushqim që ju plotëson kërkesat ushqimore në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre;

ii) pjesa bimore e ushqimit për kafshë duhet të përfitohet nga prodhimi biologjik dhe pjesa e ushqimit për kafshë që përfitohet nga speciet ujore duhet të vijë nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i peshkimit;

iii) lëndët e para jobiologjike me prejardhje bimore, shtazore dhe minerale për ushqim për kafshët, aditivët e ushqimit për kafshë, disa produkte të caktuara që përdoren në të ushqyerit e kafshëve, si dhe ndihmësit në përpunim, përdoren vetëm nëse përcaktohen sipas nenit 16 të këtij ligji;

iv) nuk lejohen të përdoren stimulantët e rritjes dhe aminoacidet sintetike.

d) Për molusqet bivalve dhe speciet e tjera, të cilave nuk u jepet ushqim nga njeriu por ushqehen me plankton natyror:

i) ato specie që ushqehen nëpërmjet filtrimit duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e tyre ushqyese nga natyra, përjashtuar rastin e brezit të ri, të rritur në vaska rritjeje dhe inkubator;

ii) ato duhet të rriten në ujëra që përmbushin kriteret e parashikuara për zonat A dhe B, sipas legjislacionit për produktet ujore në fuqi;

iii) zonat e rritjes duhet të kenë cilësi të lartë ekologjike, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

dh) Për parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimet veterinarë:

i) parandalimi i sëmundjeve bazohet në mbajtjen e specieve në kushte optimale, nëpërmjet vendosjes së përshtatshme, projektimit optimal të fermës, zbatimit të praktikave të mira të mbarështimit dhe menaxhimit, përfshirë pastrimin dhe dezinfektimin e rregullt të lokaleve, ushqimin për kafshë me cilësi të lartë, dendësinë e duhur të specieve dhe zgjedhjen e racave dhe linjave;

ii) sëmundja duhet të trajtohet menjëherë, për të shmangur vuajtjen e species. Në rastet kur përdorimi i produkteve fito-terapeutike, homeopatike dhe i produkteve të tjera është i papërshtatshëm, kur është e nevojshme dhe nën kushte të rrepta mund të përdoren produktet alopatiche mjekësore veterinarë të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët. Në mënyrë të veçantë përcaktohen kufizimet lidhur me ciklet e trajtimit dhe periudhat që nuk bëhet trajtim, në zbatim të legjislacionit në fuqi;

iii) lejohet përdorimi i barnave imunizuese veterinarë;

iv) lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, sipas legjislacionit në fuqi.

e) Produktet për pastrim dhe dezinfektim të pellgjeve, kafazeve, ndërtesave dhe pajisjeve përdoren vetëm nëse janë të përcaktuara sipas nenit 16 të këtij ligji.

## Neni 16

### **Produktet dhe substancat që përdoren në bujqësinë biologjike dhe kriteret për përdorimin e tyre**

1. Në prodhimin biologjik përdoren produktet dhe substancat, sipas një liste të përcaktuar, për këto qëllime:

- a) si produkte për mbrojtjen e bimëve;
- b) si plehra dhe përmirësues të tokës;
- c) si lëndë të para jobiologjike për ushqim për kafshë, të cilat janë me origjinë bimore, shtazore e minerale, dhe substanca të caktuara, që përdoren në ushqyerjen e kafshëve;
- ç) si aditivë në ushqimin për kafshë dhe ndihmës në përpunim;
- d) si produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e pellgjeve, kafazeve, ndërtesave dhe pajisjeve për prodhimin shtazor;
- dh) si produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe pajisjeve që përdoren në prodhimin bimor, përfshirë edhe ruajtjen në fermën bujqësore.

2. Lista e produkteve dhe substancave, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Përdorimi i produkteve dhe substancave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet sipas përcaktimeve në kreun II, si dhe kriterëve të përgjithshme e të veçanta, si më poshtë:

a) përdorimi i tyre është i nevojshëm për prodhimin e qëndrueshëm dhe i domosdoshëm për çfarë synohet;

b) të gjitha produktet dhe substancat janë me origjinë bimore, shtazore, mikrobike, minerale, përveçse kur këto produkte ose substanca, nga burime të tilla, nuk gjenden në sasi të mjaftueshme ose me cilësinë e duhur, si dhe kur nuk gjenden alternativa të tjera;

c) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, zbatohen këto rregulla:

i) përdorimi i tyre është i domosdoshëm për luftimin e organizmave të dëmshëm, të një sëmundjeje të veçantë, për të cilën nuk ka alternativa të tjera biologjike, fizike, ose nga seleksionimi, praktika kultivimi, praktika të tjera menaxhimi të efektshme;

ii) nëse produktet nuk janë me origjinë bimore, shtazore, mikrobike ose minerale dhe nuk janë identike me formën e tyre natyrore, ato mund të përdoren vetëm nëse si kusht për përdorimin e tyre vendoset mënjanimi i çdo kontakti të drejtpërdrejtë me pjesët e ngrënshme të bimës;

ç) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i tyre është i domosdoshëm për të rritur, ruajtur pjellorinë e tokës, përmbushur kërkesat e veçanta të ushqyerit të bimëve ose për qëllime të veçanta, për përmirësimin e tokës;

d) në rastin e produkteve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, zbatohen këto kërkesa:

i) të jenë të domosdoshme për ruajtjen e shëndetit të mirëqenies e vitalitetit të kafshëve dhe të kontribuojnë në një dietë të përshtatshme, duke plotësuar nevojat fiziologjike e të sjelljes së specieve në fjalë, ose në rast se këto ushqime për kafshë nuk mund të prodhohen apo ruhen pa përdorimin e këtyre substancave;

ii) ushqimi për kafshë me prejardhje minerale, oligoelementet, vitaminat ose provitaminat të jenë me origjinë natyrore dhe, në rast se këto substanca nuk mund të sigurohen në prodhimin biologjik, mund të përdoren substanca me efekte kimikisht analoge, të mirëpërcaktuara.

## Neni 17

### **Rregullat për prodhimin në kalim**

Fermtat, në të cilat ka filluar prodhimi biologjik, duhet të zbatojnë këto rregulla:

a) periudha e kalimit fillon sa më parë, kur operatori ka njoftuar për aktivitetin e tij autoritetin kompetent dhe e ka bërë fermën e tij subjekt të sistemit të kontrollit, në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 36, të këtij ligji;

b) gjatë periudhës së kalimit zbatohen të gjitha rregullat e përcaktuara në këtë ligj;  
c) periudhat e kalimit përcaktohen në bazë të llojit të kulturës bujqësore apo prodhimit shtazor;

ç) në një fermë ose njësi pjesërisht me prodhim biologjik dhe pjesërisht me prodhim në kalim drejt prodhimit biologjik, operatori mban të ndara produktet e prodhuara në mënyrë biologjike nga ato në kalim drejt prodhimit biologjik, edhe kafshët mbahen të ndara ose lehtësisht të ndara, dhe mban dokumentacionin përkatës për këtë ndarje;

d) për të përcaktuar periudhën e kalimit, të përmendur më lart, mund të merret parasysh edhe një periudhë përpara datës së fillimit të periudhës së kalimit, nëse mund të vërtetohet prania e kushteve të caktuara;

dh) kafshët dhe produktet shtazore, të prodhuara gjatë periudhës së kalimit, të përcaktuar në shkronjën “c”, të këtij neni, nuk tregtohen me treguesit për etiketimin dhe reklamën e produkteve të përcaktuara në nenet 25 dhe 26, të këtij ligji.

#### Neni 18

### **Rregulla të hollësishme për prodhimin, përpunimin, ambalazhimin, transportin dhe ruajtjen**

Rregullat e hollësishme për prodhimin blegtoral, prodhimin e specieve nën akuakulturë dhe për prodhimin në kalim, sipas neneve 14, 15 e 17, të këtij ligji, dhe rregullat për grumbullimin, paketimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve organike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

#### SEKSIONI 3

### **PRODHIMI I USHQIMEVE TË PËRPUNUARA PËR KAFSHË**

#### Neni 19

### **Rregullat e përgjithshme për prodhimin e ushqimeve të përpunuara për kafshë**

1. Prodhimi i ushqimeve të përpunuara për kafshë bëhet i ndarë në kohë ose hapësira të ndryshme nga prodhimi i ushqimeve të përpunuara jobiologjike për kafshë.

2. Në përbërjen e ushqimeve biologjike për kafshë nuk përzihen lëndë të para ushqimore biologjike apo nga prodhimi në kalim me lëndë të para ushqimore të prodhuara me metoda jobiologjike.

3. Nuk lejohet përdorimi i tretësve të sintetizuar kimikisht në lëndët e para apo në ushqimet e përpunuara për kafshë.

4. Nuk lejohet përdorimi i substancave dhe teknikave për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit e ruajtjes së ushqimeve biologjike për kafshë, ose për të korrigjuar pasojat të pakujdesive gjatë përpunimit apo, nga ana tjetër, që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të këtyre produkteve.

#### SEKSIONI 4

### **PRODHIMI I USHQIMEVE TË PËRPUNUARA**

#### Neni 20

### **Rregulla të përgjithshme për prodhimin e ushqimeve të përpunuara**

1. Përgatitja e ushqimeve biologjike të përpunuara kryhet e ndarë në kohë ose në hapësira të ndryshme nga ushqimet jobiologjike.

2. Për përbërjen e ushqimeve biologjike të përpunuara plotësohen këto kushte:

a) produkti prodhohet kryesisht nga përbërës me prejardhje bujqësore. Për të përcaktuar nëse produkti është prodhuar kryesisht nga përbërës me prejardhje bujqësore nuk merren parasysh uji dhe kripa e gjellës, që shtohen gjatë përgatitjes;

b) në produktet ushqimore mund të përdoren vetëm aditivë, ndihmës të përpunimit, aromatizues, ujë, kripë, preparate me bazë mikroorganizmash e enzimash, lëndë minerale, oligoelemente, vitamina, aminoacide e mikrolëndë të tjera ushqyese, që përdoren në ushqime për përdorime të veçanta, vetëm nëse përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji;

c) përbërësit me prejardhje nga bujqësia jobiologjike përdoren vetëm nëse përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji;

ç) një përbërës biologjik nuk duhet të jetë i pranishëm bashkë me të njëjtin përbërës jobiologjik ose një përbërës që vjen nga bujqësia në kalim;

d) ushqimet e prodhuara nga kulturat bujqësore në kalim duhet të përmbajnë vetëm një përbërës bimor me prejardhje bujqësore.

3. Nuk lejohet të përdoren substanca e teknika për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit dhe ruajtjes së ushqimit biologjik ose për të korrigjuar pakujdesi gjatë përpunimit apo, nga ana tjetër, që mund të keqinformojnë për natyrën e vërtetë të këtyre produkteve.

#### Neni 21

### **Rregulla të përgjithshme në prodhimin e majave biologjike**

1. Për prodhimin e majave biologjike përdoren vetëm substrate të prodhuara në rrugë biologjike. Produkte dhe substanca të tjera përdoren vetëm nëse përcaktohen për t'u përdorur në prodhimin biologjik, sipas nenit 22 të këtij ligji.

2. Majaja jobiologjike nuk duhet të jetë e pranishme së bashku me majanë biologjike në ushqimin biologjik ose në ushqimin biologjik për kafshë.

#### Neni 22

### **Produktet dhe substancat e caktuara që përdoren në përpunimin e ushqimeve dhe kriteret e përdorimit të tyre**

1. Në prodhimin biologjik përdoren produktet dhe substancat që përfshihen në listën e produkteve dhe substancave të përcaktuara në shkronjat "b" e "c", të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji.

2. Lista e produkteve dhe substancave, të cilat mund të përdoren në përpunimin e ushqimeve sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Përdorimi i produkteve e substancave në prodhimin biologjik dhe përfshirja e tyre në listën e produkteve e substancave të përcaktuara në shkronjat "b" e "c", të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, bëhet sipas objektivave dhe parimeve të përcaktuara në kreun II dhe këtyre kriterëve:

a) nëse nuk ka alternativa të përcaktuara në përputhje me këtë kapitull;

b) nëse pa përdorimin e tyre është e pamundur të prodhohen apo ruhen ushqimet ose të plotësohen kërkesat e caktuara dietike, të vendosura në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Produktet dhe substancat e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, duhet të gjenden në natyrë dhe mund t'u jenë nënshtruar vetëm proceseve mekanike, fizike, biologjike, enzimatike ose mikrobike, përveç rasteve kur këto produkte dhe substanca, nga burime të tilla, nuk gjenden në treg në sasi ose cilësi të mjaftueshme.

## SESIONI 5 PËRSHTATSHMËRIA

Neni 23

### **Rregulla përjashtuese të prodhimit**

1. Në prodhimin biologjik, në kushte të veçanta, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëhen përjashtime nga rregullat e prodhimit, të përcaktuara nga seksionet 1 deri në 4, të këtij kreu.

2. Përjashtimet, sipas pikës 1, të këtij neni, zbatohen vetëm të kufizuara në kohë dhe për rastet e mëposhtme:

a) kur janë të nevojshme për të siguruar fillimin apo vazhdimësinë e prodhimit biologjik në ferma që përballen me kushtëzime klimatike, gjeografike ose strukturore;

b) kur janë të nevojshme për të siguruar furnizimin me ushqim për kafshë, farëra dhe material shumëzues vegjetativ, kafshë të gjalla e inpute të tjera bujqësore, kur inpute të tilla nuk gjenden në treg në formë biologjike;

c) kur janë të nevojshme për të siguruar furnizimin me përbërës me prejardhje bujqësore, kur këta përbërës nuk gjenden në treg në formë biologjike;

ç) kur janë të nevojshme për zgjidhjen e probleme specifike që lidhen me menaxhimin e blegtorisë biologjike;

d) kur, gjatë përpunimit, është e nevojshme të përdoren substanca dhe produkte specifike, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, për të siguruar qëndrueshmëri në prodhimin e produkteve ushqimore biologjike;

dh) kur janë të nevojshme masa të përkohshme për të lejuar vazhdimin e prodhimit biologjik ose rifillimin e tij në rast të situatave të jashtëzakonshme (kushtet meteorologjike, shpërthimi i sëmundjeve infektive, ndotja me substanca toksike ose zjarreve);

e) kur është i nevojshëm përdorimi i aditivëve ushqimorë e substancave të tjera, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 20, të këtij ligji, ose aditivëve të ushqimit për kafshë e substancave të tjera, sipas përcaktimit të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 16, të këtij ligji, dhe kur këto substanca nuk gjenden në treg, përveçse të prodhuara nga OMGJ-të;

ë) kur përdorimi i aditivëve ushqimorë dhe substancave të tjera, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 20, ose aditivëve të ushqimit për kafshë, sipas përcaktimit të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 16, të këtij ligji, përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 24

### **Rregulla të hollësishme dhe rregulla përjashtuese të prodhimit**

Rregullat e hollësishme për prodhimin e ushqimeve biologjike të përpunuara për kafshë, ushqimeve biologjike të përpunuara dhe majave biologjike, sipas neneve 19, 20 e 21, si dhe rregullat e hollësishme përjashtuese të prodhimit për çdo rast, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 23, të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

## KREU IV ETIKETIMI

Neni 25

### **Përdorimi i termave që i referohen prodhimit biologjik**

1. Për qëllim të këtij ligji, një produkt konsiderohet që i bart termat që i referohen metodave biologjike të prodhimit kur në etiketim, reklamë ose dokumente tregtare përbërësit e tij ose lëndët e para të ushqimit për kafshë përshkruhen me terma që informojnë konsumatorin se produkti, përbërësit e tij ose lëndët e para për ushqim për kafshë janë përfunduar në përputhje me rregullat e



përcaktuara në këtë ligj. Në veçanti, termi “biologjik” ose “organik” dhe shkurtime si “bio” dhe “eko” përdoren të vetme ose të kombinuara për etiketimin dhe reklamën e produkteve që plotësojnë kërkesat e këtij ligji. Në etiketimin dhe reklamën e produkteve bujqësore të gjalla ose të papërpunuara, termat që i referohen metodës biologjike të prodhimit përdoren vetëm nëse edhe të gjithë përbërësit e këtij produkti janë prodhuar sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Termat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk përdoren në etiketimin, reklamën dhe në dokumentet tregtare të produkteve që nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, përveçse kur ato nuk përdoren për produkte bujqësore ushqimore ose për ushqime për kafshë apo kur ato nuk kanë asnjë lidhje me prodhimin biologjik. Në etiketimet apo reklamën e prodhimit biologjik nuk përdoren terma, përfshirë edhe termat që përdoren në markat tregtare, praktikën që mund të keqinformojnë konsumatorin ose përdoruesin, duke sugjeruar se një produkt ose përbërësi i tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Termat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk përdoren për një produkt, për të cilin tregohet në etiketë ose reklamë se përmban OMGJ, përbëhet nga OMGJ ose prodhohet nga OMGJ, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për ushqimet e përpunuara, termat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përdoren:

a) në emërtimin e produkteve për shitje, me kusht që:

i) ushqimet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji;

ii) të paktën 95 për qind e peshës së përbërësve të tij me prejardhje bujqësore të jenë biologjike.

b) vetëm në listën e përbërësve, me kusht që ushqimi të jetë në përputhje me nenin 20, pikat 1 e 2, shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të këtij ligji;

c) në listën e përbërësve dhe në të njëjtën fushëpamje me përshkrimin e produktit për shitje, me kusht që:

i) përbërësi kryesor të jetë një produkt gjuetie ose peshkimi;

ii) të përmbajë përbërës të tjerë me prejardhje bujqësore, të cilët janë të gjithë biologjike;

iii) ushqimi të plotësojë kërkesat e nenit 20, pika 1 e 2, shkronjat “a”, “b” e “ç”, të këtij ligji.

5. Lista e përbërësve tregon se cilët përbërës janë biologjike. Në rastet kur zbatohen shkronjat “b” e “c”, të pikës 4, të këtij neni, referimet ndaj metodës së prodhimit biologjik vendosen vetëm për përbërësit biologjike dhe lista e përbërësve përfshin treguesin e përqindjes së përgjithshme të përbërësve biologjike në raport me sasinë e përgjithshme të përbërësve me prejardhje bujqësore. Termat dhe treguesi i përqindjes, të përmendura më sipër, paraqiten me shkronja me të njëjtën ngjyrë, madhësi e formë shkrimi si treguesit e tjerë në listën e përbërësve.

## Neni 26

### **Treguesit e detyrueshëm të etiketimit**

1. Kur përdoren termat, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 25, të këtij ligji, duhet që:

a) në etiketë të vendoset edhe emri dhe numri me të cilët është miratuar trupa e kontrollit, subjekt i së cilës ka qenë operatori që ka kryer prodhimin ose përgatitjen e fundit;

b) në ambalazhin e ushqimeve të paraambalazhura duhet të vendoset dukshëm logoja kombëtare, e përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 27, të këtij ligji;

c) krahas logos kombëtare, në të njëjtin pozicion, vendoset edhe një tregues i vendit ku janë kultivuar lëndët e para bujqësore, prej të cilave përbëhet produkti dhe, sipas rastit, në një nga format e mëposhtme:

i) “Bujqësi shqiptare”, kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në Shqipëri;

ii) “Bujqësi joshqiptare”, kur lënda e parë bujqësore është kultivuar në vende të tjera;

iii) “Bujqësi shqiptare/joshqiptare”, kur një pjesë e lëndëve të para bujqësore janë kultivuar në Shqipëri dhe një pjesë në një vend tjetër.

2. Treguesi “shqiptare/joshqiptare”, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, mund të zëvendësohet ose plotësohet me vendin, në rastin kur të gjitha lëndët e para bujqësore, nga i cili përbëhet produkti, janë kultivuar në atë vend. Për treguesin “Bujqësi shqiptare/joshqiptare”, sasinë e vogla në peshë të

përbërësve nuk merren parasysh kur sasia e përgjithshme e këtyre përbërësve nuk kalon 2 për qind të peshës së përgjithshme të përbërësve me prejardhje bujqësore.

Treguesi “shqiptare/joshqiptare” nuk duhet të paraqitet me shkronja me ngjyra, përmasa dhe stil që e bëjnë më të dukshëm, krahasuar me emërtimin për shitje të produktit.

3. Treguesi i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset në një vend të dukshëm, që të shihet lehtësisht, të lexohet qartësisht dhe të mos fshihet.

#### Neni 27

### **Logot e prodhimit biologjik**

1. Logoja kombëtare e prodhimit biologjik përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamat e produkteve që përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Logoja nuk përdoret në rastin e produkteve dhe ushqimeve në kalim dhe të ushqimeve sipas përcaktimit në shkronjat “b” e “c”, të pikës 4, të nenit 25, të këtij ligji.

2. Krahas logos kombëtare në etiketimin, paraqitjen dhe reklamat e produkteve që përmbushin kërkesat e këtij ligji, mund të përdoren edhe logo të tjera private.

#### Neni 28

### **Kërkesat e veçanta të etiketimit**

Rregullat e veçanta për etiketimin dhe përmbajtjen e tij zbatohen për produktet e mëposhtme:

- a) ushqimin biologjik për kafshë;
- b) produktet me origjinë bimore në kalim;
- c) materialin shumëzues vegjetativ dhe farërat për kultivim.

#### Neni 29

### **Rregulla të hollësishme për etiketimin**

Rregullat e hollësishme për etiketimin, paraqitjen, përbërjen dhe përmasat e treguesve të detyrueshëm të etiketimit, sipas neneve 25, 26 e 28, dhe rregullat për përbërjen, paraqitjen, madhësinë dhe dizenjimin e logos kombëtare për prodhimin biologjik, sipas nenit 27, të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

## KREU V

### KONTROLLET

#### Neni 30

### **Sistemi i kontrollit**

1. Ky ligj përcakton sistemin e kontrollit, autoritetin kompetent dhe autoritetet përgjegjëse për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit.

2. Sistemi i kontrollit, përveç kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin zyrtar të ushqimit, duhet, të paktën, të zbatojë masat parandaluese dhe të kontrollit për prodhimet biologjike, të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.

3. Natyra dhe shpeshtësia e kontroleve përcaktohen bazuar në vlerësimin e rrezikut të shfaqjes së parregullsive dhe shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në këtë ligj.

4. Të gjithë operatorët, me përjashtim të operatorëve të tregimit me shumicë, që tregtojnë vetëm produkte të paraambalazuara dhe operatorët, të cilët u tregtojnë konsumatorëve të fundit ose përdoruesve, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 34, të këtij ligji, i nënshtrohen sistemit të kontrollit për respektimin e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj, të paktën, një herë në vit.

5. Sistemi i kontrollit siguron gjurmueshmërinë për çdo produkt, në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ushqimin, që të garantojë konsumatorët se produktet biologjike janë prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

#### Neni 31

### Trupat e kontrollit

1. Trupat e kontrollit kryejnë inspektimin dhe certifikimin e operatorëve të prodhimit biologjik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

2. Trupat e kontrollit miratohen vetëm nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe, në veçanti, kur:

a) ka një përshkrim të saktë të detyrave që kryen trupa e kontrollit dhe kushteve në të cilat mund t'i kryejë ato;

b) është e provuar që trupa e kontrollit:

i) zotëron përvojën, pajisjet dhe infrastrukturën e duhur për të kryer këto detyra;

ii) ka numër të mjaftueshëm personeli me kualifikimin dhe përvojën e duhur;

iii) është e paanshme dhe nuk ka konflikt interesi për të ushtruar këtë detyrë.

c) trupa e kontrollit është e akredituar në përputhje me standardin ISO/IEC 17065 për fushën e këtij ligji;

ç) ka një procedurë standarde për kontrollin që duhet të ndiqet, e cila përmban një përshkrim të detajuar të masave të kontrollit dhe masave paraprake, që trupa ushtron ndaj operatorëve nën kontrollin e saj;

d) ka një procedurë masash që ndërmerr trupa e kontrollit në rastet e parregullsisve dhe/ose shkeljeve të përcaktuara në katalogun e sanksioneve, bazuar në standardin ISO/IEC 17065.

3. Trupa e kontrollit duhet të sigurojë që:

a) kontrollet e kryera të jenë objektive, të pavarura dhe efektive;

b) të zbatohen masa korigjuese kur gjendet një parregullsi apo shkelje tek operatori.

4. Trupat e kontrollit i lejojnë autoritetit kompetent hyrjen në zyrat dhe ambientet e tyre dhe i sigurojnë çfarëdolloj informacioni dhe ndihme që konsiderohet e nevojshme.

5. Trupa e kontrollit i paraqet rregullisht autoritetit kompetent rezultatet e kontrolleve të kryera dhe sa herë që i kërkohet. Nëse rezultatet e kontrolleve tregojnë parregullsi, mospërputhje apo dyshim për parregullsi, të cilat cenojnë statusin e produktit biologjik, trupa e kontrollit duhet të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent, i cili merr masat e nevojshme.

6. Çdo vit, jo më vonë se data 31 janar, trupat e kontrollit i paraqesin autoritetit kompetent listën e operatorëve të kontrolluar prej tyre deri më 31 dhjetor të vitit të mëparshëm dhe, brenda datës 31 mars të çdo viti, raportin vjetor të aktiviteteve të kontrollit, të kryera gjatë vitit të mëparshëm.

7. Trupat e kontrollit nuk mund të kryejnë funksionet e mëposhtme:

a) mbikëqyrjen dhe auditimin e trupave të tjera të kontrollit;

b) kompetencën për të përcaktuar përjashtime, sipas nenit 23, të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet në kushte të veçanta, të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji.

8. Kriteret dhe procedurat e hollësishme të miratimit të trupave të kontrollit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

#### Neni 32

### Miratimi dhe mbikëqyrja e trupave të kontrollit

1. Në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë ngrihet dhe funksionon Komisioni për Prodhimin Biologjik (KPB), i cili është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit.

2. Në ministri ngrihet njësi për prodhimin biologjik, e cila kryen mbikëqyrjen e trupave të kontrollit për llogari të KPB-së dhe i raporton atij.

3. Përbërja, funksionimi, organizimi dhe detyrat e KPB-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

#### Neni 33

### **Rregullat e hollësishme për kontrollin**

Rregullat e hollësishme për kontrollin e produkteve biologjike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

#### Neni 34

### **Përfshirja në sistemin e kontrollit**

1. Çdo operator që prodhon, përgatit, ruan, importon ose eksporton nga/në një vend tjetër produktet e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji, ose tregton këto produkte, përpara vendosjes në treg të produktit biologjik apo në kalim drejt produktit biologjik duhet:

- a) të njoftojë aktivitetin e tij pranë autoritetit kompetent;
- b) t'ia nënshtrojë aktivitetin e tij sistemit të kontrollit, të përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji.

2. Në rastet kur operatori i nënkontraktton një aktivitet një pale të tretë, nënkontraktori duhet të zbatojë kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

3. Përrjashtohen nga zbatimi i këtij neni operatorët që i shesin produktet direkt te konsumatori ose përdoruesi i fundit, me kusht që të mos prodhojnë, përgatisin, magazinojnë, importojnë produkte të tilla nga një vend tjetër dhe që nuk kanë kontraktuar aktivitete të tilla për një palë të tretë.

4. Njësia e prodhimit biologjik pranon njoftimet dhe mban regjistrin e operatorëve të prodhimit biologjik.

5. Autoriteti kompetent siguron që çdo operator, i cili i përmbush kërkesat e këtij ligji dhe kryen pagesën ndaj trupës së kontrollit për kontrollin dhe procedurën e certifikimit, të përfshihet në sistemin e kontrollit për certifikim.

6. Trupat e kontrollit mbajnë një listë të përditësuar, e cila përmban emrat dhe adresat e operatorëve që kontrollohen prej tyre. Kjo listë duhet të publikohet në internet, që të jetë në dispozicion të palëve të interesuara.

#### Neni 35

### **Certifikata e operatorit**

1. Trupat e kontrollit, të përcaktuara sipas nenit 31, të këtij ligji, i lëshojnë certifikatën çdo operatori të kontrolluar prej tyre, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Certifikata duhet të përmbajë të dhënat për identifikimin e operatorit, llojin ose gamën e produkteve, si dhe periudhën e vlefshmërisë.

2. Operatori duhet të verifikojë certifikatën e operatorit që e furnizon atë.

#### Neni 36

### **Rregullat për njoftimin e aktivitetit**

Rregullat e detajuara për procedurën e njoftimit të aktivitetit nga operatorët, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 34, dhe forma e certifikatës së operatorit, sipas nenit 35, të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

## KREU VI

### TREGTIA ME VENDET E TJERA

#### Neni 37

### **Rregullat e importit të produkteve biologjike**

1. Një produkt biologjik, i prodhuar në një vend tjetër, vendoset në tregun e vendit tonë nëse importuesi, i cili ka njoftuar aktivitetin e tij, sipas nenit 34, të këtij ligji, siguron që ky produkt është prodhuar në përputhje me rregullat ekuivalente.

2. Produktet e certifikuara nga trupa e kontrolli të vendeve anëtare të Bashkimit European ose të njohura si ekuivalente nga Komisioni European, konsiderohen ekuivalente, në kuadër të këtij ligji.

3. Rregullat e hollësishme dhe kushtet për importin e produkteve biologjike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

## KREU VII INFORMIMI

Neni 38

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Për të garantuar se një produkt është prodhuar në përputhje me këtë ligj, autoriteti kompetent, komisioni i prodhimit biologjik, trupat e kontrollit dhe autoriteti kombëtar i ushqimit duhet të shkëmbejnë informacionet për rezultatet e kontrolleve të kryera, sa herë të jetë e nevojshme.

Neni 39

### **Informacioni statistikor**

1. Informacioni statistikor vjetor për prodhimin biologjik mblidhet dhe përpunohet nga sektori i statistikës në ministri dhe dërgohet për publikim në INSTAT.

2. Treguesit statistikorë për prodhimin biologjik përcaktohen sipas programit statistikor zyrtar. Forma dhe përmbajtja e informacionit statistikor përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

## KREU VIII KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE MASAT

Neni 40

### **Kundërvajtjet**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative.

2. Nëse gjatë procesit të prodhimit të produkteve biologjike operatorët biologjikë shkelin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, trupat e kontrollit ndërmarrin masat, sipas katalogut të sanksioneve.

3. Përveç masave, sipas pikës 2, të këtij neni, në rastet e shkeljeve të rënda ose me ndikim të zgjatur, merren edhe këto masa:

a) kur në prodhimin biologjik përdoren produkte dhe substanca që nuk përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 16, të këtij ligji, produkti nuk certifikohet si biologjik;

b) në rast konstatimi të kontaminimit të produktit, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “nj”, të nenit 3, të këtij ligji, produkti nuk certifikohet si biologjik;

c) në rastin e gjetjes së një mashtrimi nga operatori, trupa e kontrollit i heq certifikatën operatorit;

ç) në rast se operatori përsërit mbi dy herë shkeljet, të cilat cenojnë statusin biologjik të produktit, operatorit i hiqet certifikata dhe nuk ka të drejtë aplikimi për një periudhë 12-mujore, nga data e heqjes së saj.

4. Trupës së kontrollit i hiqet miratimi kur:

a) nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 31, të këtij ligji;

b) nuk vazhdon të përmbushë kriteret e miratimit, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji;

c) nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 31, të këtij ligji.

Neni 41

### **Ankimi**

1. Kundër masave të përcaktuara në nenin 40, të këtij ligji, mund të bëhet ankim me shkrim tek autoriteti kompetent, brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni për masën e vendosur.

2. Autoriteti kompetent duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

3. Ekzekutimi i vendimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

## KREU IX

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 42

### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim neneve 13, 18, 24, 29, 31, 32, 33, 36 dhe 37, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, 16, 22 dhe 39, të këtij ligji.

Neni 43

### **Dispozita kalimtare**

1. Deri në miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 9199, datë 26.2.2004, "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio"", për sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

2. Produktet dhe substancat e përdorura sipas ligjit nr. 9199, datë 26.2.2004, "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio"", por që nuk përfshihen në listën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 16 dhe në pikën 2, të nenit 22, të këtij ligji, mund të vazhdojnë të përdoren edhe 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 44

### **Shfuqizimet**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9199, datë 26.2.2004, "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio"", të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 45

### **Hyrj**

**a në fuqi** Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit

në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën

27.10.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9840, datë 9.11.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

## LIGJ Nr.10 465, datë 29.9.2011

### PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Ky ligj është përafuar pjesërisht me: Direktivën 82/894/KEE të Këshillit, datë 21 Dhjetor 1982 "Mbi njoftimin e sëmundjeve të kafshëve brenda Komunitetit". Numri CELEX: 31982L0894, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 378, datë 31. 12. 1982, faqe 58 - 62.

Direktivën e Këshillit 86/609/KEE, datë 24 Nëntor 1986 "Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me mbrojtjen e kafshëve që përdoren për qëllime eksperimentale dhe për qëllime të tjera shkencore", CELEX 31986L069, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 358, datë 18. 12. 1986, faqe 1 - 28.

Direktivën 90/425/KEE të Këshillit, datë 26 Qershor 1990 "Mbi kontrollin veterinar dhe zooteknike që zbatohen në tregtinë brenda Komunitetit të disa lloje kafshësh të gjalla dhe produktet e tyre me qëllim plotësimin e tregut të brendshëm". Numri CELEX: 31990L0425, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 224, datë 18. 8. 1990, faqe 29 - 41.

Direktivën 91/496/KEE të Këshillit, datë 15 Korrik 1991 "Mbi vendosjen e parimeve që rregullojnë organizimin e kontrolleve veterinarë për kafshët që hyjnë në Komunitet nga vendet e treta". Numri CELEX: 31991L0496, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 268, datë 24. 9. 1991, faqe 56 - 68. Direktivën 92/119/KEE të Këshillit, datë 17 Dhjetor 1992 "Mbi masat e përgjithshme të Komunitetit për kontrollin e disa sëmundjeve të kafshëve dhe masat specifike lidhur me sëmundjen vezikulare të derrit". Numri CELEX: 31992L0119, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 62, datë 15. 3. 1993, faqe 69 - 85.

Direktivën 93/119/KE të Këshillit, datë 22 Dhjetor 1993 "Për mbrojtjen e kafshëve në kohën e therjes apo eliminimit". Numri CELEX: 31993L0119, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 340, datë 31. 12. 1993, faqe 21 - 34.

Direktiva 96/23/KE e Këshillit, datë 29 Prill 1996, "Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore", Numri CELEX: 31996L023, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 125, datë 23. 5. 1996, faqe 10 - 32.

Direktivën 97/78/KE të Këshillit, datë 18 Dhjetor 1997 "Mbi parimet e organizimit të kontrollit veterinar mbi produktet që hyjnë në Komunitet nga vendet e treta". Numri CELEX: 31997L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 24, datë 30. 1. 1998, faqe 9 -30.

Direktivën 98/58/KE të Këshillit, datë 20 Korrik 1998 "Mbi Mbrojtjen e Kafshëve të mbajtura për qëllime blegtorale". Numri CELEX: 31998L0058, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 221, datë 8. 8. 1998, faqe 23 - 27.

Direktivën 2001/82/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 Nëntor 2001 "Mbi Kodin e Komunitetit për Produktet Mjekësore Veterinare". Numri CELEX: 32001L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 311, datë 28. 11. 2001, faqe 1 - 66. Direktivën 2002/32/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 Maj 2002 "Mbi substancat e padëshiruara në ushqimin e kafshëve". Numri CELEX: 32002L0032, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 140, datë 30. 5. 2002, faqe 10 - 22.

Direktivën 2002/99/KE të Këshillit, datë 16 Dhjetor 2002 "Mbi vendosjen e rregullave për shëndetin e kafshëve lidhur me prodhimin, përpunimin, shpërndarjen dhe prezantimin e prodhimeve me origjinë shtazore për përdorim njerëzor". Numri CELEX: 32003L0099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 18, datë 23. 1. 2003, faqe 11 - 20.

Direktivën 2003/99/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 Nëntor 2003 "Mbi monitorimin e zoonozave dhe agjentëve zoonotik". Numri CELEX: 32003L0099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 325, datë 12. 12. 2003, faqe 31 - 40.

Direktivën 2006/88/KE të Këshillit, datë 24 Tetor 2006 "Mbi kërkesat e shëndetit të kafshëve të akuakulturës dhe produkteve të tyre, si dhe parandalimin dhe kontrollin e disa sëmundjeve në kafshët ujore". Numri CELEX: 32006L0088, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 328, datë 24. 11. 2006, faqe 14 - 56. Rregulloren 999/2001/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 Maj 2001 "Mbi vendosjen e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrënjosjen të disa encefalopative sponzhiforme të transmetueshme". Numri CELEX: 32001R0999, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 147, datë 31. 5. 2001, faqe 1 - 40.

Rregulloren 178/2002/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 28 Janar 2002 "Mbi vendosjen e parimeve të përgjithshme dhe kërkesave të legjislacionit të ushqimit, ngritjen e Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore dhe mbi vendosjen e procedurave për çështjet e sigurisë ushqimore". Numri CELEX: 32002R0178, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 31, datë 1. 2. 2002, faqe 1 - 24.

Rregulloren 1831/2003/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Këshillit, datë 22 Shtator 2003 "Mbi aditivët për përdorim në ushqimet e kafshëve". Numri CELEX: 32003R1831, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 268, datë 18. 10. 2003, faqe 29 - 43.

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

### **VENDOSI:**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të mbrojë dhe të përmirësojë shëndetin e kafshëve të tokës dhe të ujit.
2. Të përcaktojë procedurat për parandalimin, monitorimin, diagnostikimin, trajtimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve.
3. Të mbrojë shëndetin publik nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët, si dhe nga lëndët mbetëse të dëmshme, të cilat gjenden në produktet për konsum publik.
4. Të sigurojë zbatimin e masave shëndetësore veterinarë për produktet me origjinë shtazore, të prodhuara në fermë, lëndët e papërpunuara, kullotat, ujin dhe vendet e pirjes së ujit për kafshët.
5. Të mbrojë shëndetin riprodhues të kafshëve, të sigurojë rritjen e prodhimit dhe përmirësimin racor.

---

Rregulloren 21/2004/KE të Këshillit, datë 17 Dhjetor 2003 "Mbi vendosjen e një sistemi identifikimi dhe regjistrimi të kafshëve dhen dhe dhi". Numri CELEX: 32004R0021, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 5, datë 9. 1. 2004, faqe 8 - 17.

Rregulloren 853/2004/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill 2004 "Mbi vendosjen e rregullave specifike për higjienën e ushqimeve me origjinë shtazore". Numri CELEX: 32004R0853, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 139, datë 30. 4. 2004, faqe 55 - 205.

Rregulloren 854/2004/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill 2004 "Mbi vendosjen e rregullave specifike për organizimin e kontroleve zyrtare mbi produktet me origjinë shtazore të destinuar për konsum human". Numri CELEX: 32004R0854, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 139, datë 30. 4. 2004, faqe 206 - 320.

Rregulloren 882/2004/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill 2004 "Mbi kontrollet zyrtare të ndërmarra për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe rregullat e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve". Numri CELEX: 32004R0882, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 165, datë 30. 04. 2004, faqe 1 - 141.

Rregulloren 1/2005/KE të Këshillit, datë 22 Dhjetor 2004 "Mbi mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit dhe lëvizje të tjera". Numri CELEX: 32005R0001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 3, datë 5. 1. 2005, faqe 1 - 44.

Rregulloren 1198/2006/KE të Këshillit, datë 27 Korrik 2006 "Mbi Fondin Evropian të Peshkimit". Numri CELEX: 32006R1198, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 223, datë 15. 8. 2006, faqe 1 - 44.

Rregulloren 834/2007/KE të Këshillit, datë 28 Qershor 2007 "Mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, e cila shfuqizon Rregulloren 2092/91". Numri CELEX: 32007R0834, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 189, datë 20. 07. 2007, faqe 1 - 23.

Rregulloren 1099/2009/KE të Këshillit, datë 24 Shtator 2009 "Mbi mbrojtjen e kafshëve në kohën e therjes". Numri CELEX: 32009R1099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 303, datë 18. 11. 2009, faqe 1 - 30.



6. Të mbrojnë mjedisin nga infeksionet, helmet, mbeturinat e kafshëve dhe ndotjet (biologjike, fizike, kimike, radiobiologjike), me pasoja dëmtuese për shëndetin e kafshëve dhe njerëzit.
7. Të përcaktojnë procedurat e trajnimit dhe të informimit në fushën e veterinarisë për veterinerët, pronarët apo kujdestarët e fermave të kafshëve dhe publikun.
8. Të mbrojnë kafshët nga tortura dhe të sigurojnë mirëqenien e tyre.
9. Të mbrojnë kafshët e egra.
10. Të sigurojnë asgjësimin e sigurt të kafshëve të ngordhura, kadavrave, konfiskateve, mbeturinave të kafshëve dhe produkteve të kafshëve, jo për konsum njerëzor.
11. Të përcaktojnë detyrimet e fermerëve, të personave fizikë dhe juridikë, në zbatimin e këtij ligji.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Ky ligj ka për objekt:

1. Përcaktimin e parimeve bazë për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, sipas standardeve ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE) dhe të Bashkimit Evropian;
2. Rregullimin, organizimin, financimin e shërbimit veterinar, përcaktimin e përgjegjësive, të rregullave dhe të procedurave të shërbimit veterinar në mbrojtje të shëndetit e mirëqenies së kafshëve;
3. Mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët, në përfaqje me legjislacionin e BE-së.

## **Neni 3**

### **Fusha e zbatimit të ligjit**

Ky ligj zbatohet nga të gjithë mjekët veterinarë, që kryejnë, mbikëqyrin, kontrollojnë veprimtarinë veterinare:

- a) në Shërbimin Veterinar Shtetëror;
- b) në institucione, struktura dhe ente të tjera publike;
- c) në shërbimin veterinar privat;
- ç) të pronarëve dhe të operatorëve të biznesit të mbarështimit të kafshëve.

## **Neni 4**

### **Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agjent zoonotik" është çdo virus, baktere, myk, parazit ose qenie tjetër biologjike që është në gjendje të shkaktojë një zoonozë.
2. "Akuakulturë" janë organizmat ujorë, që mbarështohen apo kultivohen, duke përdorur teknika, me qëllim rritjen e prodhimit mbi kapacitetin e tyre natyror në mjedis.
3. "Antimikrobikë" janë substancat e prodhuara në mënyrë sintetike ose natyrore dhe që përdoren për të vrarë apo për të penguar rritjen e mikroorganizmave, përfshirë këtu bakteret, viruset, myqet dhe protozoarët.
4. "Aplikim me qëllime zooteknike" është administrimi i produkteve dhe PMV-ve të certifikuara në kafshët prodhuese, me qëllim sinkronizimin e afshit dhe të dhuruesit, për mbarsjen e embrioneve të implantuara, si dhe në kafshët e akuakulturës, aplikimi i androgjenëve në grupet e peshqve, me synim ndërrimin e seksit.

5. "Autoriteti kompetent" është drejtoria përgjegjëse për shëndetin e kafshëve në ministri, e cila ka përgjegjësi dhe kompetencë në të gjithë territorin e vendit.
6. "Autoritet kompetent për PIK-në" është institucioni përgjegjës për administrimin dhe kontrollin në pikat e inspektimit kufitar.
7. "Autoriteti kompetent për sigurinë ushqimore" është autoriteti i përcaktuar si i tillë nga legjislacioni në fuqi për ushqimin dhe sigurinë ushqimore.
8. "Beta-agonist" është substanca agoniste e beta-adrenoceptorit.
9. "Certifikatë veterinarë" është certifikata e lëshuar në përputhje me dispozitat e nenit 55 të këtij ligji, si dhe të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit të OIE-së.
10. "Çrrënjosje" është eliminimi i agjentit patogjen nga një vend ose zonë.
11. "Dezinfektim" është zbatimi mbi gjallesa ose objekte pa jetë, që mund të jenë kontaminuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i metodave që synojnë të shkatërrojnë agjentët infektive të sëmundjeve të kafshëve, përfshi dhe zoonozat.
12. "Dezinfestim" është zbatimi i procedurave që synojnë eliminimin e artropodëve (rriqna, insekte etj.), të cilët mund të shkaktojnë sëmundje ose janë vektorë të mundshëm të agjentëve infektivë të sëmundjeve të kafshëve, përfshi dhe zoonozat.
13. "Dëmtues" është shkaktari biologjik, kimik ose fizik, në kafshë/produkte me origjinë shtazore ose gjendja e një kafshe/produkti me origjinë shtazore, që mund të shkaktojë një veprim të dëmshëm shëndetësor te kafsha ose njeriu.
14. "Eksperiment" është përdorimi i një ose disa kafshëve për qëllime të studimit shkencor, që mund t'i shkaktojë atyre dhimbje, vuajtje, ankth ose dëmtim të zgjatur dhe që përfshin çdo mënyrë të veprimit, të synuar ose të detyruar, që rezulton në krijimin e kushteve të tilla te një kafshë.
15. "Ekzaminim veterinar" është kontrolli mjekësor veterinar i kafshëve për verifikimin klinik, patologjik dhe laboratorik të sëmundjeve infektive.
16. "Eliminim" është çdo procedurë që shkakton ngordhjen e detyruar të një kafshe.
17. "Eliminim i detyruar" është eliminimi apo therja e urdhëruar nga veterineri, për shkak të ndonjë aksidenti, çrregullimi serioz fiziologjik ose funksional në gjendjen shëndetësore.
18. "Farmakopea veterinarë" është një përmbledhje që përmban udhëzime për përgatitjen e produkteve mjekësore veterinarë, e botuar nga një autoritet qeveritar i një vendi a bashkimi vendesh ose një shoqëri mjekësore apo farmaceutike.
19. "Fermë" është çdo ndërhyrje, strukturë ose, në rastin e rritjes së lirë, çdo mjedis, në të cilin mbahen, rriten ose trajtohen kafshët, përgjithnjë ose përkohësisht, me përjashtim të vendeve ku ushtrohet praktika veterinarë.
20. "Gjendje e rëndë epidemiologjike" është gjendja kur shfaqja dhe përhapja e sëmundjes infektive në kafshë ka përfshirë rajone të tëra të vendit, e shoqëruar me dëme të mëdha ekonomike.
21. "Identifikim i kafshës" është kombinimi i identifikimit dhe regjistrimit individual të një kafshe, me një kod të veçantë ose kolektiv në njësinë epidemiologjike apo grupin.
22. "Import/eksport" është hyrja dhe/ose dalja fizike e ngarkesave, që i nënshtrohen kontrollit veterinar në territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes pikave të miratuara të inspektimit kufitar.
23. "Importues/eksportues" është çdo person fizik ose juridik, që importon dhe/ose eksporton ngarkesa që i nënshtrohen kontrollit veterinar.
24. "Infeksion" është hyrja dhe zhvillimi ose shumimi i një agjenti infektiv në trupin e njeriut ose të kafshës.
25. "Izolim" është veçimi i kafshëve të infektuara ose të dyshuara si të infektuara në mjedise të

veçanta ose vend mbajtje kafshësh.

26. "Kafshë" janë gjitarët, shpendët, amfibët, zvarranikët, peshqit, molusqet, krustacët, vertebrorë ose jovertebrorë, që mbarështohen nga njerëzit për qëllime tregtare ose jotregtare ose që jetojnë të lira në natyrë.

27. "Kafshë bartëse e sëmundjes" është kafsha e infektuar, me apo pa shenja klinike, që mbart shkaktarin e sëmundjes dhe është burim i mundshëm për përhapjen e saj.

28. "Kafshë ferme" janë kafshët që mba rështohen, me qëllim prodhimin e ushqimit ose të produkteve të tjera me origjinë shtazore.

29. "Kafshë e ekspozuar" është kafsha në kontakt me kafshët e infektuara, që mund të preken lehtësisht nga shkaktari patogjen.

30. "Kafshë eksperimenti" janë kafshët që përdoren ose që do të përdoren në eksperimente.

31. "Kafshë ekzotike" janë kafshët që mbahen nga njeriu jo për qëllime tregtare, por që nuk konsiderohen si kafshë shoqërimi.

32. "Kafshë për therje" është një kafshë që do të theret brenda një kohe të shkurtër nën kontrollin e mjekut veterinar.

33. "Kafshë shoqërimi" janë kafshët që mbahen dhe rriten nga njeriu, në shtëpi, jo për qëllime përfitimi.

34. "Karkasë e kafshës" është trupi i një kafshe pas therjes dhe përgatitjes së mishit për tregtim dhe/ose përdorim.

35. "Karantinë" është masa profilaktike, që konsiston në izolimin e kafshëve që mbarështohen.

36. "Kodi Shëndetësor i Kafshëve të Tokës dhe të Ujit", kodi i miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve (OIE), ku përshkruhen masat shëndetësore që duhet të zbatohen nga autoritetet veterinare për të garantuar sigurinë shëndetësore të kafshëve të tokës dhe të ujit, si dhe të produkteve të tyre, duke shmangur kalimin e agjentëve patogjenë të kafshët ose njeriu.

37. "Koha e pezullimit" është koha e nevojshme, ndërmjet përdorimit të fundit të produktit mjekësor veterinar të kafshët e gjalla dhe prodhimit të ushqimeve nga kafshë të tilla, në mënyrë që ky ushqim të mos përmbajë mbetje në sasi mbi kufijtë maksimalë të lejuar e të përcaktuar.

38. "Koksidiostatikët dhe histomonostatikët" janë produktet mjekësore veterinare që përdoren për të vrarë apo për të ndaluar shumëzimin e protozoarëve.

39. "Konfirmim i sëmundjes" është deklarimi, prej autoritetit kompetent, i pranisë së një prej sëmundjeve të përcaktuara në listë, mbështetur në rezultatet e laboratorit, ndërkohë që në rast epizootie, autoriteti kompetent mund të konfirmojë praninë e sëmundjes, mbështetur në shenjat klinike dhe/ose rezultatet epidemiologjike.

40. "Kontejner" është një kuti jo-vetëlëvizëse ose arkë a strukturë tjetër e ngurtë, që nuk është një mjet transporti, e përdorur për transportin e kafshëve ose ushqimeve me origjinë shtazore gjatë një udhëtimit, me një ose disa mënyra transporti.

41. "Kontroll i identitetit" është kontrolli vizual/pamor për të siguruar përputhjen, ndërmjet dokumenteve ose certifikatave veterinare me shenjat e identifikimit të kafshëve ose etiketat dhe përmbajtjen e ngarkesës.

42. "Kontroll fizik" është kontrolli i kafshëve, i materialeve embrionale, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, i PMV-ve, si dhe i ushqimeve të medikuara për kafshë, që mund të përfshijë kontrollet e mjeteve të transportit, ambalazheve, etiketave dhe temperaturës, marrjes së kampioneve për analiza dhe provat laboratorike, si dhe ndonjë kontroll tjetër të nevojshëm për të verifikuar përputhjen me kërkesat e legjislacionit veterinar.

43. "Kontroll sanitaro-veterinar" është kontrolli i çdo aspekti të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, produkteve embrionale, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, dhe PMV-ve, për të verifikuar nëse ato janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit veterinar dhe të legjislacionit përushqimin në fuqi.
44. "Kontroll zyrtar" është monitorimi, mbikëqyrja dhe inspektimi që kryen autoriteti kompetent përkatës, për të verifikuar përputhshmërinë me legjislacionin veterinar.
45. "Kufiri maksimal i mbetjes" është përqendrimi maksimal i mbetjes, si pasojë e përdorimit të një PMV-je dhe aditivi në të ushqyerit e kafshës, i lejuar ligjërisht dhe i pranueshëm për të qenë në ushqimin për njerëz dhe/ose kafshë.
46. "Kufizim" është zbatimi mbi një kafshë i çdo procedure, që synon të kufizojë lëvizjet e saj.
47. "Laborator i akredituar" është laborator i cili ka kaluar një procedurë akreditimi nga një trupë kombëtare ose ndërkombëtare dhe njihet si kompetent për të kryer ekzaminime dhe analiza të përcaktuara.
48. "Laborator i autorizuar" është laborator i autorizuar për kryerjen e tipeve të analizave, të përcaktuara sipas nenit 121, të këtij ligji.
49. "Laboratori Kombëtar i Referencës" është laborator, i cili mbikëqyr laboratorët e tjerë në vend për aplikimin e standardeve dhe të metodave të kontrollit laboratorik, përpunimin e kampioneve standarde të referencës dhe kryerjen e ekzaminimeve ndërlaboratorike.
50. "Masë shëndetësore" është masa, që, sipas Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit, përcaktohet për të mbrojtur shëndetin ose jetën e kafshëve ose të njeriut brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rreziqet që vijnë nga hyrja, vendosja ose përhapja e një rreziku.
51. "Material patologjik" janë kampionet e marra për t'u dërguar në një laborator, nga kafshët e gjalla ose të ngordhura, që përmbajnë ose dyshohen se përmbajnë agjentë infektivë.
52. "Mbetje" është një mbetje e lëndëve me efekt farmakologjik të metaboliteve të tyre dhe të lëndëve të tjera, që kalojnë te produktet shta zore dhe që mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut.
53. "Mbeturinat me origjinë shtazore" janë përbërësit e pjesëve të trupit të kafshës, mbeturinat e nënprodukteve dhe materialet e padobishme me origjinë shtazore, që nuk mund të përdoren për konsum nga njerëzit.
54. "Mikroorganizma patogjenë" janë mikroorganizmat, të cilët, vetë ose përmes produkteve të veprimtarisë së tyre jetësore, shkaktojnë sëmundje në njerëz dhe/ose në kafshë.
55. "Ministri" është ministri përgjegjës që mbulon fushën e veterinarisë.
56. "Ministria" është ministria përgjegjëse që mbulon fushën e veterinarisë.
57. "Mirëqenie e kafshës" ka të bëjë me gjendjen në të cilën kafsha jeton, nëse është e shëndetshme, në gjendje të rehatshme, e mirushqyer, e sigurt, në gjendje të shprehë sjellje natyrale dhe nëse nuk vuan nga gjendje të papëlqyeshme, si frika, dhimbja e ankthi.
58. "Mish" janë të gjitha pjesët e ngrënshme të një kafshe.
59. "Mjek veterinar" është personi që ka përfunduar arsimin universitar në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, i regjistruar ose i licencuar nga trupa statusore veterinarë për të zbatuar praktikën mjekësore ose shkencore veterinarë në Republikën e Shqipërisë.
60. "Mjek veterinar i autorizuar" është mjeku veterinar i autorizuar nga autoriteti kompetent, pas miratimit nga trupa statusore veterinarë, për të kryer një ose disa detyra të veterinerit zyrtar.
61. "Mbikëqyrje" është mbledhja e vazhdueshme sistematike, shqyrtimi dhe analiza e informacionit që lidhet me shëndetin e kafshëve dhe shpërndarjen në kohë të informacionit atyre që duhet të dinë për marrjen e masave.

62. "Mbikëqyrje specifike" është mbikëqyrja e shënjestruar për një sëmundje ose infeksion të veçantë.
63. "Ndalim" është kombinimi i masave kufizuese të përkohshme në stabilimentet e mbarështimit të kafshëve, vendqëndrimet, territoret ku janë zbuluar sëmundje infektive të kafshëve, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga autoriteti kompetent veterinar.
64. "Nënprodukt shtazor" janë karkasat e kafshëve ose pjesë të tyre, ose produkte me origjinë shtazore, të cilat nuk janë për konsum njerëzor, si dhe vezët, sperma dhe embrionet.
65. "Nënpopulacion" është një pjesë e veçantë e një populacioni, e identifikuar duke u mbështetur në karakteristikat e përbashkëta të shëndetit të kafshëve.
66. "Ngarkesë" janë kafshët, produktet embrionale, produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, produktet mjekësore veterinare, produktet biologjike dhe materialet patologjike, të shoqëruara nga e njëjta certifikatë ose dokument veterinar, të transportuara me të njëjtat mjete transporti dhe që vijnë nga i njëjti vend ose rajon.
67. "Njësi epidemiologjike" është një grup kafshësh me një lidhje të përcaktuar epidemiologjike, të cilat ndajnë thuajse të njëjtën mundësi të ekspozimit ndaj një patogjeni, për arsye se ndajnë të njëjtin mjedis (p.sh. kafshët në një vathë) ose për shkak të praktikës së njëjtë të administrimit. Zakonisht një njësi epidemiologjike është një tufë ose kope, megjithatë mund t'i referohet edhe grupeve të kafshëve, që i përkasin banorëve të një fshati, ose kafshët, që ndajnë të njëjtin mjedis të përbashkët.
68. "Njësi e ndërzimit artificial" është njësia e miratuar nga autoriteti kompetent veterinar, që përmbush kushtet e përcaktuara në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të OIE-së, për mbledhjen, përpunimin ose ruajtjen e spermës.
69. "Njësi të shërbimit veterinar privat" janë personat fizikë ose juridikë, farmacitë veterinare, klinikat dhe spitalet veterinare, qendrat për riprodhimin dhe ndërzimin artificial e laboratorët veterinarë.
70. "Njësi e veçuar prodhimi" janë një ose më shumë stalla në një sistem të përbashkët të menaxhimit të biosigurisë, ku mbahet një nënpopullatë kafshësh me një gjendje të dallueshme shëndetësore, në lidhje me një sëmundje të veçantë, për të cilën janë zbatuar mbikëqyrje e kontrole dhe janë marrë masat e duhura të biosigurisë, sipas përcaktimeve për qëllime tregtie.
71. "Njoftim" është procedura, përmes së cilës autoriteti kompetent veterinar njofton zyrën qendrore të OIE-së ose zyra qendrore e OIE-së njofton autoritetin kompetent veterinar, për shfaqjen e një shpërthimi të sëmundjes ose infeksionit, në përputhje me Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit.
72. "Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve (OIE)" është organizata ndërqeveritare përgjegjëse për përmirësimin e shëndetit të kafshëve.
73. "Parti (malli)" është një sasi e përcaktuar e materialit primar, materialit paketues ose e produktit përfundimtar, që karakterizohet nga homogjeniteti i tij dhe është prodhuar në një proces ose një seri procesesh, nën të njëjtat kushte prodhimi ose një orari pune.
74. "Periudhë infektive" është periudha gjatë së cilës një kafshë e prekur mund të bëhet burim i infeksionit.
75. "Periudhë e inkubimit" është periudha më e gjatë që nevojitet ndërmjet hyrjes së patogjenit në kafshë ose ekspozimit ndaj shkaktarit të sëmundjes dhe shfaqjes së shenjave të para klinike të sëmundjes s.
76. "Periudhë rreziku" është periudha e shfaqjes dhe e pranisë së sëmundjes me pasoja të dëmshme në shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve.
77. "Pikë e daljes" është pika e inspektimit kufitar ose çdo vend tjetër i përcaktuar, nga e cila kafshët largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.
78. "Pikë grumbullimi për kafshët" janë vende të tilla, si fermat, pikat e grumbullimit dhe tregjet, ku grumbullohen kafshë nga ferma të ndryshme, me qëllim krijimin e një grupi të madh kafshësh për të formuar ngarkesa.

79. "Pikë e inspektimit kufitar" është çdo aeroport ose port, pikë kontrolli në tokë ose stacion hekurudhor, e përcaktuar dhe miratuar nga ministri, për kryerjen e kontroleve veterinarë për ngarkesat që mbërrijnë në kufirin e territorit të Republikës së Shqipërisë.
80. "Pikë pushimi" është vendi ku ndërpritet udhëtimi për të pushuar, për të ushqyer ose për t'i dhënë për të pirë kafshëve, të cilat mund të qëndrojnë në mjete ose të shkarkohen për këtë qëllim.
81. "Plan kontingjence" është një plan i hollësishëm, i hartuar për kontrollin dhe luftimin e një sëmundjeje infektive, të përcaktuar në listën përkatëse për kafshët.
82. "Plan kontrolli" është përshkrimi i hartuar nga autoriteti kompetent, i cili përmban informacionin e përgjithshëm për strukturën dhe organizimin e sistemeve të tij të kontrollit zyrtar.
83. "Plan kualifikimi" është plani i hartuar nga autoriteti kompetent, për trajnimin e mjekëve veterinarë, teknikëve veterinarë, kujdestarëve të kafshëve, për njohjen e sëmundjeve infektive, kontrollin dhe luftimin e tyre.
84. "Populacion" është një grup i njësive epidemiologjike që ndajnë një karakteristikë të përbashkët të përcaktuar.
85. "Produkte embrionale" janë spermata, vezët dhe embrionet për inseminimin artificial të kafshëve dhe rasatit të peshkut.
86. "Produkte hormonale" janë produktet, të cilat përmbajnë substanca hormonale (direkte ose indirekte), me efekt estrogjenik, androgjenik dhe gestagenik.
87. "Produkt mjekësor veterinar (më poshtë PMV)" është çdo lëndë ose përzierje lëndësh:
- a) që përdoren për mjekimin ose parandalimin e sëmundjes në kafshë;
  - b) që mund t'u jepet kafshëve për të kthyer, rregulluar ose ndryshuar funksionet fiziologjike në kafshë, duke ushtruar një veprim farmakologjik, imunologjik ose metabolik apo për vendosjen e një diagnoze mjekësore.
88. "Produkt mjekësor veterinar imunologjik" është një PMV, që u jepet kafshëve për të shkaktuar imunitet aktiv a pasiv ose për të diagnostikuar gjendjen e imunitetit.
89. "Produkte shtazore specifike të rrezikshme" janë organet dhe indet e kafshëve ripërthypëse, ku janë grumbulluar agjentët e encefalopatisë sfungjerore të transmetueshme (TSE).
90. "Program i kontrollit zyrtar" është programi që është miratuar dhe drejtohet ose mbikëqyret nga autoriteti kompetent veterinar, për kontrollin e një vektori, patogjeni ose sëmundjeje me masa të veçanta, të zbatuara në të gjithë territorin e vendit ose brenda një zone apo njësie të veçantë të vendit.
91. "Pronar ose kujdestar" është çdo person fizik apo juridik, që ka në pronësi kafshët ose është i ngarkuar të kujdeset për kafshët, me ose pa shpërblim financiar.
92. "Rast" është konfirmimi zyrtar i pranisë së sëmundjes së përfshirë në listë, në kafshë ose karkasë, me ose pa shenja klinike.
93. "Reaksion i kundërt" është reaksioni, i cili është i paqëllimshëm dhe i dëmshëm dhe i cili ndodh në rastet e marrjes së dozave të PMV-ve, që normalisht përdoren në kafshë për profilaksinë, diagnozën ose trajtimin e sëmundjes apo ndryshimin e funksioneve fiziologjike.
94. "Recetë e farmakopesë" është receta për një PMV, e përgatitur në një farmaci, sipas një farmakopeje veterinarë në fuqi, me qëllim për t'u përdorur në një kafshë apo grup kafshësh të caktuara.
95. "Regjistrim" është veprimi me anë të të cilit informacioni për kafshët (si identifikimi, shëndeti i kafshëve, lëvizja, certifikimi, epidemiologjia, stabilimentet) mbledhet, shënohet, ruhet në mënyrë të sigurt për përdorim nga autoriteti kompetent.
96. "Rezistencë antimikrobike" është aftësia e disa llojeve të mikroorganizmave që të mbijetojnë, madje dhe të rriten në praninë e një përqendrimi të dhënë të një agjenti antimikrobik, përqendrim që zakonisht është në gjendje të pengojë ose të vrasë mikroorganizma të të njëjtit lloj.
97. "Risk" është mundësia e shfaqjes dhe madhësia e pasojave biologjike të një efekti të kundërt për shëndetin e kafshëve ose të njeriut në një vend gjatë një periudhe të caktuar kohe.
98. "Rrezik" është një agjent biologjik, kimik ose fizik ose një gjendje e një kafshe ose produkti shtazor me mundësinë për të shkaktuar një efekt të kundërt shëndetësor.

99. "Sëmundje" është shfaqja klinike dhe/ose patologjike e infeksionit.
100. "Sëmundje infektive" është shfaqja klinike dhe/ose patologjike e infeksionit, të shkaktuar nga agjentë infektivë.
101. "Sëmundje e lajmërueshme" është një sëmundje e listuar nga autoriteti kompetent veterinar dhe e miratuar nga ministri, për të cilën, sapo të zbu lohet ose të dyshohet, duhet të njoftohet autoriteti kompetent.
102. "Lista e sëmundjeve ose lista" është lista e sëmundjeve të transmetueshme, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Delegatëve të OIE-së dhe të përcaktuara në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit.
103. "Sëmundje e shfaqur rishtas" është një infeksion i ri, si rrjedhojë e evolucionit ose ndryshimit të një agjenti patogjen ekzistues, një infeksion i njohur, që përhapet në një zonë të re gjeografike ose në një populacion të ri apo një agjent patogjen a sëmundje e panjohur më parë që diagnostikohet për herë të parë dhe që ka një ndikim të madh mbi shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik.
104. "Sistemi i farmakovigjilencës" është mbledhja, monitorimi, kërkimi, vlerësimi, kuptimi dhe parandalimi i reaksioneve të kundërta të produkteve mjekësore veterinare mbi shëndetin e kafshëve ose të njeriut.
105. "Sistemi i identifikimit të kafshëve" është përfshirja dhe lidhja e komponentëve të tillë, si identifikimi i fermave, pronarëve dhe/ose kujdestarëve të kafshëve, lëvizjet e kafshëve dhe shënime të tjera që lidhen me identifikimin e kafshës.
106. "Stacion karantine" është një ndërtesë nën kontrollin e autoritetit veterinar, ku kafshët mbahen në izolim pa asnjë kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me kafshët e tjera, për të parandaluar transmetimin e një patogjeni të caktuar, ku kafshët i nënshtrohen një vëzhgimi për një kohëzgjatje të caktuar dhe, nëse nevojitet, i nënshtrohen edhe testimit e mjekimit.
107. "Shërbim veterinar" janë strukturat veterinare, shtetërore ose joshtetërore, të cilat zbatojnë masat e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe standarde dhe rekomandime të fushës, të përcaktuara në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit, të OIE-së, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nën drejtimin e autoritetit kompetent.
108. "Shkelje e përsëritur" është shkelja e kryer brenda një periudhe 1-vjeçare që nga hyrja në fuqi e një akti dënues, përmes të cilit kundërvajtësi është dënuar për shkelje të të njëjtit tip.
109. "Shpërthim i parë" është shpërthimi i një sëmundjeje infektive në kafshë, që nuk lidhet nga ana epidemiologjike me një shpërthim të mëparshëm në të njëjtën zonë ose shpërthimin e parë në një zonë tjetër.
110. "Shpërthim i sëmundjes ose infeksionit" është shfaqja e një ose më shumë rasteve të një sëmundjeje ose infeksioni në një njësi epidemiologjike.
111. "Shpërthim vijues" është shpërthimi që pason shpërthimin e parë të një sëmundjeje infektive në kafshë në një zonë tashmë të infektuar.
112. "Teknik veterinar" është një veteriner me arsim të mesëm profesional, që autorizohet nga trupa statusore veterinare të kryejë disa detyra të përcaktuara në një territor, nën përgjegjësinë dhe drejtimin e një mjeku veterinar.
113. "Transport" është lëvizja e kafshëve për qëllime tregtare, e kryer me një ose me shumë mjete transporti, dhe veprimet e tjera që përfshijnë ngarkimin, shkarkimin, transferimin dhe pushimin, deri në përfundimin e shkarkimit të kafshëve në vendin e mbërritjes.
114. "Transportues" është personi fizik ose juridik, i licencuar për të transportuar kafshë, për llogari të tij ose për një të tretë.
115. "Transit" është lëvizja e ngarkesës së kafshëve të gjalla, përmes ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një vend në një vend tjetër.
116. "Trulllosje" është çdo procedurë e zbatuar mbi një kafshë, që shkakton humbjen e menjëhershme të ndjenjave dhe që zgjat deri në ngordhjen e kafshës.
117. "Tufë/kope" është një numër kafshësh të të njëjtit lloj, që mbahen së bashku nën kontrollin e njeriut, ose një bashkim i kafshëve të egra. Për qëllimet e Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës, një tufë zakonisht konsiderohet si një njësi epidemiologjike.

118. "Therje" është çdo procedurë që shkakton ngordhjen e një kafshe me gjakderdhje.
119. "Therje sanitare" është një masë e detyrueshme që zbatohet me qëllim çrrënjësor të sëmundjes së kafshëve të infektuara ose të dyshuara si të tilla.
120. "Therje e sforcuar" është therja e urdhëruar e kafshëve nga një mjek veterinar, për shkak të ndonjë dëmtimi ose në rastet e sëmundjeve që shoqërohen me dhimbje dhe vuajtje të rënda dhe kur nuk ka asnjë mundësi tjetër praktike për të lehtësuar dhimbjen ose vuajtjen.
121. "Tireostatikët" janë substancat, të cilat zvogëlojnë funksionet e gjëndrës tiroide, përmes të cilave stimulohet efekti i rritjes.
122. "Udhëtim" është i gjithë veprimi i transportit nga vendi i nisjes për në vendin e mbërritjes, që fillon kur kafsha e parë ngarkohet në një mjet ose kontejner dhe përfundon kur kafsha e fundit është shkarkuar dhe përfshin çdo periudhë të qëndrimit ose të pushimit.
123. "Udhëtim i gjatë" është një udhëtim që zgjat mbi 8 orë, duke filluar nga koha kur lëvizet kafsha e parë e ngarkesës.
124. "Vaksinim profilaktik" është imunizimi i kafshëve të prekshme nga sëmundjet infektive, nëpërmjet administrimit të një vaksine, të përbërë nga antigjenë të përshtatshëm për të kontrolluar sëmundjen.
125. "Vektor" është çdo kafshë, vertebrorë ose jovertebrorë, që, në mënyrë mekanike apo biologjike, transmeton a përhap shkaktarin e sëmundjes.
126. "Vend i mbërritjes" është vendi, në të cilin një kafshë shkarkohet nga një mjet transporti dhe pushon për të paktën 48 orë përpara kohës së nisjes ose therjes apo vendi ku shkarkohet ngarkesa.
127. "Veteriner zyrtar" është mjeku veterinar shtetëror i autorizuar nga autoriteti kompetent veterinar për të kryer detyra të përcaktuara në lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, shëndetit publik, kontrollin e PMV-ve, materialin biologjik, materialin patologjik dhe certifikimin e tyre.
128. "Zonë/rajon" është një pjesë e përcaktuar qartë e një territori, që përmban kafshë në një nënpopulacion kafshësh me një gjendje të dallueshme shëndetësore, në lidhje me një sëmundje të veçantë, për të cilën mbikëqyrja, kontrolli dhe masat e biosigurisë janë zbatuar për qëllime të tregtisë ndërkombëtare.
129. "Zonë e infektuar" është zona, në të cilën prania e sëmundjes në fjalë vërtetohet sipas kërkesave, të përcaktuara në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit.
130. "Zonë e lirë" është zona, në të cilën vërtetohet mungesa e sëmundjes, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit.
131. "Zona e mbikëqyrtur" është zona e përcaktuar brenda dhe gjatë kufirit të një zone të lirë, që ndan zonën e lirë nga një zonë e infektuar, që ka një shkallë intensive të mbikëqyrjes.
132. "Zoonozë" është çdo sëmundje ose infeksion që, në mënyrë të natyrshme, transmetohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga kafshët te njeriu.

## **KREU II**

### **IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I KAFSHËVE DHE FERMAVE BLEGTORALE**

#### **SEKSIONI 1**

#### **IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI**

##### **Neni 5**

##### **Qëllimi i sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve**

Sistemi i identifikimit dhe regjistrimit (IR) të kafshëve synon:

- a) kryerjen e regjistrimit individual të kafshëve dhe të fermave blegtorale, ku ato mbarështohen në territorin e Republikës së Shqipërisë;



- b) sigurimin e një baze të dhënash për të gjitha njësitë blegtorale dhe kafshët e llojeve të gjedhit, dhenve, dhive, derrave, njëthundrakëve, qenve dhe maceve, si dhe të llojeve të tjera, nëse kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
- c) garantimin e një kontrolli më të mirë të shëndetit të kafshëve që nga lindja, lëvizja, therja dhe ngordhja e tyre;
- ç) harmonizimin me sistemin e mbikëqyrjes epidemiologjike, për të mundësuar gjurmueshmërinë e kafshëve dhe të fermave blegtorale;
- d) sigurimin e informacionit për popullatën e kafshëve, për të mundësuar planifikimin e masave profilaktike veterinarë, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të kafshëve;
- dh) përmirësimin e kontrollit veterinar gjatë import-eksportit të kafshëve;
- e) të shërbejë si bazë informacioni për kontrollin e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve;
- ë) të shërbejë për zbatimin e programeve kombëtare të mbështetjes dhe zhvillimit të sektorit blegtoral;
- f) garantimin e konfidencialitetit të informacionit në bazën e të dhënave.

## **Neni 6**

### **Identifikimi i kafshëve të prodhimit**

1. Gjedhi, delet, dhitë dhe derrat i nënshtrohen identifikimit të detyrueshëm individual, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ministri.
2. Identifikimi i kafshëve të racave të pastra, që kryhet nga qendrat e blegtorisë dhe të studimeve racore, nuk është subjekt i rregullimeve të përcaktuara në këtë kre.
3. Për të parandaluar, zbuluar dhe kontrolluar sëmundje infektive, si dhe për të kontrolluar tregtinë e kafshëve, autoriteti kompetent urdhëron identifikim të detyrueshëm të llojeve të tjera të kafshëve të prodhimit.
4. Pronari i kafshëve është përgjegjës për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve sipas legjislacionit në fuqi.
5. Pronari i kafshëve mban regjistrat e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve dhe siguron gjurmimin e tyre në rast të lëvizjes.

## **Neni 7**

### **Financimi i sistemit IR**

1. Shpenzimet për ngritjen dhe administrimin e sistemit IR mbulohe nga buxheti i ministrisë dhe çdo e ardhur tjetër nga burime të ligjshme.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton pjesën e kostos së sistemit IR, që do të mbulohet nga fermerët.
3. Tarifat për funksionimin e sistemit IR përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për fushën e veterinarisë dhe të ministrit përgjegjës për financat.

## **Neni 8**

### **Pronari dhe kujdestari i kafshëve**

Pronari ose kujdestari i kafshëve është përgjegjës për:

- a) identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermës blegtorale;
- b) njoftimin e lëvizjes së kafshëve, të cilat duhet të shoqërohen me certifikatë veterinare;
- c) mbajtjen e regjistrit të identifikimit të kafshëve në fermë, sipas formatit të miratuar nga autoriteti kompetent, i cili ka të drejtën e kontrollit mbi të dhënat e regjistrit.

### **Neni 9**

#### **Funksionet e veterinerit zyrtar në identifikimin e kafshëve të prodhimit**

1. Veterineri zyrtar urdhëron masat e mëposhtme, kur konstaton mospërputhje në identifikimin e kafshëve:
  - a) ndalimin e lëvizjes së të gjitha kafshëve nga ferma ose futjen e kafshëve në fermë;
  - b) eliminimin, brenda 72 orëve, të kafshëve të paidentifikuara dhe groposjen e karkasave të tyre.
2. Ministri miraton rregullat për marrjen e masave që zbatohen nga veterineri zyrtar, në rastet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

### **Neni 10**

#### **Trajtimi dhe mbrojtja e të dhënave**

Trajtimi i të dhënave të sistemit IR bëhet duke marrë të gjitha masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e këtyre të dhënave nga çdo dëmtim apo rast humbjeje, të paligjshme apo aksidentale, nga çdo ndryshim, hyrje apo përhapje të paautorizuar, duke garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 11**

#### **Funksionimi i sistemit të identifikimit dhe regjistrimit (IR)**

1. Kafshët dhe fermat blegtorale identifikohen dhe regjistrohen, sipas sistemit kombëtar IR, të mbajtur nga autoriteti kompetent, që është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e këtij sistemi.
2. Procedurat, mjetet dhe metodat për ngritjen, funksionimin dhe zbatimin e sistemit IR miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
3. Sistemi IR përfshin një bazë të dhënash kompjuterike, ku hidhen të dhënat për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale.
4. Njësia përkatëse e IR-së është përgjegjëse për monitorimin, marrjen dhe analizimin e të dhënave të këtij sistemi, si dhe për raportimin pranë autoritetit kompetent.

## **SEKSIONI 2**

### **SISTEMI I IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE TË SHOQËRIMIT**

### **Neni 12**

#### **Identifikimi i qenve**

1. Të gjithë qentë duhet t'i nënshtrohen procesit të identifikimit.
2. Të gjithë qentë e identifikuar duhet të regjistrohen në regjistrin që administrohet nga autoriteti kompetent.
3. Pronarët e qenve mbulojnë koston e pasaportës mjekësore veterinarë dhe identifikimin e detyrueshëm të qenve (rripit identifikues ose mikroçipit).
4. Ministri miraton rregulloren përkatëse, ku përcaktohet forma e identifikimit të detyrueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni.
5. Pronari i qenit është i detyruar që, brenda 14 ditëve, të njoftojë shërbimin veterinar për blerjen e një qeni ose të kërkojë çregjistrimin e qenit, në rastet e zhdukjes, shitjes, dhurimit ose ngordhjes së kafshës.

### **KREU III**

## **MBROJTJA E SHËNDETIT TË KAFSHËVE DHE KONTROLLI SEKSIONI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË KAFSHËVE**

### **Neni 13**

#### **Mbrojtja e shëndetit të kafshëve**

Mbrojtja e shëndetit të kafshëve garanton mbarështimin dhe prodhimin e kafshëve të shëndetshme, mbrojtjen e shëndetit publik veterinar, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen veterinarë të mjedisit.

### **Neni 14**

#### **Lista e sëmundjeve**

1. Lista e sëmundjeve, të cilat prekin rëndë shëndetin e kafshëve, përgatitet nga autoriteti kompetent, mbështetur në situatën epidemiologjike në vend dhe listën e sëmundjeve të përcaktuara nga OIE-ja, dhe miratohet nga ministri.
2. Lista e sëmundjeve të lajmërueshme dhe e atyre me lajmërim të menjëhershëm përcaktohen nga autoriteti kompetent, mbështetur në listën e sëmundjeve të përcaktuara nga OIE-ja.

### **Neni 15**

#### **Masat e përgjithshme profilaktike**

Shërbimi veterinar, me qëllim zbatimin e masave të përgjithshme profilaktike për mbrojtjen e shëndetit, të kontrollit dhe të çrrënjësjes së sëmundjeve të kafshëve, kryen:

- a) ndarjen dhe izolimin e kafshëve të sëmura nga kafshët e shëndetshme;
- b) ndalimin ose kufizimin e vendosjes në tregje ose të lëvizjes së kafshëve;
- c) ndalimin e tregjeve të bagëtive, panairëve të bagëtive, garat sportive dhe evenimente të tjera publike, ndalimin e punës në tregje, në transport dhe në vende të tjera të grumbullimit të kafshëve;
- ç) ndalimin ose kufizimin e tregtisë së kafshëve dhe të objekteve të tjera, përmes të cilave mund të transmetohet sëmundja;

- d) ndalimin e therjes së njëthundrakëve, dythundrakëve, shpendëve, lepujve dhe kafshëve të egra që gjenden në fermë;
- dh) ndalimin, kufizimin ose shtimin e gjuetisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi të gjuetisë;
- e) eliminimin ose therjen e kafshëve të sëmura ose të kafshëve të dyshuara si të sëmura;
- ë) regjistrimin e kafshëve në një fermë ose vend tjetër ku ato mbarështohen dhe, nëse është e nevojshme, matrikullimin e veçantë të tyre;
- f) ndalimin ose kufizimin e prodhimit të kafshëve për një kohë të caktuar;
- g) trajtimin, mbrojtjen ose vaksinimin dhe testet diagnostike;
- gj) kufizimin e lëvizjes së personave në zonat mbrojtëse që janë në kontakt me kafshët e infektuara ose kafshët e dyshuara si të infektuara;
- h) ndalimin e hyrjes ose të daljes së njerëzve dhe të kafshëve nga dhe drejt zonave të infektuara ose të rrezikuara, në të cilat dyshohet infeksioni;
- i) kastrimin e kafshëve të infektuara;
- j) ndalimin e riprodhimit të kafshëve deri në zhdukjen e infeksionit në zonat e infektuara;
- k) eliminimin dhe asgjësimin e karkasave të qenve dhe maceve të rrugës;
- l) ndalimin e transportit dhe tregtisë së bletëve;
- ll) dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e objekteve, pajisjeve, ndërtesave, mjeteve të transportit dhe të mjediseve të tjera, zonave dhe sipërfaqeve ku mbahen kafshët e infektuara ose të dyshuara si të infektuara;
- m) dezinfektimin e personave, që kanë pasur kontakt, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me vektorët e sëmundjeve infektive;
- n) ndalimin e lëshimit të certifikatave veterinarë për lëvizjen e kafshëve dhe të materialeve me origjinë shtazore;
- nj) kontrollin sistematik të kafshëve bartëse të sëmundjes;
- o) sigurimin dhe mbajtjen e kushteve higjienike (biosiguria) në fermat e stabilimentet për mbarështimin e kafshëve dhe në mjetet e transportit;
- p) kontrollin e detyruar për kafshët gjatë kullotjes ose ndalimin e kullotjes në zonat e infektuara, të rrezikuara ose të dyshuara si të infektuara.

## **Neni 16**

### **Programet vjetore të monitorimit**

Shërbimi veterinar përgatit programet vjetore të profilaksisë veterinarë shtetërore, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve me pasoja për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik veterinar, mbështetur në situatën epidemiologjike në vend.

## **SEKSIONI 2**

### **MONITORIMI I ZOONOZAVE DHE AGJENTËVE ZONOTOIKË**

## **Neni 17**

### **Sëmundjet e shfaqura rishtas**

1. Autoriteti kompetent, në rast të shfaqjes së një sëmundjeje infektive, që nuk është përfshirë në

programet dhe në listën e sëmundjeve të përmendura në nenin 14 të këtij ligji, i propozon ministrit përfshirjen e sëmundjes në programet vjetore dhe listën e sëmundjeve infektive.

2. Propozimi përmban argumentet për burimet shtesë financiare dhe materiale për ndjekjen e zbatimin e masave profilaktike, të kontrollit dhe të çrrënjësjes së sëmundjes infektive.

3. Në rast rreziku për shpërthimin e sëmundjeve infektive, të cilat nuk figurojnë në listën e OIE-së dhe që mund të rrezikojnë shëndetin e kafshëve ose të njerëzve, zbatohen masat për mbrojtjen kundër sëmundjeve infektive, të parashikuara në këtë nen.

## **Neni 18**

### **Dyshimi për praninë e sëmundjes infektive**

Konsiderohen arsye për të dyshuar për praninë e një sëmundjeje infektive në një tufë, stallë, fermë ose njësi epidemiologjike, ku kafshët qëndrojnë përkohësisht ose gjithë kohës, rastet kur:

a) shfaqen dy ose më shumë raste të sëmundjes ose të ngordhjeve, me të njëjtat shenja ose shenja të ngjashme;

b) një kafshë ngordh papritur, pa ndonjë shkak të dukshëm;

c) te kafsha, brenda 8 ditëve, shfaqen shenja të sëmundjes, të përsëritura në krerë të tjerë;

ç) rezultatet e testeve laboratorike, shenjat klinike të sëmundjes ose rrethanat epidemiologjike justifikojnë ngritjen e dyshimeve për sëmundjet infektive.

## **Neni 19**

### **Njoftimet në rast dyshimi**

1. Pronari dhe/ose kujdestari i kafshës duhet të njoftojë menjëherë për rastin e dyshuar një mjek veterinar, privat ose shtetëror, pas shfaqjes së një sëmundjeje infektive ose të shenjave, në bazë të të cilave dyshohet se kafsha është infektuar ose ka ngordhur nga një sëmundje e tillë.

2. Teknikët veterinarë, në rast dyshimi për praninë e sëmundjes infektive në kafshë, njoftojnë menjëherë mjekun veterinar, nën kontrollin e të cilit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

3. Çdo mjek veterinar, i cili dyshon për praninë e sëmundjes infektive në kafshë, njofton menjëherë, me shkrim, shërbimin veterinar rajonal përkatës. Modeli i formularit miratohet nga ministri, me propozim të autoritetit kompetent.

4. Drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore, punonjësit e shërbimit pyjor dhe gjuetarët janë të detyruar të lajmërojnë shërbimin veterinar rajonal për çdo dyshim për sëmundje infektive në kafshë dhe/ose kafshët e egra.

## **Neni 20**

### **Veprimet në rastin e dyshimit**

1. Pronari ose kujdestari i kafshës është i detyruar të kufizojë menjëherë lëvizjen e kafshëve, për të cilat ai dyshon se janë infektuar, ose të shmangë kontaktin e kafshës së sëmurë ose karkasës me njerëz dhe kafshë të tjera, deri në çastin e kryerjes së një ekzaminimi veterinar, sipas përcaktimeve të këtij

ligji.

2. Me marrjen e njoftimit për dyshim të sëmundjes infektive, veterineri zyrtar nis menjëherë kryerjen e procedurave përkatëse për të konfirmuar ose për të përjashtuar praninë e sëmundjes së dyshuar.
3. Veterineri zyrtar merr kampionet dhe i dërgon në laboratorin veterinar, të përcaktuar për sëmundjen që dyshohet.
4. Nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar, kafshët e dyshuara mund të transportohen në laboratorin veterinar, duke marrë masat e nevojshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjes, sipas legjisllacionit në fuqi.

## **Neni 21**

### **Masat me konfirmimin e sëmundjes**

1. Kur konfirmohet dyshimi i pranisë së sëmundjes infektive nga laboratorin veterinar, shërbimi veterinar rajonal njofton autoritetin kompetent.
2. Shërbimi veterinar rajonal vendos fermën nën mbikëqyrje zyrtare dhe autorizon veterinerin zyrtar ose të autorizuar të zbatojë masat e përgjithshme profilaktike, të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji, si dhe ato të përcaktuara në rregulloren përkatëse.
3. Pronari dhe/ose kujdestari i kafshëve, për të cilat është konfirmuar prania e sëmundjes, bashkëpunon me veterinerin zyrtar për zbatimin e masave të vendosura sipas këtij neni.
4. Shërbimi veterinar rajonal mund të zbatojë masat e tjera nëse vendndodhja, konfigurimi ose kontaktet e tyre me fermën, ku sëmundja është dyshuar, japin arsye për të dyshuar për një kontaminim të mundshëm.
5. Masat e zbatuara i njoftohen autoritetit kompetent dhe ato nuk mund të hiqen nga ana e shërbimit veterinar rajonal, derisa dyshimi për praninë e sëmundjes nuk është përjashtuar.
6. Nëse përcaktohet në planin e kontingjencës, ngrihet njësitë e krizës për bashkërendimin e të gjitha masave të nevojshme, për çrrënjosjen e sëmundjes sa më shpejt që të jetë e mundur. Burimet për përfitimin, ruajtjen dhe furnizimin e pajisjeve minimalisht të kërkuara për qendrat e krizave, të ngritura për zbatimin e planeve të kontingjencës, sigurohen nga buxheti i ministrisë.
7. Ministri miraton rregulloren për masat që duhet të zbatohen në fermën e vendosur nën mbikëqyrje zyrtare, sipas pikës 2 të këtij neni.

## **Neni 22**

### **Njoftimi pas konfirmimit**

1. Shërbimi veterinar rajonal njofton personat fizikë dhe juridikë, që kryejnë veprimtari veterinarë, shërbimet veterinarë homologe të strukturave të tjera shtetërore në rajonin përkatës dhe autoritetet e qeverisjes vendore për konfirmimin e pranisë së një sëmundjeje infektive.
2. Autoritetet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me shërbimin veterinar rajonal, njoftojnë zyrtarisht pronarët që merren me mbarështimin e kafshëve dhe bëjnë publike për të gjithë zonën konfirmimin e sëmundjes.
3. Në rastin e shfaqjes së zoonozave, shërbimi veterinar rajonal njofton autoritetin kompetent për sigurinë ushqimore dhe atë të shëndetit publik rajonal.

4. Autoriteti kompetent njofton OIE-në, strukturat veterinarë të BE-së dhe të vendeve, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje veterinarë, brenda 24 orëve për shpërthimin e parë të çdo sëmundjeje infektive, me lajmërim të menjëhershëm, të konfirmuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohen vendndodhja dhe masat e menjëhershme që janë marrë apo duhet të merren.

5. Autoriteti kompetent, gjithashtu, njofton OIE-në dhe organizmat veterinarë, të përmendur në pikën 4 të këtij neni, edhe për shpërthimet vijuese të sëmundjeve infektive me lajmërim të menjëhershëm.

6. Autoriteti kompetent njofton ministrin, organet administrative shtetërore të shëndetësisë, të mbrojtjes së mjedisit, organet kompetente për emergjencat civile dhe publikun, kur një sëmundje paraqet një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, si dhe i informon për masat më të rëndësishme për parandalimin e sëmundjes.

### **Neni 23**

#### **Njësitë e veçuara të prodhimit**

Shërbimi veterinar rajonal mund të vendosë përjashtimin nga kërkesat e nenit 21 të këtij ligji, në rastin e fermave të përbëra nga më shumë se 2 njësi të veçuara prodhimi, me kusht që veterineri zyrtar të ketë konfirmuar se:

- a) struktura e madhësia e këtyre njësive dhe veprimet e kryera atje janë krejtësisht të veçanta për sa i përket strehimit, personelit, pajisjeve e ushqimit;
- b) masat e marra parandalojnë përhapjen e shkaktarit të sëmundjes nga një njësi në tjetrën.

### **Neni 24**

#### **Zona e mbrojtur dhe e mbikëqyrur**

1. Me konfirmimin e sëmundjes, autoriteti kompetent përcakton zonën e mbrojtur, me rreze minimumi 3 km, nga ferma e infektuar, që përfshihet në zonën e mbikëqyrur, me rreze minimumi 10 km, me përjashtim të rasteve kur madhësia e tyre përcaktohet në planet e kontingjencës ose rregulloret e sëmundjeve të veçanta. Në përcaktimin e zonës së mbrojtur dhe të mbikëqyrur merren në konsideratë faktorët gjeografikë, administrativë, ekologjikë dhe epidemiologjikë që lidhen me sëmundjen përkatëse dhe mundësitë e monitorimit.

2. Autoriteti kompetent mund të vendosë të ndryshojë (të rrisë apo të kufizojë, sipas rastit) kufijtë e zonave ose kohëzgjatjen e masave kufizuese, në varësi të pozicionit gjeografik dhe të faktorëve ekologjikë, kushteve meteorologjike, pranisë, shpërndarjes dhe llojit të vektorëve, rezultateve të hetimit epidemiologjik, rezultateve të analizave laboratorike dhe masave të kontrollit që zbatohen.

3. Masat e zbatuara në zonën e mbrojtur mbahen në fuqi për të paktën një periudhë inkubimi të sëmundjes përkatëse, pasi të jenë eliminuar kafshët në fermën e infektuar dhe të jenë kryer operacionet e pastrimit dhe të dezinfektimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Autoriteti kompetent dhe shërbimi veterinar rajonal, sipas rastit, bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore dhe njoftojnë popullatën, veçanërisht banorët e zonës, për masat e marra dhe shtrirjen e zonës së mbrojtur dhe të zonës së mbikëqyrur.

5. Ministri miraton masat që duhet të zbatohen në zonën e mbrojtur e të mbikëqyrur, si dhe planin e

kontingjencës për sëmundje të veçanta.

#### **Neni 25**

#### **Përfundimi i sëmundjes infektive**

1. Një sëmundje konsiderohet se ka përfunduar kur, pas trajtimit dhe shërimit, eliminimit të detyruar, therjes ose ngordhjes së kafshës së fundit të sëmurë, pas kryerjes së dezinfektiveve, desi nsektiveve dhe deratizimeve, ka kaluar periudha maksimale e inkubimit për këtë sëmundje infektive.
2. Autoriteti kompetent njofton OIE-në, strukturat veterinare të BE-së dhe të vendeve, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje veterinare, për heqjen, pas çrrënjësjes së shpërthimit të fundit të sëmundjes, të kufizimeve të vendosura në përputhje me nenet 21, 22 dhe 23 të këtij ligji.

#### **Neni 26**

#### **Mbrojtja e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet e tjera**

Mbrojtja e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet e tjera kryhet përmes marrjes së masave, sipas legjislacionit veterinar në fuqi dhe zbatimit të metodave shkencore e të testeve praktike në përcaktimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve.

#### **Neni 27**

#### **Masat në rrethana të jashtëzakonshme**

1. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, urdhëron marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave të tjera për kontrollin dhe eliminimin e sëmundjeve, në rastin e rrethanave të jashtëzakonshme dhe katastrofave natyrore.
2. Për marrjen e masave, sipas pikës 1 të këtij neni, bashkëpunohet edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore.

#### **Neni 28**

#### **Vaksinimet profilaktike**

1. Ndalohen vaksinimet profilaktike kundër sëmundjeve me lajmërim të menjëhershëm, me përjashtim të sëmundjes së pseudopestit dhe të murtajës klasike të derrave deri në afatin e përcaktuar në rregulloret përkatëse. 2. Ministri urdhëron zbatimin e vaksinimit në rastin e përhapjes në shkallë të gjerë të një ose disa sëmundjeve, sipas pikës 1 të këtij neni.

### **SEKSIONI 3**

### **MASAT VETERINARE NË RIPRODHIMIN E KAFSHËVE**

#### **Neni 29**



## **Qendrat e riprodhimit të kafshëve**

1. Qendrat e punës racore, qendrat e ndërzimit, tufat e kafshëve, tufat riprodhuese të shpendëve, inkubatorët, qendrat e punës racore me fazanët, fermat e peshkut e të rritjes së mbretëreshave të bletëve duhet të jenë e të mbahen të pastra nga sëmundjet infektive.
2. Mbledhja dhe magazinimi i spermës së kafshëve, vezëve dhe embrioneve, si dhe metodat e përdorura për mbledhje dhe magazinim i nënshtrohen kontrollit sanitaro - veterinar, sipas rregullores përkatëse.
3. Ndalohet mbledhja e spermës nga kafshët, për të cilat dyshohet të jenë bartëse të sëmundjeve infektive ose të jenë të prekura nga një sëmundje, e cila transmetohet në kafshë të tjera me material biologjik, vezë apo embrione të të njëjtit lloj kafshe.
4. Ndalohen tregtimi dhe përdorimi i spermës, vezëve dhe embrioneve të kafshëve, të cilat janë të kontaminuara ose që kanë veti morfologjike, biokimike dhe biofizike të ndryshuara.
5. Shërbimi veterinar rajonal kontrollon, në mënyrë periodike, gjendjen shëndetësore riprodhuese të kafshëve në ndërzimin natyral e ndërzimin artificial, qendrat e ndërzimit dhe qendrat e punës racore.
6. Shërbimi veterinar rajonal, pas kontroleve, sipas pikës 5 të këtij neni, i propozon autoritetit kompetent vijimin ose ndërprerjen e veprimtarisë në qendrat e riprodhimit të kafshëve, si dhe bllokimin e saj.
7. Qendrat e riprodhimit të kafshëve detyrohen të informojnë rregullisht, në përputhje me përcaktimet e pikës 5 të këtij neni, autoritetin kompetent i cili administron regjistrin e këtyre qendrave.

## **SEKSIONI 4**

### **KONTROLLET ZYRTARE SANITARO-VETERINARE NË KAFSHËT E GJALLA**

#### **Neni 30**

#### **Kontrollet zyrtare sanitare veterinare**

1. Kontrolli (mbikëqyrja dhe monitorimi) zyrtar veterinar kryhet për:
  - a) kafshët para therjes;
  - b) materialet e papërpunuara me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;
  - c) mjetet e transportit të kafshëve të gjalla;
  - ç) prodhimin dhe tregtimin e produkteve mjekësore veterinare;
  - d) përmbushjen e kërkesave në mirëqenien e kafshëve.
2. Autoriteti kompetent garanton kryerjen e kontroleve zyrtare veterinare periodike, të mbështetur mbi riskun dhe me shpeshhtësinë e duhur, duke pasur parasysh:
  - a) rreziqet e identifikuar të lidhura me kafshët;
  - b) çdo informacion që është në mospërputhje me këtë ligj.
3. Kontrollet zyrtare kryhen pa paralajmërim, me përjashtim të rasteve kur njoftimi paraprak është i nevojshëm.

### **Neni 31**

#### **Masat pas kontrollit**

1. Pas kryerjes së kontrollit, nëse rezulton se kafshët e gjalla janë të shëndetshme, ato certifikohen dhe për këto kafshë lejohet tregtimi e trajtimi i tyre sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Nëse pas kontrollit zyrtar, sipas nenit 30 të këtij ligji, konstatohen probleme në kushtet sanitaroveterinare, atëherë merren masat në përputhje me këtë ligj.

### **Neni 32**

#### **Therja e sforcuar e kafshëve**

1. Therja e sforcuar e kafshëve ose therja e kafshëve të dyshuara si të sëmura i nënshtrohet kontrollit veterinar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, edhe në rastet e përdorimit të mishit e të produkteve për konsum vetjak.
2. Në rastin e therjeve të përmendura më lart, kafsha e gjallë shoqërohet nga një certifikatë veterinarë, e lëshuar nga mjeku veterinar, i autorizuar sipas përcaktimeve të këtij ligji.
3. Gjatë therjes së kafshëve respektohen kërkesat e mirëqenies së kafshëve, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 33**

#### **Kontrolli në pikat e inspektit mit kufitar (PIK)**

1. Importi, eksporti dhe transiti i dërgesave me kafshë të gjalla, produkteve mjekësore veterinarë, produkteve embrionale të kafshëve, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, të cilat mund të transmetojnë një sëmundje infektive ose të rrezikojnë shëndetin e njerëzve ose kafshëve, lejohen vetëm në pikat e inspektimit kufitar (PIK) dhe i nënshtrohen kontrollit veterinar nga inspektorët veterinarë të kufirit.
2. Çdo PIK vendoset në zonën e autoritetit doganor sa më pranë që të jetë e mundur pikës hyrëse, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. PIK-të vendosen në mjedise që plotësojnë kushtet higjienike, teknike dhe operative.
3. Autoriteti përgjegjës për inspektimin veterinar në PIK dhe shërbimi doganor bashkëpunojnë në organizimin e kontroleve në këto pika të inspektimit kufitar, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe parashikimeve të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.
4. Pikat e kalimit kufitar, ku lejohen hyrja dhe dalja e ngarkesave, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të ministrit.
5. Kafshët e shoqërimit ose kafshët ekzotike, të cilat, për qëllime jotregtare, hyjnë për në ose dalin ngaterritori i Republikës së Shqipërisë përmes PIK, shoqërohen me dokumentacionin veterinar dhe i nënshtrohen kontrollit veterinar në PIK.
6. Ministri, me propozim të autoritetit kompetent, miraton aktet nënligjore për lëvizjen për qëllime jotregtare të kategorive të kafshëve, sipas pikës 5 të këtij neni.

### **Neni 34**

## **Rregullorja e PIK-ve**

1. Ministri miraton mënyrën e ngarkimit, të ringarkimit, të shkarkimit dhe të magazinimit të kafshëve të gjalla që importohen, transitojnë ose eksportohen.
2. Ngarkimi, ringarkimi, shkarkimi, magazinimi e përpunimi i ngarkesave, sipas të këtij neni, i nënshtrohen inspektimit të detyrueshëm sanitaro-veterinar.
3. Në PIK sigurohet prania e të paktën një inspektori veterinar gjatë gjithë kohës.

### **Neni 35**

#### **Detyrimet e importuesit**

1. Ngarkesa, që i nënshtrohet kontrollit veterinar të detyrueshëm në PIK, është nën përgjegjësinë e pronarit ose të personit përgjegjës për ngarkesën.
2. Importuesi duhet të kryejë të gjitha procedurat e përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi, për lajmërimin paraprak për ngarkesën, paraqitjen e ngarkesës për kontroll dhe për pagesën e tarifës së kontrollit veterinar, si dhe duhet të zbatojë masat e vendosura nga inspektori veterinar kufitar, të përcaktuara në nenet e këtij kreu.
3. Importuesit e ngarkesave të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, detyrohen të njoftojnë, të paktën 24 orë përpara mbërritjes, inspektorin veterinar të PIK-së, ku do të hyjë ngarkesa. Importuesit e ngarkesave me kafshë të gjalla në njoftimin paraprak duhet të kenë të përcaktuar edhe numrin e llojin e kafshëve që përbëjnë ngarkesën.

### **Neni 36**

#### **Ngarkesat në PIK**

1. Ngarkesat e kafshëve, materiali biologjik, produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, dhe produktet mjekësore veterinar mund të shkarkohen, ringarkohen dhe magazinohen në PIK, vetëm pas inspektimit dhe kontrollit sanitaro-veterinar.
2. Inspektori veterinar i PIK-së, mbështetur në certifikatën shëndetësore veterinarë, të lëshuar në çastin e ngarkimit, lëshon një dokument shoqërues për ngarkesat që eksportohen, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Vendqëndrimet e kafshëve, qendrat e karantinës, magazinat doganore për produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, dhe produktet mjekësore veterinarë në pikat e inspektimit kufitar duhet të plotësojnë kërkesat sanitaro-veterinarë, të përcaktuara me akte nënligjore.
4. Ndalohet eksporti jashtë kufijve shtetërorë i kafshëve të sëmurura, si dhe i kafshëve ekzotike, shtëpiake ose të egra që përcaktohen si pasuri kombëtare, e ndaluar për eksport sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 37**

#### **Procedurat në PIK**

1. Autoriteti doganor është i detyruar:
  - a) të njoftojë inspektorin veterinar në PIK, që është pjesë e grupit të praktikës doganore, për çdo ngarkesë të përcaktuar në nenin 33 të këtij ligji, që mbërrin në PIK;
  - b) të sigurojë që i gjithë dokumentacioni i nevojshëm do të vihet në dispozicion të inspektorit veterinar në PIK;
  - c) të sigurojë që ngarkesa do të lëshohet vetëm pas përfundimit të inspektimit veterinar.
2. Inspektimi në PIK i ngarkesave të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, kryhet kundrejt një tarife veterinarë, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat. Të ardhurat derdhen në Buxhetin e Shtetit.
3. Autoriteti doganor kryen procedurat, duke i dhënë përparësi kalimit të kafshëve të gjalla, materialit biologjik dhe produkteve embrionale, bioprodukteve veterinarë, materialeve e produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, që rrezikohen të dëmtohen.

### **Neni 38**

#### **Hyrja dhe dalja e ngarkesave përmes PIK-së**

1. Lejohen importi, eksporti dhe transitimi i kafshëve të gjalla, i produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, i materialeve biologjike e i produkteve embrionale dhe i produkteve mjekësore veterinarë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse ngarkesa i është nënshtruar inspektimit veterinar në PIK dhe pas këtij inspektimi rezulton e pastër nga sëmundjet infektive dhe ndotjet e dëmshme, si dhe nëse është e shoqëruar me certifikatën veterinarë. Ngarkesa shoqërohet me të gjithë dokumentacionin, që vërteton identitetin dhe origjinën e mallit.
2. Lejohet importi i PMV-ve në territorin e Republikës së Shqipërisë, vetëm pas lëshimit të certifikatës së tregtimit për PMV-të, në përputhje me nenin 85 të këtij ligji.
3. Ndalohen importimi dhe transitimi i ngarkesave të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, me përjashtim të PMV-ve, në rast se ngarkesa vjen nga ose kalon përmes një zone të infektuar me sëmundje, me lajmërim të menjëhershëm.
4. Importimi i kafshëve të egra joautoktone bëhet pas marrjes nga importuesi të një miratimi paraprak nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe gjenofondit autokton.
5. Ndalohen importimi dhe futja e mikroorganizmave të gjallë, si baktere, viruse dhe myqe, të cilët janë patogjenë për kafshët dhe njerëzit.
6. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, në raste të veçanta, lejon futjen në Republikën e Shqipërisë të mikroorganizmave dhe shtameve mikrobike nga qendra dhe organizata kërkimore - shkencore për qëllime kërkimore - shkencore dhe për prodhim bioproduktesh.
7. Autoriteti kompetent lejon daljen nga Republika e Shqipërisë të materialeve biologjike dhe patologjike, për qëllime diagnostike dhe konfirmimi të diagnozës në qendrat ndërkombëtare të referencës.

### **Neni 39**

#### **Procedurat në rast dyshimi**

1. Inspektori veterinar në PIK urdhëron bllokimin e menjëhershëm të ngarkesave të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, në rast se, gjatë importit, eksportit apo transitit të këtyre ngarkesave, ai dyshon për sëmundje infektive, ndotje, ndryshime organoleptike të mallit apo konstaton mangësi në

dokumentacionin e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 38 të këtij ligji. Për këtë, ai mban procesverbalin e inspektimit dhe njofton menjëherë autoritetin kompetent për PIK-në, i cili njofton shërbimin veterinar rajonal.

2. Shërbimi veterinar rajonal kryen verifikimin në vend dhe merr masat për ngarkesën, si më poshtë vijon:

- a) bllokimin e ngarkesës në PIK;
- b) rikontrollin veterinar me analiza laboratorike të specifikuara;
- c) konfiskimin, eliminimin dhe groposjen e mallit;
- ç) kthimin mbrapsht të ngarkesës sipas nenit 40 të këtij ligji;
- d) masa të tjera parandaluese e mjekuese, sipas legjislacionit veterinar në fuqi.

3. Të gjitha shpenzimet për masat e marra, sipas pikës 2 të këtij neni, mbulohen nga pronari ose personi përgjegjës për ngarkesën.

4. Shërbimi veterinar rajonal, në rastin e ngarkesave me kafshë të gjalla, urdhëron shoqërimin e ngarkesës për në pikën më të afërt të karantinës ose në vendin e destinacionit, ku do t'i nënshtrohet masave karantimore, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij. Ngarkesa shoqërohet nga veterineri zyrtar i shërbimit veterinar rajonal deri në vendin e destinacionit.

5. Ministri miraton modelin e aktit të masës parandaluese, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni.

## **Neni 40**

### **Kthimi mbrapsht i ngarkesave**

1. Autoriteti kompetent për PIK-në lejon kthimin mbrapsht të ngarkesës, vetëm në rast se:

- a) pronari i ngarkesës ka rënë dakord për vendin ku do të kthehet ngarkesa;
- b) pronari i ngarkesës ka njoftuar autoritetin kompetent të vendit të origjinës ose të vendit ku do të kthehet ngarkesa, nëse ky i fundit është i ndryshëm nga vendi i origjinës, për arsyet dhe rrethanat, në bazë të të cilave ndalohen hyrja dhe tregtimi i ngarkesës në Republikën e Shqipërisë;
- c) vendi, ku do të kthehet ngarkesa, është i ndryshëm nga vendi i origjinës, dhe autoriteti kompetent i vendit, ku do të kthehet ngarkesa, ka njoftuar autoritetin kompetent për PIK-në për gatishmërinë për të pritur ngarkesën.

2. Autoriteti kompetent për PIK-në lejon transitimin, përmes Republikës së Shqipërisë, të ngarkesave të kthyer nga vendet fqinje, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, dhe pas miratimit të autoritetit kompetent të Republikës së Shqipërisë nëse:

- a) ngarkesa nuk është kthyer për shkak të pranisë ose të dyshimit për praninë e sëmundjeve infektive të përcaktuara në listën përkatëse;
- b) në rastin e ngarkesave të kafshëve të gjalla, plotësohen kushtet e mirëqenies së kafshëve, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

## **Neni 41**

### **Karantina për kafshët e gjalla**

1. Kafshët e importuara mbahen në karantinën shtetërore ose në vendin e destinacionit në kushte karantimore, jo më pak se 21 ditë, për të kryer ekzaminimet e nevojshme veterinare. Të gjitha shpenzimet për ditët e karantinës përballohen nga importuesi.

2. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, përcakton mënyrën e organizimit dhe të

funksionimit, si dhe vendin e ngritjes së karantinës shtetërore veterinarë. Shpenzimet, që shoqërojnë procedurat e ngritjes së karantinës, përballohen ng a buxheti i ministrisë.

3. Shërbimi veterinar rajonal siguron në qendrat e karantinës shtetërore personelin, mjediset dhe pajisjet e nevojshme për:

a) kryerjen e ekzaminimeve klinike dhe marrjen e kampioneve ose të materialeve nga kafshët e gjalla ose karkasat e kafshëve të prekura a të dyshuara si të prekura nga një sëmundje infektive, e përcaktuar në listën përkatëse, për qëllime diagnostike;

b) zbulimin dhe izolimin e kafshëve të prekura ose të dyshuara si të prekura nga një sëmundje infektive, e përcaktuar në listën përkatëse;

c) dezinfektimin dhe mundësisht edhe dezinfestimin e mjeteve të transportit të kafshëve të gjalla.

4. Qendrat e karantinës shtetërore gjatë gjithë kohës janë nën kontrollin e veterinerit zyrtar, që është përgjegjës për zbatimin e masave, sipas legjislacionit veterinar në fuqi.

5. Nuk futen në karantinë njëthundrakët, dythundrakët, shpendët dhe lepujt e importuar për therje të menjëhershme brenda 72 orëve nga vende me situatë të pastër epizootike, që nuk paraqesin rrezik për popullatën e kafshëve të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 42**

#### **Certifikatat veterinarë**

1. Importi, eksporti dhe transiti i ngarkesave, sipas nenit 33 të këtij ligji, shoqërohen me certifikatën veterinarë, mbështetur në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit, të OIE-së, dhe të miratuar paraprakisht nga autoritetet kompetente veterinarë të të dyja vendeve.

2. Importi, eksporti dhe transiti i ngarkesave, sipas nenit 33 të këtij ligji, nga ose për në vendet e Bashkimit Evropian, shoqërohet me certifikatën tip, të miratuar nga BE-ja.

#### **Neni 43**

#### **Urdhrat për PIK-në në rastet e sëmundjeve**

1. Në rastet e njoftimeve të OIE-së për shfaqjen e sëmundjeve infektive, të përcaktuara në listën përkatëse, me lajmërim të menjëhershëm, inspektorët veterinarë në PIK detyrohen të zbatojnë menjëherë urdhrin e përkohshëm, të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit, të OIE-së, për ndalimin e importit dhe të transimit në Republikën e Shqipërisë, të ngarkesave të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, që vijnë nga zonat ose vendet ku është konfirmuar prania e sëmundjes.

2. Kur shfaqja e sëmundjeve infektive, sipas pikës 1 të këtij neni, njoftohet në vendet kufitare me Republikën e Shqipërisë, inspektorët veterinarë në PIK detyrohen të zbatojnë menjëherë urdhrin e përkohshëm, të lëshuar nga autoriteti kompetent, për vendosjen e masave karantinore kufitare.

3. Urdhri i ministrit për marrjen dhe zbatimin e masave veterinarë për sëmundjet infektive shfuqizon urdhrat e përkohshëm, të lëshuar nga autoriteti kompetent, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

### **SEKSIONI 5**

### **FINANCIMI I SHËRBIMIT VETERINAR DHE DËMSHPËRBLIMI**

#### **Neni 44**

## **Financimi**

1. Shërbimi Veterinar Shtetëror financohet nga:

- a) buxheti i ministrisë;
- b) mjetet financiare të siguruara nga veprimtaritë veterinare, si tarifatat dhe pagesat për miratimin e njësive të përmendura në nenet 105 e 106 të këtij ligji, dhe të produkteve mjekësore veterinare;
- c) sponsorizime nga persona fizikë e juridikë, vendas e të huaj, për të mbështetur veprimtari shkencore e kualifikuese dhe sigurim aparaturash e mjetesh pune;
- ç) çdo burim tjetër, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

2. Tarifatat e shërbimeve veterinare, që kërkohen për qëllimin bazë të mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për fushën e veterinarisë dhe të ministrit përgjegjës për financat. Shërbimi veterinar rajonal merr një pjesë të të ardhurave të saj nga shërbimet veterinare, duke i përdorur sipas këtij ligji.

## **Neni 45**

### **Përdorimet e financimit**

1. Burimet financiare të shërbimit veterinar, të siguruara nga buxheti i ministrisë, dhe të ardhurat e tjera përdoren për:

- a) zbatimin e masave kundër sëmundjeve në kafshë, të përfshira në programin shtetëror të profilaksisë dhe në listën e sëmundjeve infektive;
- b) dëmshpërblimin e pronarëve të kafshëve, të eliminuara sipas shkronjës "a" të kësaj pike;
- c) detyrimet e anëtarësimit në OIE;
- ç) pajisjet e laboratorëve veterinarë të Qendrës Kombëtare të Referencës dhe të laboratorëve veterinarë rajonalë (shtetërorë);
- d) zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- dh) hartimin, përpunimin dhe zbatimin e projekteve të kërkimit shkencor, të veprimtarive të konsulencës dhe të kualifikimeve;
- e) ngritjen dhe administrimin e sistemeve kompjuterike për informacionin veterinar dhe të regjistrave të shërbimit veterinar;
- ë) mbështetjen e veprimtarisë së kontrollit të shërbimit veterinar;
- f) dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin dhe shkatërrimin, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- g) zbatimin e programeve të trajnimit për punonjësit e shërbimit veterinar;
- gj) ngritjen dhe funksionimin e stacioneve të karantinës shtetërore veterinare;
- h) pjesëmarrjen në studime/testime ndërlaboratorike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- i) identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve.

2. Ministria mban një fond rezervë të detyruar për vjetor mjetesh financiare, jo më pak se 5 për qind të buxhetit të miratuar për autoritetin kompetent, për vaksina, bioprodukte, eliminim kafshësh dhe masa të tjera veterinare, për raste të domosdoshme dhe emergjente për luftimin e sëmundjeve infektive në kafshë dhe zoonozat.

3. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, miraton shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve financiare të shërbimit veterinar.

## **Neni 46**

## **Financimet për emergjencat dhe sëmundjet zoonotike**

1. Masat e nevojshme dhe kostot financiare për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, në rastet e emergjencave nga shpërthimet në shkallë të gjerë të tyre, që shkaktojnë dëmtime në masë të kafshëve dhe paraqesin rrezik për shëndetin publik, përballohen nga Buxheti i Shtetit.
2. Shpenzimet, që kryhen për përballimin e situatave, në rastet e sëmundjeve zoonotike, mbulohen nga fondi përkatës, i parashikuar në buxhetin e ministrisë.
3. Përdorimi i fondit për përballimin e situatave të tilla dhe mënyra e administrimit të tij përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës dhe të Ministrit të Financave.

### **Neni 47**

#### **Vaksinimet dhe gjurmimet e programit të profilaksisë**

1. Vaksinimet dhe gjurmimet e përfshira në programet shtetërore të profilaksisë, të parashikuara nga ky ligj, bëhen falas.
2. Shpenzimet për sigurimin e vaksinave dhe biopreparateve diagnostikuese për këto sëmundje administrohen dhe mbulohen nga ministria.

### **Neni 48**

#### **Masat e autoritetit kompetent**

1. Autoriteti kompetent, mbështetur në listën e sëmundjeve infektive, vendos për:
  - a) eliminimin e kafshëve të sëmura, të dyshuara si të sëmura ose të ekspozuara kundrejt infeksionit;
  - b) asgjësimin e produkteve embrionale, të lëndëve të papërpunuara dhe të pajisjeve e mjeteve në një vatër të sëmundjes, që paraqet rrezik për shëndetin e kafshëve.
2. Pas njoftimit me shkrim, drejtuar kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore ose personit të ngarkuar nga ligji apo akti nënligjor, autoriteti kompetent nxjerr urdhrin për marrjen e njëres prej masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

### **Neni 49**

#### **Dëmshpërblimi**

Për kafshët, që theren, eliminohen, shkatërrohen dhe groposen, në zbatim të vendimit të marrë nga autoriteti kompetent ose për të cilat vërtetohet se kanë ngordhur, pas zbatimit të masave, sipas programit shtetëror të profilaksisë veterinarë, pronari kompensohet nga buxheti i ministrisë në masën e vlerës së dëmit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 50**

#### **Mospërfitimi i dëmshpërblimit**

Pronarët e kafshëve nuk përfitojnë dëmshpërblim në rastet kur:

- a) nuk kanë vënë në dispozicion kafshët e tyre për identifikimin dhe zbatimin e masave nën programin shtetëror të profilaksisë;
- b) nuk kanë njoftuar menjëherë për shfaqjen e sëmundjes infektive;



- c) nuk ka zbatuar masat e përcaktuara nga veterineri zyrtar për dyshimin ose konfirmimin e sëmundjes;
- ç) sëmundja në kafshë shfaqet gjatë importit ose gjatë karantinës së kafshëve të importuara dhe kur pronari është vetë fajtor për shpërthimin e sëmundjes, duke blerë kafshë të sëmura ose të dyshimta, të pashoqëruara me certifikatë veterinare;
- d) sëmundja në kafshë shfaqet, pasi ato janë ushqyer në zona të ndaluara;
- dh) kanë shkelur kërkesat mjekësore veterinare për mbarështimin e kafshëve;
- e) nuk është kryer eliminimi i kafshëve në afatet e përcaktuara nga legjislacioni veterinar në fuqi.

## **SEKSIONI 6**

### **DETYRAT E PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË, SI DHE FUNKSIONET E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

#### **Neni 51**

##### **Detyrat e pronarit dhe të kujdestarit**

1. Pronarët ose kujdestarët e kafshëve të prodhimit detyrohen:
  - a) të ngrenë dhe të mbajnë fermën, në përputhje me kërkesat mjekësore veterinare;
  - b) t'i sigurojnë hyrje të lirë dhe pa asnjë pengesë veterinerit zyrtar, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - c) t'i sigurojnë hyrje të lirë në fermë dhe të kafshët mjekut veterinar që u shërben kafshëve;
  - ç) të njoftojnë mjekun veterinar që i shërben fermës ku mbarështohen kafshët për ndryshimet në gjendjen shëndetësore dhe numrin e kafshëve, të therjeve të sforcuara të kryera e të kafshëve të ngordhura dhe t'i paraqesin atij certifikatën mjekësore veterinare dhe pasaportën e kafshëve të blera;
  - d) të ofrojnë kafshët për identifikimin, vaksinimin dhe ekzaminimet diagnostike;
  - dh) të mbajnë një regjistër ditor, ku mjeku veterinar të shënojë trajtimet mjekësore të kryera;
  - e) të vërtetojnë duke nënshkruar në regjistrin ditor, sipas shkronjës "dh" të kësaj pike, se janë të njohur me kohën e pezullimit të PMV-ve ose të ushqimeve të medikuara të kafshëve, me të cilat janë trajtuar kafshët e tyre;
  - ë) të mos tregtojnë kafshët ose produktet e rrjedhura prej tyre, kur kafshët janë trajtuar me lëndë të paautorizuara ose gjatë kohës së pezullimit;
  - f) të respektojnë kërkesat për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve;
  - g) të respektojnë udhëzimet e autoritetit kompetent për zbatimin e masave profilaktike, kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve.
2. Ministri, me pr opozimin e autoritetit kompetent, miraton kushtet mjekësore veterinare për fermat e mbarështimit të kafshëve dhe të gjitha fermat e tjera që mbajnë kafshë.

#### **Neni 52**

##### **Shfaqjet dhe konkurset me kafshë**

1. Personat fizikë ose juridikë, që organizojnë shfaqje dhe konkurse ku marrin pjesë kafshë, detyrohen të njoftojnë me shkrim shërbimin veterinar rajonal, 7 ditë përpara datës së zhvillimit të veprimtarisë, duke përcaktuar vendin dhe kohën e kryerjes së veprimtarisë si dhe llojet e kafshëve.
2. Shërbimi veterinar rajonal cakton një veteriner zyrtar, që do të kryejë kontrollin e gjendjes

shëndetësore të kafshëve që marrin pjesë në shfaqje ose konkurse.

### **Neni 53**

#### **Detyrimet dhe ndalimet për personat fizikë ose juridikë**

Veprimet dhe veprimtaritë e mëposhtme janë të ndaluara:

- a) lëvizja ose transporti i kafshëve të paignifikuara ose i kafshëve, tek të cilat nuk janë kryer masat e programit të profilaksisë shtetërore;
- b) heqja e matricave nga veshët dhe mënyrave të tjera të identifikimit, si dhe fshirja e numrit të identifikimit të zgjojeve të bletëve;
- c) transporti i kafshëve pa një certifikatë shëndetësore veterinarë dhe për gjedhin e njëthundrakët edhe pa një pasaportë mjekësore veterinarë;
- ç) mbarështimi i kafshëve në qendrat e grumbullimit të ujërave të zeza;
- d) të ushqyerit e kafshëve me mbeturina nga qendrat e grumbullimit të mbeturinave;
- dh) lëvizja ose transporti i kafshëve të sëmura ose të ekspozuara, me përjashtim të rasteve kur është urdhëruar nga veterineri zyrtar, inspektori veterinar ose mjeku veterinar i autorizuar;
- e) të ushqyerit e kafshëve me mbeturina ushqimore, me përjashtim të kafshëve që mbarështohen vetëm për prodhimin e lëkurës;
- ë) të ushqyerit e derrave me mbeturina ushqimore;
- f) përdorimi i kullotave publike dhe i vendeve të ujit nga kafshë të paignifikuara dhe nga kafshë që nuk janë përfshirë në programin shtetëror të profilaksisë;
- g) plehërimi i kullotave me proteina të përpunuara shtazore, të prodhuara nga materiale specifike të kafshëve të riskuara;
- gj) kryerja e trajtimeve mjekësore veterinarë në kafshë nga persona pa edukimin e duhur mjekësor veterinar;
- h) therja e kafshëve të sëmura dhe nekropsia e kafshëve që kanë ngordhur nga tërbimi ose plasja;
- i) futja, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të qenve dhe maceve të pashoqëruara me pasaportën veterinarë dhe të pavaksinuara kundër tërbimit;
- j) prodhimi, importi dhe eksporti i lëkurëve të qenve dhe maceve.

### **Neni 54**

#### **Funksionet e njësive të qeverisjes vendore**

1. Strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore duhet:

- a) të bashkëpunojnë me strukturat e shërbimit veterinar rajonal për zbatimin e masave profilaktike, në rastin e fermave të regjistruara, si dhe për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë;
- b) të përcaktojnë vendndodhjen dhe të administrojnë tregjet e kafshëve të gjalla;
- c) të përcaktojnë kullotat dhe vendet e pirjes së ujit, në varësi të situatës epidemiologjike dhe, nëse është e nevojshme, të ndalojnë përdorimin e tyre;
- ç) të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë legjislacionin në fuqi për eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës;
- d) të kontrollojnë njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe zburimit;
- dh) të organizojnë mbledhjen e kadavrave të kafshëve dhe të përcaktojnë vendet e groposjes ose të

grumbullimit të tyre;

e) të marrin masa për rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të ujërave të zeza dhe të ndalojnë hyrjen e kafshëve atje;

ë) të kryejnë shërbimin veterinar në mjediset e thertoreve dhe të njëjsteve të therjes, për kontrollin shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin dhe nënproduktet e tij;

f) të njoftojnë autoritetin kompetent për sigurinë ushqimore për rastet kur në thertore konstatohen shkelje dhe parregullsi në respektimin e dispozitave të akteve nënligjore, si dhe të rregullave të zbatueshme.

2. Standardet e shërbimit veterinar të qeverisjes vendore dhe detyrat specifike për arritjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **SEKSIONI 7**

### **CERIFIKATAT SHËNDETËSORE VETERINARE QË SHOQËROJNË LËVIZJEN DHE TRANSPORTIN E NGARKESAVE TË KAFSHËVE TË GJALLA, PRODUKTEVE EMBRIONALE DHE PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE, JO PËR KONSUM NJERËZOR**

#### **Neni 55**

##### **Certifikata shëndetësore veterinare**

1. Certifikata shëndetësore veterinare, që vërteton përputhjen me kërkesat mjekësore veterinare për lëvizjen, transportin, shkëmbimin, tregtimin, eksportin ose hedhjen në treg të kafshëve të gjalla, produkteve embrionale, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, lëshohet nga veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar, sipas modelit të miratuar nga ministri e të njësuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar kanë të drejtë të lëshojnë certifikatë shëndetësore veterinare në rastet kur:

a) nuk kanë interes personal për të ngritur dyshime për njëanshmërinë e tyre për lëshimin e certifikatave shëndetësore veterinare, në lidhje me kafshët, produktet embrionale, produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;

b) kanë njohuri të plota dhe njohin veçantinë e çdo certifikate shëndetësore veterinare që ata lëshojnë;

c) kanë njohuritë e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, kontrollin shëndetësor veterinar dhe kontrollin veterinar në pikat e inspektimit kufitar;

ç) kanë njohuri të plota për kërkesat, procedurat dhe ekzaminimet, që kryhen përpara plotësimit të certifikatës shëndetësore veterinare, që kërkohen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

#### **Neni 56**

##### **Detyrimet për personat që lëshojnë certifikatë shëndetësore veterinare**

1. Veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar, kur lëshon certifikatën shëndetësore veterinare, detyrohet:

a) të vërtetojë vetëm të dhëna për të cilat ka njohuri ose për të cilat mund të përcaktojë vërtetësinë e tyre;

b) të nënshkruajë vetëm:

i) formularë të plotësuar dhe të përfunduar;

ii) dokumente të kafshëve, të produkteve embrionale, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, të cilat janë kontrolluar ose mbikëqyrur prej tij.

2. Certifikata shëndetësore veterinare lëshohet mbështetur edhe në të dhënat e marra nga programet e monitorimit, procedurat e mbështetura në sistemet e vetëkontrollit të produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, ose nga një sistem i mbikëqyrjes epidemiologjike, i miratuar nga autoriteti kompetent.

3. Veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar respekton ruajtjen e sekretit për të dhënat e marra, të nevojshme për lëshimin e certifikatës shëndetësore veterinare, të cilat janë të mbuluara nga sekreti profesional.

### **Neni 57**

#### **Ekzaminimet përpara lëshimit të certifikatës shëndetësore veterinare**

Përpara lëshimit të certifikatës dhe dokumenteve të tjera për eksport, për lëvizjen ose transportin e kafshëve, produkteve embrionale, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, veterineri zyrtar ose veterineri i autorizuar detyrohet të kryejë ekzaminimin klinik e fizik dhe kontrollet për:

a) përputhjen me kërkesat mjekësore veterinare për identifikimin e kafshëve;

b) zbatimin e programit të profilaksisë shtetërore;

c) përputhjen me kërkesat mjekësore veterinare në qendrat e prodhimit dhe të ruajtjes së produkteve embrionale në tregjet e qendrat e grumbullimit të kafshëve dhe vendet për pastrimin e dezinfektimin e mjeteve të transportit;

ç) përputhjen me kërkesat mjekësore veterinare gjatë transportit të kafshëve, produkteve embrionale, nënprodukteve dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;

d) zbatimin e detyrimeve të pronarëve në çdo fazë të mbarështimit, prodhimit dhe tregtisë së kafshëve, produkteve embrionale, nënprodukteve dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, prej nga rrjedhin;

dh) certifikatat veterinare dhe dokumente të tjera, që shoqërojnë subjektet eksportuese.

### **Neni 58**

#### **Gjurmueshmëria e certifikatave shëndetësore veterinare**

1. Autoriteti kompetent krijon dhe administron një sistem të gjurmueshmërisë dhe kontrollit të certifikatave shëndetësore veterinare të lëshuara, mbështetur në:

a) numrin e identifikimit të dokumentit;

b) nënshkrimin e mjekut veterinar, vulën e tij personale dhe vulën e shërbimit veterinar rajonal.

2. Një kopje e çdo certifikate shëndetësore veterinare ruhet në shërbimin veterinar rajonal sipas legjisllacionit në fuqi.

3. Autoriteti kompetent kryen kontrole të dokumenteve mjekësore veterinare për përputhjen e tyre me kërkesat e përcaktuara për procedurën e lëshimit të tyre.

## **SEKSIONI 8**

### **LËVIZJA DHE TRANSPORTI I BRENDSHËM I KAFSHËVE**

## **Neni 59**

### **Certifikatat shëndetësore veterinare për lëvizje**

1. Veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar lëshon certifikatën shëndetësore veterinare, që shoqëron lëvizjen e kafshëve të gjalla, lëkurëve, leshit dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, materialit biologjik dhe produkteve embrionale, në tregtinë e brendshme.
2. Certifikata shëndetësore veterinare, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, lëshohet për:
  - a) kafshët njëhundra dhe dyhundra, në rastet e nxjerrjes së tyre në tregje dhe panaire apo në të tjera mjedise shitjeje, në ekspozita, në gara sportive, në vende të ndryshme për grumbullimin e kafshëve në publik, për vrapim, kur dërgohen jashtë zonës administrative, kur nuk kanë vendqëndrim të përhershëm, për shitje ose kalim pronësie të një forme tjetër, për therje, si dhe për lëvizjen e tyre për në kullota;
  - b) shpendët, zogjtë dekorativë, lepujt dhe kafshët me gëzof, në rast se dërgohen në thertore për therje, dërgohen jashtë zonës administrative dhe në ekspozitë, si dhe për shitje ose kalim pronësie të një forme tjetër;
  - c) peshqit, nga qendrat dhe vaskat e rritjes së peshkut dhe punës racore, molusqet, krustacët e kafshët e ujit, në rast se dërgohen jashtë zonës administrative, si dhe për shitje ose kalim pronësie të një forme tjetër;
  - ç) ngarkesa me parqe bletësh, si dhe mbretëresha, në rast se dërgohen jashtë zonës administrative ose në kullotë, si dhe për shitje ose kalim tjetër pronësie;
  - d) qentë dhe macet, në rast se dalin në panaire, ekspozita, gara sportive dhe çdo vend tjetër grumbullimi kafshësh në vende publike;
  - dh) të gjitha materialet biologjike dhe produktet embrionale.
3. Certifikata shëndetësore veterinare lëshohet në çastin e ngarkimit të kafshëve dhe është e vlefshme për 3 ditë, nga çasti i lëshimit.
4. Certifikata shëndetësore veterinare nuk lëshohet, kur në vendin e origjinës së kafshëve janë shfaqur sëmundje infektive dhe për sa kohë zbatohen masat e kontrollit të sëmundjeve, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Certifikata shëndetësore veterinare nuk lëshohet për lëvizjen ose tregtimin e kafshëve, të cilat janë të paidentifikuara.
6. Ndalohet hyrja e kafshëve në tregje dhe thertore pa certifikatën veterinare të lëshuar nga veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar.

## **Neni 60**

### **Kontrolli gjatë ngarkimit dhe shkarkimit**

1. Kafshët e gjalla, që transportohen jashtë zonës territoriale administrative ku ndodhen, i nënshtrohen kontrollit veterinar gjatë ngarkimit.
2. Para ngarkimit dhe pas shkarkimit, mjeti i transportit pastrohet dhe dezinfektohet nga transportuesi.
3. Veterineri zyrtar ose mjeku veterinar i autorizuar, që ka mbikëqyrur dezinfektimin e mjeteve të transportit, certifikon dezinfektimin, sipas modelit të përcaktuar nga autoriteti kompetent.
4. Dokumenti, i cili, sipas pikës 3 të këtij neni, i jepet drejtuesit të mjetit, shoqëron ngarkesën dhe paraqitet në rastet kur ai kërkohet.

## **Neni 61**

### **Ekspozitat dhe panairot**

1. Subjektet, që merren me organizmin e ekspozitave, kopshteve zoologjike shëtitëse, transportin e kafshëve që udhëtojnë me trupat e cirkut, me organizimin e panairove e të shitjeve të organizuara të kafshëve, jashtë mjediseve të stallave dhe stabilimenteve, njoftojnë paraprakisht, me shkrim, strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore.
2. Strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore miratojnë ose refuzojnë kërkesën për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë nen. Strukturat veterinarë të qeverisjes vendore njoftojnë shërbimin veterinar rajonal për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë.
3. Ministri miraton kërkesat dhe kriteret për miratimin ose refuzimin e kërkesës për kryerjen e veprimtarive, të parashikuara në këtë nen.

## **Neni 62**

### **Detyrimet gjatë transportit**

1. Pronari, kujdestari apo transportuesi i kafshëve detyrohet të paraqesë certifikatën shëndetësore veterinarë, nëse i kërkohet nga strukturat apo organet shtetërore, të ngarkuara nga ligji.
2. Në rast aksidenti gjatë transportit të kafshëve, policia ose çdo punonjës i autoriteteve të tjera njofton shërbimin veterinar rajonal më të afërt, që merr masat për aksidentin dhe u siguron ndihmë kafshëve të aksidentuara.
3. Veterineri zyrtar urdhëron eliminimin e detyrueshëm në vend për kafshët me dëmtime të rënda dhe të pashërueshme dhe njofton shërbimin veterinar rajonal, si dhe strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore.

## **Neni 63**

### **Grumbullimi dhe tregtia e lëkurëve**

1. Personi fizik apo juridik, që grumbullon apo tregton lëkurë kafshësh dhe i përpunon ose jo ato, kur vijnë nga njëthundrakë dhe dythundrakë të therur, pa kontroll sanitaro-veterinar, ose lëkurë të papërpunuara të këtyre kafshëve, i magazinon ato në mjedise të veçanta dhe të izoluara nga të tjerat.
2. Personi fizik apo juridik, sipas pikës 1 të këtij neni, vërteton dhe dokumenton origjinën e lëkurëve të blera, përmes certifikatës veterinarë të origjinës.

## **Neni 64**

### **Liria e lëvizjes së kafshëve**

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve u siguron lirinë e nevojshme të lëvizjes, në varësi të llojit të tyre. Lëvizjet nuk duhet të kufizohen në një mënyrë që të shkaktojnë vuajtje ose dëmtime të panevojshme.
2. Pronari ose kujdestari i kafshëve, në rastet kur kafshët mbahen të lidhura apo të izoluara, në mënyrë të vazhdueshme ose rregullisht, u siguron atyre hapësirën e mjaftueshme për nevojat fiziologjike dhe në varësi të llojit.

## **Neni 65**

### **Kërkesat e mirëqenies**

1. Kafshët mbarështohen dhe përdoren në mënyrën që i përshtatet qëllimit të mbajtjes së tyre, në përputhje me nevojat e tyre fiziologjike dhe veçoritë e llojit.
2. Ndërhyrjet kirurgjikale ose manipulimet, të cilat u shkaktojnë ose mund t'u shkaktojnë kafshëve dhimbje dhe vuajtje, kryhen me anë të anestezisë.
3. Ministri miraton kërkesat minimale të mbrojtjes dhe mirëqenies së kafshëve për mbarështimin, prodhimin, përdorimin, shitjen, therjen, eliminimin dhe transportin, përkatësisht, sipas llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve.

## **Neni 66**

### **Detyrimet e pronarëve dhe kujdestarëve të kafshëve**

Pronarët dhe kujdestarët e kafshëve, si dhe drejtuesit e fermave blegtorale detyrohen:

- a) të kujdesen për kafshët dhe të mos i braktisin ato;
- b) të mbajnë regjistrin e t rajtimeve mjekësore të kafshëve për, të paktën, 3 vjet;
- c) t'i sigurojnë secilës kafshë, në varësi të llojit, moshës dhe racës:
  - i) trajtim profilaktik veterinar të rregullt dhe ndërhyrje të menjëhershme mjekësore, në rastet e sëmundjeve apo dëmtimeve;
  - ii) vendin, kushtet dhe një mikroklimë të përshtatshme të qëndrimit, në përputhje me nevojat e kafshës;
  - iii) hapësirën e nevojshme të shtrirjes dhe akomodimit dhe lirinë e lëvizjes;
  - iv) stalla dhe strehime të ndërtuara me materiale që mund të pastrohen dhe dezinfektohen lehtë, me ajrim të përshtatshëm dhe temperaturë të pranueshme;
  - v) ushqim dhe ujë në sasi të mjaftueshme dhe qasje të lirë në vendet ku ushqehet dhe pi ujë;
  - vi) pajisje të përshtatshme për ushqim dhe pirje uji, të vendosura në mënyrë që të shmangin kontaminimin e tyre, dëmtimet e streset dhe të ulin në minimum konkurrencën agresive mes kafshëve;
  - vii) ekspozimin kundrejt ndriçimit natyror, duke shmangur qëndrimin në errësirë të përhershme ose për një kohë të gjatë në ndriçim artificial;
- ç) të ndërmarrin të gjitha masat për parandalimin e luftimeve të kafshët;
- d) të kontrollojnë gjendjen e përgjithshme shëndetësore të tyre, të paktën, një herë në ditë;
- dh) të plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta higjienike, të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **Neni 67**

### **Kafshët e përdorura për eksperimente**

1. Autoriteti kompetent miraton kryerjen e eksperimenteve me kafshë, në përputhje me kriteret dhe standardet ndërkombëtare për mirëqenien e kafshëve të eksperimentit dhe vetëm në ato raste, kur nuk është e mundur të zbatohen metoda të tjera alternative.
2. Autoriteti kompetent regjistron numrin dhe llojet e kafshëve të përdorura në eksperimentet e miratuara. Ky informacion mund të bëhet i disponueshëm për publikun, herë pas here, në intervale

kohe.

3. Eksperimentet me kafshë kryhen në qendrat eksperimentale të institucioneve kërkimore-shkencore, ndërmarrjet e prodhimit, laboratorët dhe institucionet arsimore, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Personat, që kryejnë eksperimentet ose marrin pjesë në zbatimin e tyre, duhet të kenë formimin dhe trajnimin e nevojshëm.

4. Kërkesat, kriteret dhe procedurat për përdorimin e kafshëve për eksperimente, si dhe qendrat ku kryhen ato, miratohen nga ministri, në përputhje me standardet ndërkombëtare. 10/28/13 Ligjet.org - Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë

### **Neni 68** **Therja e kafshëve**

1. Therja e kafshëve kryhet në mënyrën më të shpejtë, pas trulllosjes, dhe duhet të sigurojë humbjen e plotë të ndjenjave e të ndjeshmërisë gjatë të gjithë kohës së çgjakësimit.
2. Therja e kafshëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve.
3. Ndalohet heqja e gjymtyrëve dhe trajtimi i një karkase derisa kafsha të jetë ç'gjakësuar plotësisht.
4. Therja e kafshëve bujqësore (njëhundrakë shtëpiakë, gjedhë, të imta, derra, lepuj, shpendë) lejohet në rastet e mëposhtme:
  - a) kur kafshët mbarështohen për prodhimin e mishit ose të lëndëve të papërpunuara;
  - b) kur kafshët trajtohen për sëmundje joinfektive, por që shërimi i tyre është i pashpresë ose ekonomikisht i pajustificuar;
  - c) për çrrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse;
  - ç) për rituale fetare të bashkësive fetare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.
5. Ministri miraton aktet nënligjore për mbrojtjen e kafshëve gjatë therjes.

### **Neni 69** **Eliminimi i kafshëve**

1. Eliminimi i kafshëve kryhet në atë mënyrë që të mos shkaktojë dhimbje dhe vuajtje të panevojshme.
2. Eliminimi i kafshëve lejohet në rastet e mëposhtme:
  - a) për çrrënjosjen e sëmundjeve infektive;
  - b) për kontrollin e infeksioneve zoonotike në kafshë që paraqesin rrezik për jetën e njeriut;
  - c) kur njerëzit sulmohen nga një kafshë e tërbuar, tepër agresive, e egër dhe në kushtet e vetëmbrojtjes;
  - ç) gjatë gjuetisë, në përputhje me legjislacionin përkatës.
3. Planet e emergjencës për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive duhet të përfshijnë edhe procedurat logjistike për therjen e kafshëve, me qëllim garantimin e kërkesave të mirëqenies së kafshëve. Këto procedura mund të shmangen vetëm në rastet kur respektimi i tyre mund të ketë pasoja për shëndetin e njerëzve ose të pengojë çrrënjosjen e sëmundjes.

### **Neni 70** **Eutanazia e kafshëve**



1. Eutanazia e kafshëve kryhet nga mjeku veterinar, që ushtron praktikën mjekësore veterinare, me një nga PMV-të e miratuara.
2. Gjatë kryerjes së një eutanazie, mjeku veterinar shënon, në regjistrin ditor të ndërhyrjeve kirurgjikale, arsyet e kryerjes së saj dhe PMV-në e përdorur.
3. Eutanazia lejohet në rastet e mëposhtme:
  - a) kur kafsha është e prekur nga një sëmundje e pakurueshme, me ndryshime të pakthyeshme patologjike, që i shkakton dhimbje dhe vuajtje;
  - b) për kufizimin dhe çrrënjosjen e një sëmundjeje infektive, që paraqet rrezik për shëndetin e njeriut ose të kafshëve;
  - c) pas përfundimit të eksperimenteve me kafshë, që kanë çuar në ndryshime patologjike, të cilat u shkaktojnë kafshëve dhimbje dhe vuajtje;
  - ç) për kafshët, sjellja agresive e të cilave përbën një rrezik të qartë për jetën e shëndetin e njeriut dhe të kafshëve të tjera.

## **Neni 71**

### **Procedurat e eutanazisë**

1. Përgatitja dhe kryerja e eutanazisë bëhen në mënyrën e duhur, duke zvogëluar në minimum stresin te kafsha.
2. Eutanazia kryhet në një vend të veçantë dhe me produkte që shkaktojnë një humbje të menjëhershme dhe të plotë të ndërgjegjes e të ndjeshmërisë së dhimbjes, të pasuar nga një ngordhje e sigurt.
3. Pas kryerjes së eutanazisë, mjeku veterinar përcakton ngordhjen e kafshës, duke kontrolluar ndërprerjen e veprimtarisë së zemrës.
4. Në një eutanazi është i ndaluar përdorimi i pavarur i PMV-ve, që paralizojnë muskujt, pa shkaktuar humbje të ndjeshmërisë ndaj dhimbjes, si dhe i PMV-ve që nuk shkaktojnë humbjen e ndjenjave.

## **Neni 72**

### **Transporti i kafshëve**

1. Kafshët transportohen në kushte ku garantohen shëndeti, mirëqenia, nevojat e tyre fiziologjike dhe të sjelljes, duke shmangur dëmtimin apo vuajtjet e panevojshme, në mjete transporti të pajisura posaçërisht për transportin e tyre.
2. Ministri miraton aktet nënligjore për mirëqenien e kafshëve gjatë transportit. 3. Transporti i kafshëve kryhet nga transportues të pajisur me licencë transporti dhe me mjete të miratuara nga autoriteti kompetent për largësi të shkurtra ose të gjata. Transportuesi duhet të ketë trajnimin e përshtatshëm dhe të mbajë regjistrin e udhëtimit.
4. Procedurat dhe dokumentacioni i kërkuar për miratimin e mjeteve të transportit të kafshëve miratohen nga ministri.
5. Përfshihen nga detyrimet e këtij neni:
  - a) transporti i kafshëve të shoqërimit dhe qenve të gjuetisë nga pronari i tyre me automjet personal;
  - b) transporti i kafshëve individuale të fermës për nevoja personale.
6. Gjatë transportit në largësi të mëdha, në intervale kohe të përshtatshme, kafshëve u sigurohet pushim, ujë dhe ushqim në cilësinë dhe sasinë e duhur për llojin dhe madhësinë e tyre.

7. Drejtuesit e mjeteve dhe personat shoqëruar të kafshëve u sigurojnë kafshëve të sëmura, gjatë transportit, ndihmën mjekësore veterinarë sa më shpejt të jetë e mundur.

8. Gjatë kryerjes së kontrolleve, veterineri zyrtar duhet të verifikojë vlefshmërinë e dokumentacionit, të drejtën për të transportuar kafshë, të dhënat në regjistrin e udhëtimit, si dhe kushtet e kafshëve nëse ato janë në gjendje për të vijuar udhëtimin.

### **SEKSIONI 3**

## **KAFSHËT E SHOQËRIMIT DHE QENTË PËR QËLLIME PROFESIONALE, GJUETIE DHE TË TJERA**

#### **Neni 73**

#### **Detyrimet e pronarëve të kafshëve të shoqërimit**

1. Pronarët e qenve dhe kafshëve të shoqërimit duhet të pajisin me pasaportë mjekësore veterinarë qentë dhe kafshët e tjera, me moshë mbi 6 javë, ku shënohen vaksinimet dhe trajtimet antiparazitare.
2. Në moshën 4-muajsh ose brenda 14 ditëve nga data e blerjes së një qeni, pronari duhet ta regjistrojë te një mjek veterinar, që ushtron praktikën mjekësore veterinarë.
3. Pronarët e kafshëve të shoqërimit detyrohen: a) të paraqesin pasaportën mjekësore veterinarë, kur shkojnë për vizita te mjeku veterinar;  
b) të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit;  
c) t'u sigurojnë kafshëve lëvizjen e nevojshme ditore kur i mbarështojnë në mjedise të mbyllura;  
ç) t'u sigurojnë kafshëve një strehë dhe një zonë të lëvizjes së lirë, kur i mbarështojnë duke i mbajtur të lidhur për një kohë të gjatë në mjedis të hapur;  
d) të sigurojnë që kafshët të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera, duke zbatuar detyrimin e vendosjes së maskës mbrojtëse në gojë, kur i nxjerrin shëtitje qentë agresivë;  
dh) të parandalojnë riprodhimin e padëshiruar të kafshëve dhe të shmangin rrezikun për shëndetin e kafshëve gjatë përdorimit të tyre për riprodhim, duke vlerësuar veçoritë e tyre fiziologjike, anatomike dhe të sjelljes;  
e) të shmangin ndotjen e vendeve publike nga kafshët, si dhe të pastrojnë vendin pas defekimit, në rast ndotjeje.

#### **Neni 74**

#### **Sigurimi i kushteve të mbrojtjes dhe të mirëqenies**

Pronarët dhe drejtuesit e kopshteve zoologjike, të cirqeve, të njërive të shitjes së kafshëve të shoqërimit, fermave të tjera të mbarështimit të kafshëve dhe organizatorët e veprimtarive, ku marrin pjesë kafshët, detyrohen të sigurojnë kushte për zbatimin e rregullave të mbrojtjes dhe të mirëqenies së kafshëve.

#### **Neni 75**

#### **Rregulla për mirëqenien e kafshëve të egra**

1. Kafshët e egra mund të mbarështohen jashtë mjedisit të tyre natyror, vetëm në kopshte zoologjike, akuariume, terrariume, cirqe, ferma, voliera dhe vivariume.
2. Njësitë, ku mbarështohen kafshët e egra, regjistrohen në regjistër, sipas përcaktimit të nenit 129 të këtij ligji.
3. Kafshët ekzotike mund të mbarështohen në kushtet e shtëpisë, duke plotësuar kërkesat e mbrojtjes dhe të mirëqenies së kafshëve.

## **Neni 76**

### **Veprime që bien ndesh me mirëqenien e kafshëve**

Për mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve ndalohej kryerja e veprimeve të mëposhtme:

- a) shkaktimi i torturës, dhunës fizike dhe verbale, sjelljes çnjerëzore, frikës, dëmtimit, dhimbjes, vuajtjes, shqetësimit ose ankthit, me përjashtim të rasteve të lejuara sipas këtij kreu;
- b) ndërsimi i kafshëve kundër njëra-tjetrës ose përdorimi i kafshëve për luftime a shfaqje që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhje të kafshëve;
- c) stërvitja e kafshëve në një mënyrë të tillë që u shkakton atyre dhimbje ose vuajtje;
- ç) vënia e kafshëve nën ngarkesa fizike, duke mos marrë parasysh aftësitë e tyre anatomike ose fiziologjike;
- d) grumbullimi i kafshëve në një mënyrë që u shkakton atyre dhimbje, vuajtje ose dëmtim; dh) mbarështimi i kafshëve në errësirë të plotë dhe të përhershme ose të lidhur gjithë kohës;
- e) strehimi në një vend i llojeve të kafshëve të papajtueshme me njëra-tjetrën ose i kafshëve të të njëjtit lloj, kur ky mund të çojë në rritje të agresivitetit, stresit dhe tensionit; ë) kryerja e trajtimeve mjekësore veterinarë dhe dhënia e PMV-ve nga persona pa kualifikimin e duhur;
- f) përdorimi i substancave anestetike ose substancave që dëmtojnë shëndetin e kafshëve, me përjashtim të rasteve kur justifikohen në aspektin mjekësor ose për trajtime në kuadrin e zbatimit të një eksperimenti, të miratuar nga autoriteti kompetent;
- g) përdorimi i substancave stimuluese për kafshët, me qëllim arritjen e rezultateve të larta në sport;
- gj) ndërzimi natyral ose artificial që rezulton në rrezik ose sjell një rrezik për shëndetin e kafshëve;
- h) të ushqyerit e kafshëve me ushqime, që përmbajnë substanca të dëmshme, ose me ushqime, të cilat nuk janë të përshtatshme për llojin, moshën dhe gjendjen e tyre shëndetësore;
- i) kryerja pa anestezi e ndërhyrjeve kirurgjikale që shkaktojnë dhimbje në kafshë;
- j) transporti i kafshëve në mjete të paautorizuara dhe në kushte që u shkaktojnë atyre dhimbje, dëmtime dhe vuajtje;
- k) gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe lëvizjes, kafshët të qëllohen, të shtyhen, të goditen, të shtypen pjesë të ndjeshme të trupit të kafshës, të shtypen, të përdridhen ose të thyhen bishtat e tyre, të përdoren pajisje që u shkaktojnë dhimbje kafshëve, të lëvizen me pajisje mekanike, si dhe të ngrihen ose të tërhiqen nga koka, brirët, veshët, këmbët, bishtat, gëzofi dhe qimet.

## **Neni 77**

### **Ushtrimi i kontroleve**

1. Shërbimi veterinar rajonal organizon kontrollin dhe vëzhgimin për përmbushjen e kërkesave të këtij kreu.
2. Shoqatat e mbrojtjes dhe të mbarështimit të kafshëve detyrohen të bashkëpunojnë me shërbimin

veterinar rajonal, në përmbushjen e përcaktimeve të këtij ligji.

3. Përfaqësues nga shoqatat e mbrojtjes së kafshëve mund të marrin pjesë në kontrolle, në rastet kur vetë shoqata e ka iniciuar atë, duke dërguar një njoftim për shkelje të kërkesave për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve.

4. Shërbimi veterinar rajonal njofton shoqatën për kohën e kryerjes së kontrollit.

## **KREU V**

### **ASGJËSIMI I PRODUKTEVE JOSHTAZORE DHE MBROJTJA E MJEDISIT**

#### **Neni 78**

##### **Masat parandaluese për mbrojtjen e mjedisit**

1. Masat parandaluese për mbrojtjen e mjedisit përfshijnë:

a) sigurimin e largimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të përdorimit të përshtatshëm të mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta;

b) sigurimin e depozitimit të përshtatshëm të mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta;

c) trajtimin higjienik të jashtëqitjeve dhe mbeturinave të lëngshme;

ç) pakësimin e rreziqeve të infeksionit, duke përcaktuar kushte sanitaro-veterinare të përshtatshme në stalla dhe mjedise, si mikroklimë, ulje e nivelit të amoniakut, depozitim mbeturinash dhe jashtëqitjesh, pastrim dhe dezinfektim;

d) parandalimin e ndotjes së ujërave nga shkaktarët biologjikë;

dh) masa të tjera, sipas përcaktimit të legjislacionit mjedisor në fuqi.

2. Masat parandaluese, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren nga personat fizikë ose juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e mëposhtme:

a) mbarështimin e kafshëve;

b) përdorimin, tregtimin dhe transportin e kafshëve;

c) përpunimin e produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, dhe mbeturinat shtazore.

3. Ministri, së bashku me ministrin përgjegjës për mjedisin, miratojnë rregulloren e trajtimit të mbeturinave me origjinë shtazore.

#### **Neni 79**

##### **Detyrimet e personave fizikë e juridikë për mbrojtjen e mjedisit**

1. Pronari ose kujdestari i kafshëve informon menjëherë shërbimin veterinar rajonal për ngordhjen.

2. Pronari ose kujdestari i kafshëve, që ushtron veprimtari blegtorale dhe shkakton mbeturina, detyrohet t'i transportojë ato, sipas rregullave, në depon më të afërt të grumbullimit ose në vendin e përpunimit të mbeturinave.

#### **Neni 80**

##### **Qendrat e përpunimit pas ngordhjes**

1. Groposja ose djegia e kadavrave të kafshëve bëhet në qendrat e përpunimit, pas ngordhjes, sipas rregullave sanitaro-veterinare.

2. Qendrat përcaktohen nga organet e qeverisjes vendore, me pëlqimin e shërbimit veterinar rajonal

dhe agjencive shtetërore përgjegjëse për mjedisin.

3. Groposja ose djegia e kadavrave të kafshëve në qendrat e përpunimit, post mortem, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar.

## **KREU VI**

### **PLANI I MONITORIMIT TË MBETJEVE DHE USHQIM EVE PËR KAFSHË ME PMV**

#### **Neni 81**

##### **Plani i monitorimit të mbetjeve**

1. Autoriteti kompetent përgatit Planin Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve dhe mbikëqyr zbatimin e tij nga shërbimi veterinar rajonal, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe laboratorët e autorizuar.
2. Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve hartohet nga autoriteti kompetent dhe miratohet nga ministri.
3. Rregullorja për zbatimin e Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve dhe kufijtë maksimalë të lejuar të mbetjeve të PMV-ve në lëndët e papërpunuara dhe ushqimet me origjinë shtazore miratohen nga ministri.
4. Shërbimi veterinar rajonal, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në zbatim të Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve, kontrollojnë kafshët e gjalla, materialet e papërpunuara, produktet me origjinë shtazore dhe ushqimet për kafshë, për praninë e mbetjeve me ndikime të dëmshme në shëndetin e kafshëve e të njerëzve.
5. Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve i miratuar nga ministri dhe rezultatet e zbatimit të planit të vitit paraardhës, i dërgohen Komisionit Evropian.

#### **Neni 82**

##### **Ushqimet të cilat përmbajnë PMV**

1. Ndalohen prodhimi, vendosja në treg dhe tregtimi i ushqimeve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, i ushqimeve me origjinë shtazore dhe i ushqimeve për kafshë kur:
  - a) janë të prodhuara nga kafshë të trajtuara ose të ushqyera me PMV përpara mbarimit të kohës së pezullimit, me tireostatikë dhe beta-agonistë;
  - b) qumështi është prodhuar nga lopët e qumështit, të trajtuara me somatotropinë;
  - c) ushqimet me origjinë shtazore janë të prodhuara nga kafshët e ushqyera, ose tek të cilat është zbuluar prania e ndotësve dhe mbetjeve të PMV-ve mbi kufijtë maksimalë të përcaktuar.
2. Lejohet përdorimi i PMV-ve hormonale, beta-agonistëve dhe tireostatikëve, të miratuara nga Komisioni Evropian, vetëm për qëllime terapeutike, zooteknike dhe për kërkime shkencore, nën kontrollin e mjekut veterinar.
3. Kushtet dhe procedurat për përdorimin e këtyre PMV-ve përcaktohen me urdhër të ministrit.
4. Ministri përcakton PMV-të, promotorët e rritjes dhe lëndët e tjera ose lëndët e papërpunuara, të cilat ndalohet të futen në ushqimet e kafshëve.
5. Ministri miraton kufijtë maksimalë të lejueshëm të lëndëve dhe të produkteve të padëshirueshme në ushqimet e kafshëve.

### **Neni 83**

#### **Ushqimet e medikuara të kafshëve**

1. Ndalohet futja e lëndëve mjekësore në mënyrë të drejtpërdrejtë në ushqimin dhe ujin e kafshëve.
2. PMV-të përfshihen në ushqimin e medikuar të kafshëve vetëm në formën e premikseve të medikuara.
3. Ushqimi i medikuar i kafshëve prodhohet vetëm në stabilimente të regjistruara, pas lëshimit të recetës nga mjeku veterinar ose përfaqësuesi i autorizuar i tij.
4. Mjeku veterinar, i cili ka lëshuar recetën, i jep udhëzime, me shkrim, pronarit të kafshëve, prej të cilave prodhohet ushqim për konsum njerëzor, për ruajtjen dhe përdorimin e ushqimit të medikuar të kafshëve dhe respektimin e kohës së pezullimit.

### **Neni 84**

#### **Detyrimet për ushqimet e medikuara**

1. Pronari i kafshëve, prej të cilave prodhohen ushqime për konsum njerëzor, detyrohet:
  - a) të respektojë udhëzimet e mjekut veterinar;
  - b) të caktojë një person përgjegjës për përdorimin e ushqimit të medikuar të kafshëve;
  - c) të mbajë një regjistër ditor, në të cilin ai mban shënim përdorimin e ushqimit të medikuar të kafshëve;
  - ç) të respektojë kohën e pezullimit të ushqimit të medikuar të kafshëve.
2. Mjeku veterinar, i cili ka lëshuar recetën, ndjek gjendjen shëndetësore të kafshëve gjatë periudhës së marrjes së ushqimit të medikuar të kafshëve dhe njofton prodhuesin e ushqimit të kafshëve e veterinerin zyrtar, në rast të shfaqjes së ndonjë reaksioni të padëshiruar në kafshë.
3. Ministri miraton kushtet për prodhimin, ruajtjen, përshkrimin, transportin, dekontaminimin, detoksikimin dhe asgjësimin e ushqimit të medikuar të kafshëve.

## **KREU VII**

### **PRODUKTET MJEKËSORE VETERINARE SEKSIONI 1 AUTORIZIMI PËR TREGTIMIN E PRODUKTEVE MJEKËSORE VETERINARE**

### **Neni 85**

#### **Tregtimi i produkteve mjekësore veterinarë**

1. Produktet mjekësore veterinarë, dezinfektantët dhe dezinfestantët për përdorim veterinar tregtohen në Republikën e Shqipërisë, vetëm pasi të jenë miratuar nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse të PMV-ve, të miratuar nga ministri. Deratizuesit lejohet të tregtohen në Republikën e Shqipërisë, pas regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kur një produkt mjekësor veterinar lejohet për tregtim në Republikën e Shqipërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë lejohet të tregtohen edhe variacionet dhe shtesat e këtij produkti, që kanë të bëjnë me llojet e tjera të kafshëve, ku mund të përdoren, me përqendrimin, formën farmaceutike, rrugët e përdorimit e me paraqitjen, sipas procedurave të rregullores përkatëse të PMV-ve.

3. Komisioni Shtetëror i PMV-ve njih dhe pranon certifikatën e tregtimit për PMV-të, lëshuar nga Agjencia Evropiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE-së.
4. Autoriteti kompetent lëshon certifikatën e tregtimit për secilin produkt të miratuar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e miratimit prej komisionit.
5. Produktet e miratuara nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve shënohen në regjistrin zyrtar të PMV-ve.
6. Ministri, në rastet e një gjendjeje të rëndë shëndetësore ose epidemiologjike, me propozimin e Komisionit Shtetëror të PMV-ve, urdhëron lejimin e përkohshëm të tregtimit ose të përdorimit në kafshë të PMV-ve të autorizuara në një nga vendet anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin përkatës.

### **Neni 86**

#### **Përdorimi në kafshë i PMV-ve**

Asnjë produkt mjekësor veterinar pa certifikatë tregtimi, të lëshuar nga autoriteti kompetent, nuk mund të përdoret në kafshë, me përjashtim të rasteve të provave të PMV-ve që janë pranuar nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin veterinar në fuqi.

### **Neni 87**

#### **Procedura për miratimin e tregtimit të PMV-ve 1.**

Shqyrtimi i dosjes së PMV-ve, miratimi nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve dhe lëshimi i certifikatës së tregtimit kryhen brenda një afati prej 210 ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës dhe dosjes së plotë nga kërkuesi.

2. Pas miratimit të PMV-ve nga komisioni, autoriteti kompetent njofton kërkuesin për përmbledhjen e karakteristikave të PMV-ve, që është miratuar.
3. Autoriteti kompetent merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që informacioni për PMV-të, veçanërisht ai që jepet në paketimin dhe udhëzimet e përdorimit, është në përputhje me përmbledhjen e karakteristikave të produktit të miratuar nga komisioni.

### **Neni 88**

#### **Komisioni Shtetëror i PMV-ve**

1. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, urdhëron ngritjen e Komisionit Shtetëror të PMV-ve.
2. Komisionit Shtetëror i PMV-ve kryesohet nga titullari i drejtorisë që mbulon fushën e veterinarisë në ministri dhe ka në përbërje këta anëtarë:
  - a) Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinare;
  - b) drejtuesin e Labororit Shtetëror të Kontrollit të PMV-ve;
  - c) përgjegjës të sektorit që mbulon fushën e veterinarisë në drejtorinë përkatëse në ministri;
  - ç) një specialist nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

### **Neni 89**

#### **Vendimet e komisionit**

1. Komisioni, me shumicë të votave të anëtarëve të tij, merr vendim për pranimin ose refuzimin e kërkesës për tregtim të PMV-ve, mbështetur në rregulloren e përkatëse për këto produkte, të miratuar në zbatim të këtij ligji.
2. Vendimi i komisionit për refuzimin e kërkesës për tregtim mund të ankimohej pranë ministrit.

### **Neni 90**

#### **Mbajtësi i certifikatës së tregtimit**

1. Mbajtësi i certifikatës së tregtimit të PMV-ve njofton, me shkrim, autoritetin kompetent për kohën e hedhjes në treg të PMV-ve.
2. Mbajtësi i certifikatës së tregtimit të PMV-ve njofton, me shkrim, autoritetin kompetent nëse, përkohësisht ose përfundimisht, ndalon hedhjen në treg të PMV-ve të miratuara. Ky njoftim, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, kryhet jo më pak se dy muaj përpara ndërprerjes së hedhjes në treg të këtyre produkteve.
3. Me kërkesën e autoritetit kompetent për farmako-vigjilencën, mbajtësi i certifikatës së tregtimit të PMV-ve i dorëzon autoritetit kompetent të dhëna për vëllimin e shitjeve të PMV-ve.
4. Mbajtësi i certifikatës së tregtimit të PMV-ve regjistron të gjitha reaksionet e dyshuara si të dëmshme në kafshë ose njerëz, që kanë lidhje me përdorimin e PMV-ve, të cilat i raportohen atij, dhe menjëherë njofton autoritetin kompetent për ngjarjen e ndodhur, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes dijeni.
5. Mbajtësi i certifikatës së tregtimit të PMV-ve është përgjegjës për tregtimin e PMV-ve dhe nuk mund të shmanget nga përgjegjësitë ligjore.

### **Neni 91**

#### **Certifikata e tregtimit**

1. Certifikata e tregtimit të PMV-ve është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare.
2. Certifikata e tregtimit mund të rinovohet pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, sipas rregullores përkatëse.
3. Në rastin e rinovimit, vlefshmëria e certifikatës së tregtimit është e pakufizuar në kohë.
4. Certifikata e tregtimit të PMV-ve humbet vlefshmërinë nëse produkti nuk hidhet në treg brenda 3 viteve nga data e miratimit nga komisioni.
5. Certifikata e tregtimit të PMV-ve humbet vlefshmërinë nëse produkti nuk tregtohet për një periudhë 3-vjeçare të pandërprerë.

## **SEKSIONI 2**

### **PRODHIMI, IMPORTI DHE TREGTIMI I PMV-VE**

### **Neni 92**

#### **Prodhimi i PMV-ve në vend**

1. Veprimtaria e prodhimit të PMV-ve në vend kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Licenca e prodhimit të PMV-ve u jepet subjekteve që kryejnë njëkohësisht ose në mënyrë të



veçantë veprimtari të tilla si: ndarjen, shtypjen e tabletave, paketimin, përzierjen ose prodhimin e lëndëve aktive.

3. Ministri miraton procedurat e prodhimit të PMV-ve.

### **Neni 93**

#### **Detyrimet e prodhuesit të PMV-ve në vend**

1. Prodhuesi i PMV-ve në vend mban dokumentacionin e hollësishëm për të gjitha PMV -të e prodhuara prej tij, përfshi dhe mostrat e PMV-ve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Prodhuesi i PMV-ve mban dokumentacionin, ku evidentohen data e prodhimit dhe e shitjes, emërtimi i produkteve, sasi të e PMV-ve të prodhuara dhe të shitura, numri dhe të dhëna për jetëgjatësinë e porcionit të PMV-së, emri dhe adresa e blerësit.
3. Dokumentacioni, sipas pikës 2 të këtij neni, ruhet për një periudhë 3-vjeçare dhe i paraqitet autoritetit kompetent me kërkesën e këtij të fundit.

### **Neni 94**

#### **Tregtimi me shumicë i PMV-ve**

1. Veprimtaria e tregimit me shumicë të PMV-ve në vend kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Tregtarët me shumicë të PMV-ve kanë të drejtën t'ia shesin këto produkte tregtarëve të tjerë me shumicë, farmacive veterinarë, mjekëve veterinarë që ushtrojnë praktikën mjekësore veterinarë, si dhe pronarëve e fermave të mbarështimit të kafshëve, në bazë të një recete të lëshuar nga mjeku veterinar që ushtron praktikën veterinarë.
3. Tregtarët me shumicë të PMV-ve mbajnë dokumentacionin e hollësishëm, ku evidentohen data e shitjes, emërtimi dhe sasi të e PMV-ve të shitura, numri dhe të dhëna për jetëgjatësinë e porcionit të PMV-së, emri dhe adresa e blerësit.
4. Tregtarët me shumicë, një herë në vit, kryejnë një rishikim të plotë të sasive të PMV-ve të blera, të shitura, si dhe të gjendjes në magazina. Të gjitha mospërputhjet e konstatuara regjistrohen.
5. Dokumentacioni, sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, ruhet për një periudhë 3-vjeçare dhe i paraqitet autoritetit kompetent me kërkesën e këtij të fundit.
6. Kushtet për qendrat e tregimit me shumicë të PMV-ve përcaktohen nga autoriteti kompetent dhe miratohen nga ministri.

### **Neni 95**

#### **Asgjësimi i PMV-ve**

1. Pronari i një partie të PMV-ve ose një person i autorizuar prej tij asgjëson partinë në rastet kur:
  - a) periudha e përdorimit të partisë ka skaduar;
  - b) parametrat e cilësisë kanë ndryshuar, si rrjedhojë e ruajtjes ose transportit të papërshtatshëm.
2. Personat e përmendur më sipër, në prani të veterinerit zyrtar, mbajnë procesverbalin e asgjësimit të PMV-ve, ku shënohen lloji, sasia, numri i partisë, arsyet dhe mënyra e asgjësimit.
3. Shpenzimet për asgjësimin e partisë së PMV-së së refuzuar mbuloen nga pronari i tyre.

### **Neni 96**

## **Shitja me pakicë**

1. Shitja me pakicë e PMV-ve kryhet vetëm në farmacitë veterinare nga persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Drejtuesit e farmacive veterinare dhe personat që shesin PMV, duhet të jenë mjekë veterinarë të pajisur me certifikatën e kursit të farmacisë veterinare.
3. Rregullorja për kërkesat, që duhet të plotësojnë farmacitë veterinare, miratohet nga ministri.
4. Në farmacitë veterinare kryhen veprimtaritë e mëposhtme:
  - a) mbajtja dhe shitja e PMV-ve, instrumenteve, pajisjeve dhe mjeteve për mjekësinë veterinare dhe mbarështimin e kafshëve, si dhe ushqimeve të kafshëve të shoqërimit dhe ushqimeve të kafshëve dekorative, në paketimin e tyre origjinal;
  - b) përgatitja dhe lëshimi i barnave veterinare, sipas një recete të farmakopesë.

### **Neni 97**

#### **Ndalimet në shitjen me pakicë**

1. Ndalohet tregtimi në farmaci veterinare i PMV-ve, të cilat nuk janë pajisur me certifikatën e tregtimit, sipas neneve 85 e 91 të këtij ligji.
2. Ndalohet tregtimi në farmaci veterinare i PMV-ve me efekt imunologjik kundër sëmundjeve, të cilat janë përfshirë në programin e profilaksisë shtetërore.
3. Ndalohet lëshimi i recetave veterinare nga drejtuesit e farmacive veterinare dhe farmacistët veterinarë.

### **Neni 98**

#### **Dokumentacioni në farmacitë veterinare**

1. Farmacia veterinare mban një regjistër ditor, ku evidentohen data dhe sasi të blerjeve dhe të shitjeve të PMV-ve, emërtimi dhe numri i PMV-ve, të dhëna për jetëgjatësinë e porcionit të PMV-së, emri dhe adresa e furnizuesit dhe blerësit, emri dhe adresa e mjekut veterinar që ka lëshuar recetën.
2. Farmacia veterinare, një herë në vit, kryen një rishikim të plotë të sasive të PMV-ve të blera, të shitura dhe të gjendjes në magazina. Të gjitha mospërputhjet e konstatuara regjistrohen.
3. Dokumentacioni, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ruhet për një periudhë 3-vjeçare dhe i paraqitet autoritetit kompetent me kërkesën e këtij të fundit.

### **Neni 99**

#### **PMV-të që shiten vetëm me recetë nga mjeku veterinar**

Me qëllimin e ruajtjes së shëndetit publik dhe të shëndetit të kafshëve, PMV-të e mëposhtme shiten vetëm të shoqëruara me recetë e lëshuar nga mjeku veterinar që ushtron veprimtarinë në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe mbështetur në rregulloren përkatëse:

- a) PMV-të, të cilat u nënshtrohen kufizimeve zyrtare për qarkullimin ose përdorimin, të tilla si:
  - i) kufizime, si rrjedhojë e zbatimit të konventave të OKB-së për lëndët narkotike dhe psikotrofike;
  - ii) kufizime për përdorimin e PMV-ve, të vendosura nga legjislacioni i BE-së;
- b) PMV-të, që përdoren te kafshët prodhuese të ushqimeve dhe që kanë një kohë pezullimi.

**Neni 100**  
**Koha e pezullimit të PMV-ve**

Kur koha e pezullimit nuk është dhënë për P MV-në, që përdoret në kafshët prodhuese, zbatohen afatet minimale si më poshtë:

- a) 7 ditë, për vezët dhe qumështin;
- b) 28 ditë, për mishin e shpendëve dhe gjitarëve, dhjamin dhe të brendshmet;
- c) 500 ditë-gradë, për produktet e peshkut (shumëzimi i temperaturës së ujit në gradë Celsius me ditët e pezullimit).

**SEKSIONI 3**  
**PAKETIMI DHE KONTROLLI I PMV-VE**

**Neni 101**  
**Paketimi i PMV-ve**

1. Komisioni miraton paketimin e njësisë dhe paketimin e jashtëm të PMV-së së miratuar.
2. Paketimi përmban informacionin, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren përkatëse të PMV-ve si më poshtë:
  - a) emërtimin e PMV-së, formën farmaceutike dhe lëndën aktive;
  - b) numrin e porcionit të prodhuesit;
  - c) numrin e certifikatës së tregtimit;
  - ç) llojin e kafshëve në të cilat përdoret PMV-ja, së bashku me dozën dhe rrugën e përdorimit;
  - d) kohën e pezullimit për PMV-të për kafshët, prej të cilave prodhohen ushqime;
  - dh) kushtet e veçanta të ruajtjes;
  - e) datën e skadencës. Neni 102 Sistemi i farmako-vigjilencës
1. Autoriteti kompetent merr masa për ngritjen dhe administrimin e një sistemi të farmako-vigjilencës.
2. Autoriteti kompetent merr masa për të siguruar njoftimin e reaksioneve të kundërta në kafshë, të dyshuara se ndodhin nga përdorimi i PMV-ve.
3. Shërbimi veterinar siguron shkëmbimin e informacionit nga sistemi i farmako-vigjilencës, që lidhet me PMV-të, të cilat janë lejuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë.
4. Gjatë vlerësimit të të dhënave nga farmako-vigjilencia, kur autoriteti kompetent konsideron se një certifikatë tregtimi e PMV-ve duhet tërhequr, përfunduar ose ndryshuar, njofton menjëherë mbajtësin e certifikatës së tregtimit të PMV-ve, si dhe Agjencinë Evropiane të Medikamenteve.
5. Në rast të një nevoje të menjëhershme për ruajtjen e shëndetit të njeriut ose të kafshëve, autoriteti kompetent mund të shfuqizojë certifikatën e tregtimit të PMV-ve. Në këtë rast, autoriteti kompetent njofton autoritetet e shëndetit publik, Agjencinë Evropiane të Medikamenteve dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dypalëshe, si dhe palët e interesuara, jo më vonë se 1 ditë pune, pas shfuqizimit.
6. Kushtet dhe procedurat për mbledhjen, përmbajtjen dhe dërgimin e informacionit të farmakovigjilencës miratohen nga ministri.

### Neni 103

#### Kontrolli shtetëror i PMV-ve

1. Autoriteti kompetent mbikëqyr prodhimin, shitjen me shumicë dhe pakicë, importin dhe përdorimin e PMV-ve.
2. Autoriteti kompetent kryen kontrole në vend edhe me kërkesën e autoriteteve kompetente të vendeve anëtare të interesuara, Komisionit Evropian dhe të Agjencisë Evropiane për Medikamentet.
3. Shërbimi veterinar rajonal kryen mbikëqyrjen në vend dhe kryen testime laboratorike të mostrave të PMV-ve.

### Neni 104

#### Pezullimet e certifikatës së tregtimit

1. Autoriteti kompetent i propozon komisionit pezullimin e certifikatës së tregtimit në rastet e mëposhtme:
  - a) kur PMV-ja nuk zotëron asnjë efekt terapeutik mbi llojet e kafshëve të cilat janë përkrahur në udhëzimet e përdorimit;
  - b) kur përbërja sasiore dhe cilësore e PMV-ve nuk përputhet me atë që është deklaruar;
  - c) kur koha e rekomanduar e pezullimit është e papërshtatshme për të garantuar që ushqimet e përfuara nga kafshët e trajtuara me PMV nuk përmbajnë mbetje, të cilat përbëjnë rrezik për shëndetin e konsumatorit;
  - ç) kur PMV-ja ofrohet për tregtim për një përdorim që është i ndaluar nga legjislacioni në fuqi;
  - d) me kërkesën e vetë mbajtësit të certifikatës së tregtimit;
  - dh) në rastin e pezullimit të veprimtarisë tregtare të mbajtësit të certifikatës së tregtimit.
2. Vendimi i komisionit për pezullimin e certifikatës së tregtimit mund të ankimohej pranë ministrit.

## **KREU VIII**

### **ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I PRAKTIKËS MJEKËSORE VETERINARE SEKSIONI 1 PRAKTIKA MJEKËSORE VETERINARE**

#### **Neni 105**

#### **Zbatimi i praktikës mjekësore veterinarë**

Praktikën mjekësore veterinarë mund ta ushtrorjnë personat, që kanë kualifikimin e duhur profesional dhe janë të regjistruar në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar dhe në shërbimin veterinar si më poshtë:

- a) mjekët veterinarë;
- b) farmacistët veterinarë;
- c) teknikët veterinarë (me arsim parauniversitar);
- ç) teknikët e ndërzimit (inseminatorët).

#### **Neni 106**

#### **Kryerja e veprimtarive veterinarë**

1. Veprimtaritë veterinare kryhen nga persona fizikë ose juridikë në njësi të shërbimit veterinar privat, që janë:
  - a) klinikat dhe spitalet veterinare;
  - b) qendrat për riprodhimin dhe ndërzimin artificial;
  - c) farmacitë veterinare;
  - ç) laboratorët veterinarë.
2. Një njësi e shërbimit veterinar privat mund të themelohet në një nga format ligjore të parashikuara në legjislacionin tregtar të Republikës së Shqipërisë.
3. Ortakët dhe administratorët e njësive të shërbimit veterinar privat regjistrohen në regjistrin përkatës të autoritetit kompetent.
4. Mbrojtja e shëndetit të kafshëve dhe zbatimi i praktikës mjekësore veterinare duhet të sigurohet në çdo njësi administrative epidemiologjike të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 107**

#### **Veprimtaritë veterinare nga institucione të tjera**

1. Veprimtari të caktuara të praktikës mjekësore veterinare kryhen nga institucionet e edukimit profesional veterinar (FMV dhe shkolla) dhe Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare (ISUV).
2. Disa veprimtari të praktikës mjekësore veterinare mund të kryhen edhe nga punonjës të shërbimit veterinar shtetëror, në përputhje me nenin 133 të këtij ligji.

#### **Neni 108**

#### **E drejta e ushtrimit të profesionit**

Të drejtën e ushtrimit të praktikës mjekësore veterinare në Republikën e Shqipërisë e gëzojnë personat fizikë, shqiptarë ose të huaj, që janë diplomuar si mjekë veterinarë nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare i Universitetit Bujqësor të Tiranës, çdo fakultet tjetër i mjekësisë veterinare, i themeluar dhe njohur sipas ligjeve në fuqi, ose nga universitete të huaja, diploma e të cilave u është nënshtruar procedurave të njohjes nga ministria përgjegjëse për arsimin në Republikën e Shqipërisë.

### **SEKSIONI 2**

### **MJEKËT DHE TEKNIKËT VETERINARË**

#### **Neni 109**

#### **Mjekët veterinarë**

1. Mjekët veterinarë mund të ushtrojnë profesionin në sektorin veterinar privat, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë profesionet e lira në Republikën e Shqipërisë.
2. Mjekët veterinarë, të cilët ushtrojnë profesionin në sektorin veterinar privat, kanë vulën e tyre, sipas modelit të miratuar nga autoriteti kompetent.
3. Mjeku veterinar duhet të dorëzojë një model të vulës pranë shërbimit veterinar rajonal.

#### **Neni 110**

## **Detyrat e mjekut veterinarë**

Mjeku veterinar, që ushtron një praktikë mjekësore veterinare, është i detyruar:

- a) të marrë masa kufizuese dhe të njoftojë menjëherë shërbimin veterinar rajonal, përmes dërgimit të formularit të raportimit të sëmundjeve, për çdo rast dyshimi për praninë e sëmundjeve infektive të listës, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji;
- b) të zbatojë udhëzimet e shërbimit veterinar për profilaksinë, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive dhe sëmundjeve të tjera në shkallë të gjerë;
- c) të shënojë në regjistrin ditor të mbarështimit të kafshëve të prodhimit;
- i) datën e trajtimit me PMV;
- ii) emërtimin, numrin e partisë, datën e skadencës dhe kohën e pezullimit të PMV-ve;
- ç) të njoftojë pronarin ose kujdestarin e kafshëve të prodhimit për kohën e pezullimit të PMV-ve ose për efektet shëndetësore të ushqimeve të medikuara të kafshëve;
- d) t'i dërgojë, çdo muaj, shërbimit veterinar rajonal të dhënat për pasaportat mjekësore veterinare, të lëshuara për kafshët e shoqërimit, të regjistruara;
- dh) t'i dorëzojë veterinerit zyrtar ose inspektorit veterinar, me kërkesën e tyre, dokumentacionin e mbajtur;
- e) t'i dorëzojë shërbimit veterinar rajonal një raport për reaksionet e papritura dhe të rënda, të vërejtura në njerëz dhe në kafshë pas përdorimit të PMV-ve;
- ë) të njoftojë menjëherë shërbimin veterinar rajonal për parregullsitë e vërejtura në mbledhjen e kadavrave të kafshëve dhe groposjen e tyre;
- f) të lëshojë receta dhe të respektojë kërkesat për përdorimin e produkteve hormonale, betaagonistëve dhe tireostatikëve ose PMV-ve dhe të lëndëve të tjera, për qëllime mjekësore dhe zooteknike, në kafshët e prodhimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) të kryejë kontrollin, pas ngordhjes së kafshëve, në rastet kur lejohet nga rregulloret përkatëse, të marrë mostra dhe t'i dërgojë në laboratorin veterinar për analiza për konfirmimin e diagnozës;
- gj) të marrë si ndihmës në zbatimin e praktikës mjekësore veterinare vetëm persona që kanë një arsim mjekësor veterinar;
- h) të zbatojë kërkesat e praktikës mjekësore veterinare dhe të respektojë etikën profesionale gjatë ushtrimit të profesionit.

### **Neni 111**

#### **Teknikët veterinarë**

1. Teknikët veterinarë mund të ushtrojnë profesionin në sektorin veterinar privat, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë profesionet e lira në Republikën e Shqipërisë.
2. Tekniku veterinar kryen praktikën mjekësore veterinare nën kontrollin dhe drejtimin e një mjeku veterinar.
3. Tekniku veterinar kryen këto detyra:
  - a) njofton menjëherë mjekun veterinar, nën kontrollin e të cilit punon, ose shërbimin veterinar rajonal për çdo rast dyshimi për praninë e sëmundjeve infektive të listës, sipas përcaktimeve të nenit 14;
  - b) kryen trajtimet veterinare, të urdhëruara nga mjeku veterinar, nën kontrollin e të cilit punon;
  - c) merr kampione dhe i dërgon për analiza në laboratorin veterinar;
  - ç) kryen dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e vendeve, kullotave dhe terreneve;

d) zbaton dhe përmbush udhëzimet e autoriteteve të kontrollit në fushën e përmirësimit gjenetik dhe riprodhimit kur kryen ndërzimin artificial në kafshët e prodhimit.

## **Neni 112**

### **Teknikët e ndërzimit**

1. Tekniku i ndërzimit kryen veprimtarinë e tij, në përputhje me nenin 105 të këtij ligji.
2. Tekniku i ndërzimit regjistrohet në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar dhe shërbimin veterinar, sipas rregullores përkatëse.

## **SEKSIONI 3**

### **URDHRI PROFESIONAL I MJEKUT VETERINAR DHE SHOQATAT VETERINARE**

## **Neni 113**

### **Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar**

1. Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar është organizimi në nivel kombëtar i mjekëve veterinarë që përfaqëson interesat e përbashkët dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.
2. Misioni i Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit, si dhe mbrojtja e publikut nga kequshtrimi i profesionit.
3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar përcaktohen në ligjin përkatës.
4. Në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar të Republikës së Shqipërisë regjistrohen mjekët veterinarë, farmacistët veterinarë, teknikët veterinarë dhe teknikët e ndërzimit, të cilët ushtrojnë praktikën veterinare, shtetërore ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 114**

### **Klinika dhe spitali veterinar**

1. Klinika dhe spitali veterinar janë njësi të shërbimit veterinar privat, që kryejnë veprimtari të praktikës mjekësore veterinare në një territor të caktuar të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.
2. Në një klinikë veterinare punësohet jo më pak se 1 mjek veterinar i regjistruar.
3. Në një spital veterinar punësohen jo më pak se 3 mjekë veterinarë të regjistruar.

## **Neni 115**

### **Veprimtaritë e klinikës ose të spitalit veterinar**

Në klinikën ose spitalin veterinar, në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së tyre, kryhen veprimtaritë e mëposhtme:

- a) ekzaminimi i kafshëve të sëmura dhe nekropsia e kadavrave të kafshëve, duke përcaktuar edhe shkaqet e sëmundjeve ose të ngordhjes së kafshëve dhe diagnozën e sëmundjeve të caktuara, si dhe trajtimi mjekësor i kafshëve me sëmundje infektive ose joinfektive e mbajtja nën vëzhgim e kafshëve;
- b) zbatimi i masave shëndetësore veterinare për parandalimin, zbulimin, kontrollin dhe çrënjosjen e

sëmundjeve infektive në kafshë;

c) zbulimi dhe raportimi i sëmundjeve infektive ose dyshimet për sëmundje infektive të lajmërueshme;

ç) ndërhyrja kirurgjikale, obstetrike, si dhe procedura të tjera të praktikës mjekësore veterinare;

d) trajtimi mjekësor për infertilitetin, ndërzimin artificial të kafshëve dhe transferimi i vezëve të fertilizuara (transferimi i embrionit);

dh) dhënia e ndihmës së kualifikuar profesionale për pronarët ose kujdestarët e kafshëve për shëndetin veterinar dhe mbarështimin e kafshëve, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të kafshëve, mirëqenien dhe riprodhimin e tyre;

e) mbajtja e regjistrit të veprimtarive mjekësore veterinare;

ë) dhënia e certifikatave shëndetësore veterinare për procedura në kafshët e gjalla, me materialin biologjik për ndërzim artificial dhe për vezët e fertilizuara, sipas akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji;

f) identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve, sipas akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji;

g) marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit veterinar, në mënyrë që të parandalojë dhe të kontrollojë përhapjen e sëmundjeve infektive (dezinfektim, dezinfestim, deratizim, dekontaminimin radiologjik).

## Neni 116

### Veprimtaritë e deleguara të klinikës veterinare

1. Veprimtaritë e mëposhtme mund të kryhen nga klinika veterinare me anë të një kontrate 1-vjeçare me autoritetin kompetent, të lidhur në bazë të procedurave në fuqi të prokurimit publik:

a) identifikimi dhe regjistrimi i fermës dhe matrikullimi i kafshëve të prodhimit ose i kafshëve të tjera, si dhe i kafshëve të reja në fermë, sipas rregullores përkatëse;

b) kontrolli i rregullt vjetor i gjendjes së kafshëve të prodhimit ose kafshëve të tjera në fermë, rimatrikullimi i kafshëve që nuk plotësojnë kërkesat e identifikimit, sipas rregullores përkatëse;

c) zbatimi praktik i programeve të profilaksisë shtetërore për sëmundjet në kafshë në një njësi administrative të përcaktuar;

ç) zbatimi i masave për kontrollin dhe çrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, në vatrat e shpërthimeve.

2. Klinika veterinare, e cila është kontraktuar për të kryer veprimtaritë, sipas këtij neni, siguron përmbushjen e këtyre veprimtarive gjatë gjithë kohës dhe në përputhje me kushtet e kontratës.

3. Në rast se klinika veterinare e kontraktuar, gjatë kryerjes së veprimtarive veterinare, nuk përmbush kushtet e kontratës së lidhur me autoritetin kompetent, ky i fundit mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, sipas mënyrave dhe procedurave të përcaktuara, dhe ka të drejtën të kërkojë dëmshpërblimin dhe penalitetet, sipas parashikimeve të kontratës.

## Neni 117

### Kontrata për delegimin e veprimtarive

Pas përfundimit të procedurës së prokurimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore, kontrata për delegimin e veprimtarive nënshkruhet nga autoriteti kompetent dhe titullari i klinikës veterinare. Kontrata përfshin dispozita të përcaktuara në aktet nënligjore.



## **Neni 118**

### **Qendrat për riprodhimin dhe ndërzimin artificial**

Qendrat për riprodhimin dhe ndërzimin artificial janë njësi të shërbimit veterinar privat, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren përkatëse dhe regjistrohen në regjistrin e autoritetit kompetent.

Qendrat kryejnë veprimtaritë e mëposhtme:

- a) prodhimin e kafshëve cilësore të riprodhimit;
- b) testet e riprodhimit në kafshët riprodhuese;
- c) ndërzimin artificial të kafshëve;
- ç) dhënien e ndihmës së kualifikuar profesionale në zbatimin e ndërzimit artificial dhe kontrollin e infertilitetit në kafshë;
- d) mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe aftësive të tyre riprodhuese;
- dh) zbulimin dhe raportimin e rasteve të sëmundjeve infektive ose të dyshimeve për raste të një sëmundjeje infektive, që ndikon negativisht në aftësitë riprodhuese të kafshëve, ose që mund të përhapet përmes praktikave të ndërzimit artificial;
- e) analizën laboratorike të materialit biologjik (spermës) që përdoret për ndërzimin artificial dhe të vezëve të fertilizuara (plenuara);
- ë) kualifikime të teknikëve në fushën e ndërzimit artificial dhe atë të riprodhimit të kafshëve;
- f) monitorime dhe kërkime shkencore, që lidhen me riprodhimin e kafshëve dhe gjenetikën;
- g) veprimtari të tjera, që ndihmojnë në përmirësimin e veprimtarisë veterinarë dhe mbarështimin e kafshëve, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

## **Neni 119**

### **Laboratorët veterinarë private**

1. Laboratorët veterinarë privatë janë njësi të shërbimit veterinar privat, të miratuara nga ministri, të regjistruara në shërbimin veterinar dhe të akredituara në përputhje me standardet kombëtare.

2. Laboratorët veterinarë privatë drejtohen nga një mjek veterinar me kualifikimin dhe njohuritë e përshtatshme në fushën e laboratorit.

3. Laboratorët veterinarë privatë kryejnë veprimtaritë e mëposhtme:

- a) analizat për diagnozën e sëmundjeve infektive në kafshë ose për të vërtetuar se kafshët nuk janë të infektuara;
- b) analizat për kontrollin e shkallës së mbrojtjes, të siguruar nga profilaksia veterinarë (titri i antitropave);
- c) marrin pjesë në programe të monitorimit të situatës epidemiologjike, në bashkëpunim me strukturat e shërbimit veterinar, laboratorët veterinarë të Qendrës Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinarë dhe Fakultetit të Mjekësisë Veterinarë;
- ç) marrin pjesë në zbatimin e studimeve në fushën e mjekësisë veterinarë, të miratuara nga autoriteti kompetent.

## **KREU IX**

### **LABORATORËT VETERINARË SHTETËRORE DHE EDUKIMI PROFESIONAL VETERINAR**

## **Neni 120**

### **Laboratorët shtetërorë veterinarë**

1. Laboratorët veterinarë shtetërorë, të cilët kryejnë analizat laboratorike veterinarë për kampionet e marra gjatë kontrolleve zyrtare, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, miratohen nga ministri.
2. Laboratorët veterinarë shtetërorë akreditohen në përputhje me standardet kombëtare.
3. Tarifat për kryerjen e analizave nga laboratorët veterinarë shtetërorë përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.
4. Laboratorët veterinarë shtetërorë kryejnë, pa pagesë, analizat për kampionet e marra:
  - a) gjatë kontrolleve zyrtare;
  - b) gjatë zbatimit të programeve vjetore dhe kombëtare, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - c) në rastet e dyshimeve për praninë e sëmundjes infektive, sipas përcaktimit të nenit 14 të këtij ligji.
5. Në mënyrë përjashtimore nga pika 4 e këtij neni, analizat laboratorike veterinarë kryhen kundrejt pagesës kur qëllimi i testimit është për arsye tregtare.
6. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, miraton listën e laboratorëve veterinarë shtetërorë, në të cilën përcaktohen tipi i laboratorit dhe analizat që kryhen. Lista botohet në Fletoren Zyrtare dhe shpallet në faqen zyrtare të ministrisë e përditësohet për një periudhë 6-mujore.

## **Neni 121**

### **Laboratorët veterinarë të autorizuar**

1. Analizat për kampionet e marra gjatë kontrolleve zyrtare kryhen në laboratorët shtetërorë ose privatë, të cilët janë autorizuar për kryerjen e këtyre analizave nga ministri, me propozimin e autoritetit kompetent.
2. Lista e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, ku përcaktohen tipi i laboratorit dhe analizat që çdo laborator autorizohet të kryejë, miratohet me urdhër të ministrit dhe botohet në Fletoren Zyrtare çdo fillim viti.
3. Ministri miraton kriteret, që duhet të plotësojë laboratori për t'u autorizuar, sipas pikës 1 të këtij neni.

## **Neni 122**

### **Veprimtaria e laboratorëve veterinarë**

1. Laboratorët veterinarë ushtrojnë veprimtarinë për:
  - a) analizat diagnostike të kampioneve të kafshëve dhe produkteve embrionale, për profilaksinë, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve;
  - b) ekzaminime për sigurinë e nënprodukteve dhe të produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor.
2. Veprimtaritë laboratorike të përmendura në pikën 1 të këtij neni, kryhen sipas metodave të miratuara nga Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinarë.
3. Kryerja e analizave konfirmuese të sëmundjeve infektive në laboratorët ndërkombëtarë të referencës bëhet me autorizim të autoritetit kompetent.

## **Neni 123**

## **Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare**

1. Si Qendër Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare shërben Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i cili është institucion qendror, në varësi të ministrit, dhe pjesë e rrjetit të shërbimit veterinar kombëtar.
2. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent, miraton laboratorët kombëtarë të referencës, për diagnozën e sëmundjeve të veçanta të kafshëve.
3. Laboratorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni duhet:
  - a) të kenë të përcaktuara dhe të akredituara llojet e provave laboratorike që kryhen;
  - b) të zbatojnë dhe të përmbushin kushtet e përcaktuara në praktikën e mira laboratorike;
  - c) të jenë efektivë në komunikimin dhe bashkëpunimin me laboratorët brenda vendit, si dhe laboratorët respektivë të referencës të BE-së e të OIE-së;
  - ç) të zbatojnë standardet ndërkombëtare në fuqi të OIE-së dhe BE-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë laboratorike.

### **Neni 124**

#### **Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinare**

1. Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare është përgjegjëse për:
  - a) kryerjen e analizave laboratorike, në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit dhe survejancës së situatës epidemiologjike të sëmundjeve infektive, zoonozave dhe mbetjeve toksike;
  - b) kontrollin e mbetjeve të substancave me efekt anabolik dhe të paautorizuara, biopreparateve dhe barnave veterinarë në kafshët e gjalla dhe produktet e tyre;
  - c) kryerjen e analizave laboratorike për vendosjen e diagnozës për sëmundjet infektive të kafshëve;
  - ç) prodhimin e biopreparateve veterinarë, si vaksina, antigene, alergene, serume, serume hiperimune, për përdorim, në diagnostikimin e sëmundjeve infektive dhe zoonozave e në luftimin e tyre, mbështetur në kërkesën e autoritetit kompetent;
  - d) kontrollin mikrobiologjik, kimik dhe toksikologjik të produkteve ushqimore me origjinë shtazore, të nënprodukteve me origjinë shtazore, të ushqimeve të kafshëve, të cilat janë prodhuar në, importohen për në, ose eksportohen nga Republika e Shqipërisë;
  - dh) kualifikimin e specialistëve dhe të teknikëve të laboratorëve veterinarë;
  - e) bashkërendimin e studimeve kërkimore dhe shkencore për të zbatuar metoda të reja diagnostike për sëmundjet e kafshëve;
  - ë) drejtimin metodologjik të laboratorëve veterinarë përmes:
    - i) bashkërendimit të punës në zbatimin e standardeve dhe të metodave për analizat laboratorike;
    - ii) kontrollit të skemave që garantojnë cilësinë e provave;
    - iii) sigurimit dhe miratimit të metodave standarde për diagnozën e sëmundjeve të kafshëve;
    - iv) sigurimit të materialeve standarde të referencës dhe kampioneve standarde;
    - v) asistencës së plotë teknike;
  - f) kryerjen e analizave laboratorike për kampionet, rezultatet e të cilave janë kontestuar, pasi janë nxjerrë nga laboratorët e tjerë veterinarë në vend;
  - g) përgatitjen dhe organizimin e studimeve krahasuese ndërlaboratorike brenda vendit;
  - gj) pjesëmarrjen në studime krahasuese ndërlaboratorike nga laboratorët e referencës së BE-së dhe OIE-së;

h) vlerësimin e laboratorëve veterinarë, nëse janë të aftë për kryerjen e analizave të miratuara, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Kriteret, mbi të cilat kryhet vlerësimi i laboratorëve, miratohen nga ministri.

### **Neni 125**

#### **Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar (LSHKV)**

1. Në përbërje të shërbimit veterinar ngrihet dhe funksionon Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar, që kontrollon produktet mjekësore veterinare (barna dhe bioprodukte), të prodhuara në vend ose të importuara.

2. Biopreparatet në vend prodhohen nga njësi të autorizuara nga ministria dhe përdoren pasi të jenë kontrolluar nga LSHKV-ja.

3. Tarifat për kryerjen e analizave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

### **Neni 126**

#### **Shkollat e studimeve të larta të mjekësisë veterinare (SHMV-të)**

Shërbimi veterinar bashkëpunon me SHMV-të për përmirësimin e edukimit dhe të veprimtarive shkencore veterinare, përmes kryerjes së veprimtarive të mëposhtme:

a) diagnozës klinike dhe laboratorike të sëmundjeve të kafshëve;

b) trajtimit mjekësor veterinar;

c) nekropsisë mbi karkasat e kafshëve dhe kryerjen e testeve pato-fiziologjike në organet e kafshëve;

ç) kryerjes së kërkimit shkencor, zbatimit dhe përmirësimit të metodave kimike, histologjike, biokimike, histokimike, ekologjike, mikrobiologjike, urologjike, parazitare, radiologjike, radiokimike, si dhe analizave të tjera në organe, gjak, serum, rrjedhje nga kafshët, ushqime për kafshë, ushqime me origjinë shtazore ose lëndë të tjera biologjike, tokë, ujë, ajër dhe, në përfundim të tyre, dhënies së mendimit të kualifikuar në lidhje me këto çështje;

d) kryerjes së studimeve, përllogaritjeve, projekteve në fushën e veprimtarive veterinare, përkujdesjes dhe mirëqenies së kafshëve, prodhimit, ushqimit për kafshë, si dhe përpunimit e tregtimit të kafshëve dhe të produkteve me origjinë shtazore;

dh) kryerjes së kërkimit, monitorimit dhe analizës së shpërthimeve të sëmundjeve, shpërndarjes së sëmundjeve infektive dhe joinfektive në kafshë;

e) drejtimit të kërkimit ose prodhim it të produkteve farmaceutike veterinare, biologjike dhe të produkteve biocide, me qëllim trajtimin mjekësor të kafshëve, si dhe luftimin e sëmundjeve të kafshëve;

ë) organizimit dhe ndërmarrjes, në bashkëpunim me shërbimin veterinar, Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar, Qendrën Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinare, të kualifikimit të vazhdueshëm profesional të strukturave të Shërbimit Veterinar Shtetëror;

f) dhënies së asistencës profesionale veterinare për shërbimin veterinar privat, operatorëve të biznesit të mbarështimit të kafshëve, të punës racore, të prodhuesve të ushqimeve me origjinë shtazore dhe ushqimeve për kafshë dhe të medikamenteve veterinare.

### **KREU X**

## **ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT E SHËRBIMIT VETERINAR**

### **Neni 127**

#### **Shërbimi veterinar**

1. Shërbimi veterinar organizohet si sistem i njësuar dhe ushtron veprimtarinë, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Shërbimi Veterinar Shtetëror integron në sistem edhe struktura, që kryejnë veprimtari veterinare në institucione të tjera publike dhe përcakton detyrimet, përgjegjësitë dhe komunikimin e këtyre strukturave me Shërbimin Veterinar Shtetëror në të gjithë veprimtarinë e tyre veterinare, veçanërisht në situata emergjente.
3. Shërbimi veterinar është pjesë përbërëse e rrjetit veterinar ndërkombëtar e rajonal, që bashkëpunon me OIE-në, organet homologe të Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera, organizma të tjerë ndërkombëtarë në fushën përkatëse, si dhe me të gjitha vendet, me të cilat ka marrëveshje dypalëshe.
4. Përfaqësuesit zyrtarë pranë organizmave ndërkombëtarë ose rajonalë në fushën e veterinarisë emërohen nga ministri.

### **Neni 128**

#### **Përbërja e shërbimit veterinar**

1. Shërbimi veterinar drejtohet nga autoriteti kompetent që mbulon veprimtarinë veterinare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Shërbimi veterinar funksionon në bazë të ndarjes territoriale-administrative të vendit.
3. Shërbimi veterinar rajonal përbëhet nga veterinerë zyrtarë, që punojnë në strukturat rajonale të ministrisë, të cilët mbulojnë një territor të caktuar në rajonin përkatës.
4. Strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore mbulojnë veprimtaritë veterinare, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Mjekët veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore janë në varësi teknike nga shërbimi veterinar rajonal.
5. Shërbimi veterinar privat është pjesë përbërëse e shërbimit veterinar.

### **Neni 129**

#### **Kompetencat e autoritetit kompetent**

Autoriteti kompetent ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) harton politikat e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- b) harton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive veterinare, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- c) propozon përmirësimin e legjislacionit veterinar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke e përafëruar e harmonizuar atë me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- ç) monitoron dhe harton raporte për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat që kryejnë veprimtari veterinare;
- d) informon institucionet shtetërore, strukturat e shëndetit publik, palët e interesuara në vend, OIE-

në, BE-në dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) administron mjetet financiare për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen nga zoonozat, si dhe trajnimet e specialistëve, të miratuara më parë me urdhër të ministrit;

ë) mbron shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve në:

i) mbarështimin e tyre;

ii) prodhimin dhe ruajtjen e produkteve embrionale;

iii) tregtimin, shkëmbimin dhe transportimin e kafshëve dhe të produkteve embrionale;

iv) kafshët e shoqërimit;

v) kafshët e laboratorit;

f) regjistron produktet mjekësore veterinarë, dezinfektantët dhe dezinfestantët e certifikuar, që prodhohen ose tregtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë;

g) kontrollon biosigurinë, dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin dhe shkatërrimin e materialeve të infektuara;

gj) mban dhe përditëson regjistrin zyrtar për:

i) fermat dhe stabilimentet blegtorale;

ii) subjektet që tregtojnë kafshë;

iii) subjektet që prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë produkte embrionale;

iv) individët që transportojnë kafshë, produkte embrionale, nënprodukte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;

v) qendrat e grumbullimit të kafshëve ose pikat karantinore;

vi) subjektet që prodhojnë ose tregtojnë PMV;

vii) laboratorët veterinarë;

viii) vendet ku zbatohet praktika mjekësore veterinarë dhe mjekët veterinarë që punojnë atje;

ix) institucionet dhe personat që lejohen të kryejnë eksperimente me kafshë;

h) mbikëqyr procesin e identifikimi dhe të regjistrimit të kafshëve e fermave blegtorale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

### **Neni 130**

#### **Fusha e veprimtarisë së veterinerit zyrtar**

Veterineri zyrtar e ushtron veprimtarinë e tij në njësitë e mëposhtme:

- a) fermat e rritjes dhe mbarështimit të kafshëve;
- b) pikat e grumbullimit dhe pikat e pushimit të kafshëve;
- c) qendrat e karantinës shtetërore;
- ç) qendrat e riprodhimit dhe ndërzimit artificial;
- d) qendrat e grumbullim-përpunimit të produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor apo kafshë;
- dh) njësitë e shërbimit veterinar privat, sipas përcaktimit të këtij ligji.

### **Neni 131**

#### **Veterineri zyrtar**

Veterineri zyrtar, në territorin ku ushtron veprimtarinë, kryen funksionet e mëposhtme:

1. Lëshon certifikatën shëndetësore veterinare për lëvizjen e kafshëve.
2. Në kuadër të Planit Kombëtar të Monitorimit Mbetjeve dhe në bazë të sëmundjeve infektive të përcaktuara në listën përkatëse, merr kampione dhe materiale patologjike për analiza, me qëllim kontrollin e shëndetit të kafshëve, të cilat i dërgon në laboratorët veterinarë.
3. Në rastet e sëmundjeve infektive të përcaktuara në listën përkatëse, ndalon lëvizjen e kafshëve, të produkteve primare me origjinë shtazore, produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, produkteve mjekësore veterinare, produkteve embrionale, si dhe të mbeturinave shtazore.
4. Kontrollon dhe pezullon veprimtarinë e fermave për mbarështimin, prodhimin dhe tregtimin e kafshëve, produkteve embrionale, materialeve të papërpunuara me origjinë shtazore, në rastet e mospërputhjes me standardet sanitaro-veterinare, si dhe në rastet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
5. Konfiskon dhe urdhëron asgjësimin e produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, të papërshtatshme nga ana sanitaro-veterinare, si dhe produktet mjekësore veterinare.
6. Mbikëqyr veprimtarinë e organizmave veterinarë privatë, të cilave ua pezullon veprimtarinë kur vëren mosrespektimin e kushteve të përcaktuara për licencimin e tyre.
7. Mbikëqyr dhe kontrollon:
  - a) zbatimin e masave për parandalimin, zbulimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të kafshëve dhe për mbrojtjen e shëndetit publik nga zoonozat;
  - b) zbatimin e masave veterinare për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve;
  - c) zbatimin e veprimtarive veterinare nga shërbimet veterinare private;
  - ç) përputhjen me standardet sanitaro-veterinare në fermat blegtorale, në rritjen e kafshëve të destinuara për eksperimente, në inkubatorët, rezervatet, qendrat e grumbullimit, tregjet e kafshëve të gjalla, qendrat e blerjeve dhe pikat e pushimit të kafshëve, kopshtet zoologjike ose miniparqet;
  - d) përputhjen me standardet sanitaro-veterinare të stabilimenteve të prodhimit dhe të ruajtjes së spermës së kafshëve e vezëve të fekunduara;
  - dh) përputhjen me standardet sanitaro-veterinare të mjeteve të transportit, të përdorura për transportin e kafshëve dhe mënyrën e transportit të kafshëve;
  - e) mbetjet e substancave të dëmshme në kafshë;
  - ë) zbatimin e masave veterinare në mbajtjen, prodhimin dhe tregtimin e kafshëve;
  - f) identifikimin e kafshëve, regjistrimin e fermave blegtorale dhe veprimtarinë e personave fizikë ose juridikë, të autorizuar për identifikimin;
  - g) prodhimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e produkteve mjekësore veterinare;
  - gj) prodhimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e dezinfektantëve, dezinfektantëve, deratizuesve, si dhe përdorimin e mjeteve me anë të të cilave kryhen dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi;
  - h) dokumentacionin dhe regjistrat e fermave dhe të stabilimenteve blegtorale, klinikave dhe farmacive veterinare, stabilimenteve të prodhimit dhe ruajtjes së spermës së kafshëve e vezëve të fekunduara, në lidhje me zbatimin e legjislacionit veterinar;
  - i) dezinfektimin e mjeteve të transportit, të përdorura për dërgimin e ngarkesave të kafshëve dhe mbeturinave me origjinë shtazore;
  - j) zbatimin e masave karantinore për kafshët dhe produktet me origjinë shtazore, në rastet e shpërthimeve të sëmundjeve infektive;
  - k) zbatimin e masave të tjera të përcaktuara, kur kërcënohen shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve;
  - l) vendosjen e masave kur vërehen kundërvajtje administrative, në zbatim të nenit 134 të këtij ligji.

8. Në rastet e sëmundjeve zoonotike, informon strukturat përkatëse të shëndetit publik.

### **Neni 132**

#### **Detyrat e veterinerit zyrtar**

Gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, sipas dispozitave të këtij ligji, veterineri zyrtar duhet:

- a) të ndalojë, të kërkojë apo të bllokojë çfarëdo mjet transporti, i cili dyshohet për mbajtjen e kafshëve;
- b) të ndalojë përdorimin e mjediseve, mjeteve, pajisjeve dhe makinerive në fermën blegtorale;
- c) të urdhërojë zbatimin e kushteve të përcaktuara për strukturën, pajisjet teknike, aparaturat teknologjike, veprimtarinë, higjienën dhe mbrojtjen e mjedisit veterinar, në stabilimentet blegtorale dhe fermat blegtorale, të cilat nuk i plotësojnë ose i plotësojnë pjesërisht këto kushte;
- ç) të ndalojë përdorimin e pajisjeve të përmendura në shkronjën "c" të këtij neni, nëse mospërputhjet e konstatuara nuk korrigjohen brenda afatit të vendosur;
- d) të ndalojë tregtimin e produkteve mjekësore veterinarë nëse ato tregtohen në kundërshtim me kushtet e vendosura në legjislacionin përkatës;
- dh) të ndalojë veprimtarinë e njësive të shërbimit veterinar privat, për të cilat ende nuk është marrë një vendim për fillimin e veprimtarisë së tyre e të cilat kanë dështuar në plotësimin e kushteve të përcaktuara për mjediset, stafin profesional dhe pajisjet;
- e) të hyjë në fermat, stabilimentet blegtorale dhe godinat, në të cilat ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me nenin 131 të këtij ligji, si dhe të kontrollojë të gjitha shënimet dhe dokumentacionin;
- ë) të vendosë kafshët në karantinë;
- f) të kryejë veprimtari të tjera, të përcaktuara në legjislacionin veterinar.

### **Neni 133**

#### **Konflikti i interesit dhe konfidencialiteti**

1. Gjatë kryerjes së funksioneve të tij, veterineri zyrtar duhet të shmangë çdo situatë, në të cilën ai ka një interes personal të tillë që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së këtyre funksioneve.
2. Veterinari zyrtar nuk ka të drejtë të kryejë ose të marrë pjesë në veprimtari fitimprurëse ose jofitimprurëse, të cilat janë objekt kontrolli nga shërbimi veterinar.
3. Për shmangien e situatave të konfliktit të interesit, zbatohen parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", dhe në ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", për aq sa janë të zbatueshme.
4. Në një njësi të caktuar administrative/epidemiologjike, ku nuk sigurohen mbrojtja e shëndetit të kafshëve dhe zbatimi i praktikës mjekësore veterinarë nga shërbimi veterinar privat, këto veprimtari mund të kryhen nga Shërbimi Veterinar Shtetëror, sipas rregullores përkatëse.
5. Veterineri zyrtar, gjatë ushtrimit të kontrolleve në zbatim të detyrave të ngarkuara nga shërbimi veterinar, respekton ruajtjen e informacionit të marrë, që mbulohet nga sekreti profesional.
6. Shërbimi veterinar ruan në mënyrë konfidenciale të dhënat e përfituara gjatë kontrolleve zyrtare dhe mund t'i bëjë publike ato vetëm në rastin e një kërcënimi serioz për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik.



**Neni 134**  
**Kundërvajtjet administrative**

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji, për të cilat ndëshkohen, nga veterineri zyrtar shtetëror, personat si më poshtë:

1.1 Pronari ose kujdestari i kafshëve:

a) me gjobë nga 25 000 (njëzet e pesë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në rastet kur:

i) vepron në kundërshtim me nenet, 19, 20, 24, 51 e 53, të këtij ligji;

ii) vepron në kundërshtim me nenet 6, 8, 9, 12, të këtij ligji;

iii) vepron në kundërshtim me nenin 41 të këtij ligji për karantinën shtetërore;

b) me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë në rastet kur:

i) vepron në kundërshtim me nenet 72 dhe 76 të këtij ligji gjatë transportit të kafshëve;

ii) vepron në kundërshtim me nenin 59 të këtij ligji, duke lëvizur kafshët pa certifikatën veterinare;

iii) vepron në kundërshtim me nenin 32 të këtij ligji, për therjen e kafshëve pa kryer kontrollin veterinar;

iv) vepron në kundërshtim me nenet 51, 66 e 74 të këtij ligji;

v) grumbullon dhe tregton lëkurët, në kundërshtim me nenin 63 të këtij ligji;

vi) vepron në kundërshtim me nenin 72 të këtij ligji.

1.2. Mjeku veterinar privat:

a) me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë kur:

i) vepron në kundërshtim me nenet 19, 21, 29 e 32 të këtij ligji;

ii) vepron në kundërshtim me nenet 70 dhe 76 të këtij ligji;

iii) lëshon certifikatën veterinare në kundërshtim me nenet 55, 56, 57 dhe 59 të këtij ligji;

iv) vepron në kundërshtim me nenin 83 të këtij ligji;

v) vepron në kundërshtim me nenin 84 të këtij ligji;

vi) vepron në kundërshtim me nenet 109, 110, 111, 115, 116, 117 dhe 118 të këtij ligji.

1.3 Personi fizik dhe/ose juridik:

a) me gjobë 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë kur:

i) vepron në kundërshtim me nenin 63 të këtij ligji;

ii) vepron në kundërshtim me nenet 78, 79 e 80 të këtij ligji;

iii) vepron në kundërshtim me nenet 30, 31, 82 e 84 të këtij ligji;

iv) vepron në kundërshtim me nenet 33, 35, 36, 38 dhe 42 të këtij ligji;

v) vepron në kundërshtim me nenet 90, 93, 94, 96 e 99 të këtij ligji;

vi) vepron në kundërshtim me nenet 108, 110, 115, 116 e 118 të këtij ligji.

2. Të ardhurat nga vjelja e kundërvajtjeve administrative derdhen në Buxhetin e Shtetit.

3. Format standard për vendosjen e gjobës miratohet me urdhër të ministrit.

**Neni 135**  
**Ankimi administrativ**

Kundër masave të kundërvajtjes administrative mund të ushtrohet ankim pranë autoritetit kompetent, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

**Neni 136**

## **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 2, 11 pika 2, 49 dhe 54 pika 2 të tij.
2. Ngarkohet ministri që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 1, 9 pika 2, 12 pika 4, 21 pika 7, 24 pika 5, 33 pikat 4 dhe 6, 34 pika 1, 39 pika 5, 41 pika 2, 45 pika 3, 51 pika 2, 55 pika 1, 61 pika 3, 65 pika 3, 67 pika 4, 68 pika 5, 72 pikat 2 dhe 4, 81 pikat 2 dhe 3, 82 pikat 3, 4 dhe 5, 84 pika 3, 85 pika 1, 88 pika 1, 92 pika 3, 94 pika 6, 96 pika 3, 102 pika 6, 120 pika 6, 121 pikat 2 dhe 3, 123 pika 2, 124 pika 2 dhe 134 pika 3 të tij.
3. Ngarkohen ministri dhe Ministri i Financave që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 7 pika 3, 37 pika 2, 44 pika 2, 120 pika 3 dhe 125 pika 3 të tij.
4. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për mjedisin që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 78 pika 3 të tij.

### **Neni 137**

#### **Licencimi i veprimtarive**

Veprimtaritë e kryera për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake, që parashikohen në këtë ligj, licencohen sipas kategorive e nënkategorive respektive të Fushës II të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

## **KREU XI**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 138**

##### **Shfuqizimet**

1. Ligji nr. 9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, shfuqizohet.
2. Deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, për aq sa përputhen me ligjin në fuqi.

#### **Neni 139**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R E**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**LIGJ**  
**Nr. 71/2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10 465, DATË 29.9.2011, “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

**Neni 1**

1. Kudo në ligj, emërtimet “ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” dhe “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “ministri”, “institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë” dhe “instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë”.
2. Në nenet 4, pikat 65, 71 dhe 84; 8, shkronja “c”; 14, pika 2; 22, pikat 4 e 5; 24, pika 2; 27, pika 1; 33, pika 6; 38, pikat 6 e 7; 56, pika 2; 81, pikat 1 e 2; 87, pika 2; 120, pika 6, dhe 123, pika 2, fjalët “autoriteti kompetent ” dhe “autoriteti kompetent veterinar” zëvendësohen me shprehjen “struktura përgjegjëse për veterinarinë” dhe fjalët “populacion” dhe “nënpopulacion” zëvendësohen me fjalët “popullatë” dhe “nënpopullatë”.
3. Në nenet 17, pika 1; 22, pika 6, dhe 25, pika 2, pas fjalëve “autoriteti kompetent” shtohet togfjalëshi “informon strukturën përgjegjëse për veterinarinë, e cila”.

**Neni 2**

Në nenin 1 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 4, pas fjalës “shtazore” shtohet togfjalëshi “jo për konsum njerëzor”.
2. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:  
“12. Të përcaktojë rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të transmetueshme të kafshët ose njerëzit, duke bërë të mundur:  
a) klasifikimin, sipas prioritetit, kategorizimin e sëmundjeve dhe përcaktimin e përgjegjësive për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve;

- b) miratimin dhe regjistrimin e objekteve e të mjeteve transportuese, garantimin e lëvizjes e të gjurmueshmërisë së ngarkesave të kafshëve, produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;
- c) hyrje-daljen e kafshëve, të produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor në Shqipëri;
- ç) vendosjen e masave urgjente, që duhen marrë në rast të shpërthimit të një sëmundjeje.”.

### **Neni 3**

Në nenin 2, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Mbrojtjen nga përhapja e sëmundjeve të trasmetueshme të kafshëve me pronar ose jo dhe kafshëve të egra, produkteve embrionale, produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, subjekteve, mjeteve të transportit, pajisjeve dhe çdo materiali që ndikon ose është i prirur të ndikojë në përhapjen e sëmundjeve të trasmetueshme të kafshëve.”.

### **Neni 4**

Në nenin 3, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) të fermerëve, pronarëve dhe të operatorëve të biznesit të mbarështimit të kafshëve.”.

### **Neni 5**

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Autoriteti kompetent është struktura e shërbimit veterinar shtetëror, përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së shërbimit veterinar në kryerjen e kontrollit zyrtar dhe aktiviteteve të tjera veterinare në varësi të ministrit.”

2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1 Struktura përgjegjëse për veterinarinë ose SPV-në është struktura përgjegjëse që mbulon shërbimin veterinar në ministri.”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

“8/1. “Biosiguri” është tërësia e masave menaxhuese dhe fizike, të cilat kanë qëllim të reduktojnë rrezikun e hyrjes, të zhvillimit ose përhapjes së sëmundjeve të kafshët në fermë dhe/ose objekt, zonat ose çdo ambient tjetër dhe mjetet e transportit.”.

4. Pas pikës 20 shtohet pika 20/1 me këtë përmbajtje:

“20/1. “Hetim epidemiologjik” është zbulimi i origjinës së mundshme të një sëmundjeje të shfaqur në kafshë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve dhe të zhvillimit të mëtejshëm të sëmundjes në popullatën e kafshës së kontaminuar, duke realizuar kontrollin e pranisë dhe mënyrën e shpërndarjes së vektorëve të sëmundjes infektive, për vendosjen e strategjive të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjes.”.

5. Pas pikës 35 shtohet pika 35/1 me këtë përmbajtje:

“35/1. “Kadavër” është trupi i vdekur i kafshës i destinuar për t’u eliminuar.”.

6. Pika 95 ndryshohet si më poshtë:

“95. “Regjistrim” është veprimi me anë të të cilit informacioni për kafshët (si: identifikimi, shëndeti i kafshëve, lëvizja, certifikimi, epidemiologjia, stabilimentet), mblihet, shënohet dhe ruhet në mënyrë të sigurt për përdorim nga autoriteti kompetent dhe SPV-ja.”.

7. Pika 101 ndryshohet si më poshtë:

“101. “Sëmundje e lajmërueshme” është një sëmundje e listuar nga SPV-ja dhe e miratuar nga ministri, për të cilën, sapo të zbulohet ose të dyshohet, autoriteti kompetent njofton SPV-në.”.

8. Pas pikës 105 shtohet pika 105/1 me këtë përmbajtje:

“105/1. “Sistemi i informacionit të epidemiologjisë veterinarë” është sistemi elektronik i njoftimit të menjëhershëm të strukturave përgjegjëse në vend dhe organizmave përkatës e ndërkombëtarë për ngjarjet epidemiologjike, survejancën, monitorimin dhe kontrollin e tyre.”.

9. Pas pikës 106 shtohen pikat 106/1 dhe 106/2 me këtë përmbajtje:

“106/1. “Stabiliment” është një objekt, ndërtesë ose strukturë, në të cilën kryhet të paktën një nga aktivitetet e përmendura në këtë ligj.

106/2. Survejancë është mbledhja e vazhdueshme, sistematike, shqyrtimi, analizimi i informacionit për shëndetin e kafshëve dhe shpërndarja në kohë e informacionit, me qëllim që të merren masat përkatëse.”.

10. Pika 112 ndryshohet si më poshtë:

“112. “Teknik veterinar” është veterineri me arsim të mesëm, profesional, veterinar, i cili ngarkohet nga shërbimi veterinar shtetëror që të kryejë disa detyra të përcaktuara në një territor, nën përgjegjësinë dhe drejtimin e një mjeku veterinar.”.

11. Pas pikës 112 shtohen pikat 112/1 dhe 112/2 me këtë përmbajtje:

“112/1. “Veterineri zyrtar i kontrollit” është veterineri zyrtar, i cili kryen veprimtarinë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 131 të këtij ligji.

112/2. “Veterineri zyrtar i shërbimit” është veterineri zyrtar, i cili kryen veprimtarinë e përcaktuar në pikën 2 të nenit 131 të këtij ligji.”.

## **Neni 6**

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjedhi, delet, dhitë, njëthundrakët dhe derrat i nënshtrohen identifikimit të detyrueshëm individual, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ministri.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për të parandaluar, zbuluar e kontrolluar sëmundje infektive dhe për të kontrolluar tregtinë e kafshëve, ministri urdhëron identifikimin e detyrueshëm të llojeve të tjera të kafshëve.”.

## **Neni 7**

Në nenin 7, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kostot dhe mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të sistemit IR.

3. Tarifat për funksionimin e sistemit IR përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për fushën e veterinarisë dhe ministrit përgjegjës për fushën e financave.”.

### **Neni 8**

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 9**

**Funksionet e veterinerit zyrtar në identifikimin e kafshëve të prodhimit**

1. Veterineri zyrtar urdhëron masat e mëposhtme kur konstaton mospërputhje në identifikimin e kafshëve:

a) ndalimin e lëvizjes së të gjitha kafshëve nga ferma ose futjen e kafshëve në fermë;

b) futjen e kafshëve të paidentifikuara në kushte karantinore në karantinën shtetërore ose në vendin e destinacionit, jo më pak se 21 (njëzet e një) ditë, për matrikulimin dhe kryerjen e ekzaminimeve të nevojshme veterinare. Kafshët e rezultuara pozitive pas ekzaminimeve eliminohen menjëherë. Të gjitha shpenzimet për ekzaminimet, ditët e qëndrimit në karantinë dhe eliminimin përballohen nga pronari i kafshëve.

2. Kafshët pa origjinë, pa pronar dhe kujdestar apo të braktisura nga pronari dhe kujdestari eliminohen dhe karkasat e tyre asgjësohen menjëherë, në mënyrë të sigurt, sipas legjislacionit në fuqi. Shpenzimet për eliminimin dhe asgjësimin përballohen nga buxheti i shtetit.

3. Ministri miraton rregullat për marrjen e masave, që zbatohen nga veterineri zyrtar në rastet e përmendura në pikën 1 të këtij neni.”.

### **Neni 9**

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kafshët dhe feramat blektorale identifikohen dhe regjistrohen sipas sistemit kombëtar IR.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

### **Neni 10**

Në të gjithë përmbajtjen e nenit 12, fjala “ qentë ” zëvendësohet me fjalët “ kafshët e shoqërimit.”.

### **Neni 11**

Në nenin 14, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Shërbimi veterinar shtetëror kryen monitorimin e sëmundjeve që janë të listuara në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në mënyrë që të zbulojë në kohë praninë e tyre. Lista e sëmundjeve përditësohet me sëmundje të reja që shfaqen, duke mbledhur, ruajtur dhe analizuar informacionin e vlefshëm për situatën epidemiologjike.”.

## **Neni 12**

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pas shkronjës “p” shtohet shkronja “q” me këtë përmbajtje:

“q) masa shtesë të kontrollit të sëmundjeve, nga ato të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, mund të merren nga shërbimi veterinar nëse shihen të nevojshme e të përshtatshme për të kontrolluar përhapjen e sëmundjes, duke marrë parasysh:

- i. rrethanat e veçanta epidemiologjike;
- ii. llojin e fermave e të stabilimenteve, vendndodhjet e tjera dhe prodhimin në fjalë;
- iii. llojet dhe kategoritë e kafshëve të përfshira;
- iv. kushtet ekonomike ose sociale.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Masat shtesë të kontrollit të sëmundjeve miratohen me urdhër të ministrit.”.

## **Neni 13**

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Programet vjetore të monitorimit

1. Masat e kontrollit të sëmundjeve të kafshëve dhe kushtet e shëndetit të tyre, embrioneve, materialit biologjik, produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, që rregullojnë lëvizjen, tregtinë në vend dhe importin e tyre, miratohen me urdhra të ministrit.

2. SPV-ja përgatit programet vjetore të profilaksisë veterinare shtetërore, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve me pasoja për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik veterinar, mbështetur në situatën epidemiologjike në vend. Programet miratohen me urdhër të ministrit.”.

## **Neni 14**

Në nenin 20, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Veterineri zyrtar merr kampionet, i dërgon në laboratorin veterinar të përcaktuar për sëmundjen që dyshohet dhe njofton në sistemin e informacionit të epidemiologjisë veterinare.”.

## Neni 15

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Masat paraprake profilaktike

1. Shërbimi veterinar, në rast se dyshon për praninë e një sëmundjeje të listuar në përputhje me pikën 1 të nenit 14 të këtij ligji, në pritje të rezultateve merr masat për kontrollin e sëmundjes:
  - a) duke vendosur nën mbikëqyrjen zyrtare fermat/stabilimentet ose çdo vendndodhje tjetër, ku sëmundja dyshohet se është shfaqur apo ka origjinën;
  - b) duke mbajtur një regjistër të të gjitha kafshëve që ndodhen në fermë/stabiliment ose në çdo vendndodhje tjetër, që ka rëndësi për përhapjen e mundshme të sëmundjes;
  - c) duke siguruar që janë marrë masat e nevojshme të biosigurisë, me qëllim ndalimin e përhapjes së sëmundjes te kafshët e tjera ose te njerëzit;
  - ç) duke vendosur në izolim kafshët e dyshuara si të prekura, me qëllim ndalimin e përhapjes së sëmundjes;
  - d) duke kufizuar lëvizjet e kafshëve, të produkteve, të personave, të mjeteve të transportit, si dhe të çdo materiali ose pajisjeje tjetër me anë të së cilës sëmundja mund të përhapet, me qëllim ndalimin e përhapjes së saj;
  - dh) duke ndërmarrë çdo masë tjetër të nevojshme për kontrollin e sëmundjes;
  - e) duke njoftuar në sistemin e informacionit të epidemiologjisë veterinare dhe filluar hetimin epidemiologjik.
2. Shërbimi veterinar shtetëror, në vijim të rezultateve të hetimit epidemiologjik, rishqyrton masat paraprake profilaktike sipas pikës 1 të këtij neni.”.

## Neni 16

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur konfirmohet dyshimi i pranisë së sëmundjes infektive nga laboratorit veterinar, autoriteti kompetent njofton SPV-në.”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Ministri, me urdhër, miraton rregulloret përkatëse për masat që duhet të zbatohen në fermën e vendosur nën mbikëqyrje zyrtare, sipas pikës 2 të këtij neni, për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, sipas situatës.”.

## Neni 17

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 39  
Procedurat në rast dyshimi

1. Inspektori veterinar në PIK, në rast se gjatë importit, eksportit apo transitit të ngarkesave të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, dyshon për sëmundje infektive, ndotje, ndryshime organoleptike të mallit apo konstaton mangësi në dokumentacionin e parashikuar në pikat 1 e 2 të nenit 38 të këtij ligji, urdhëron:

- a) bllokimin e ngarkesës në PIK;
- b) rikontrollin veterinar, me analiza laboratorike të specifikuara;
- c) shoqërimin e ngarkesës për në pikën më të afërt të karantinës ose në vendin e destinacionit, ku do t’u nënshtrohet masave karantimore të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore;
- ç) kthimin mbrapsht të ngarkesës, sipas nenit 40 të këtij ligji;
- d) konfiskimin, eliminimin dhe asgjësimin në mënyrë të sigurt, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Për masat e marra sipas pikës 1 të këtij neni, ai mban procesverbalin e inspektimit dhe njofton menjëherë autoritetin kompetent për PIK-un, i cili njofton strukturën përgjegjëse për veterinarinë në ministri dhe autoritetin kompetent. Shërbimi veterinar rajonal i destinacionit të ngarkesës shoqëron ngarkesën sipas shkronjës “c” të pikës 1.

3. Të gjitha shpenzimet për masat e marra sipas pikës 1 të këtij neni, mbulohen nga pronari ose personi përgjegjës për ngarkesën.”.

**Neni 18**

Në nenin 41, në pikën 2, fjalët “propozimin e autoritetit kompetent” zëvendësohen me fjalën “udhëzim”.

**Neni 19**

Në nenin 42, pika 1, togfjalëshi “nga autoritetet kompetente veterinare të të dyja vendeve” zëvendësohet me togfjalëshin “nga struktura përgjegjëse për veterinarinë në ministri dhe autoriteti kompetent në vendin e origjinës ”.

**Neni 20**

Në nenin 43 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikat 1 dhe 2, togfjalëshi “urdhrin e përkohshëm, të lëshuar nga autoriteti kompetent” zëvendësohen me togfjalëshin “ urdhrin e Ministrit”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në përputhje me “Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit” të OIE-së, ministri

miraton urdhrin për shfuqizimin e masave veterinarë për sëmundjet infektive, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni.”.

### **Neni 21**

Në nenin 45 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “autoriteti kompetent” zëvendësohet me togfjalëshin “shërbimin veterinar”.
2. Në pikën 3, togfjalëshi “me propozimin e autoritetit kompetent” hiqet.

### **Neni 22**

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 48**

#### **Masat e shërbimit veterinar shtetëror**

Autoriteti kompetent, mbështetur në listën e sëmundjeve infektive, merr njërën prej masave të mëposhtme:

- a) eliminimin e kafshëve të sëmura, të dyshuara si të sëmura ose të ekspozuara kundrejt infeksionit;
- b) asgjësimin në mënyrë të sigurt të kadavrave, produkteve të kafshëve, produkteve embrionale, lëndëve të papërpunuara dhe të pajisjeve e mjeteve në një vatër të sëmundjes, që paraqet rrezik për shëndetin e kafshëve.”.

### **Neni 23**

Në nenin 51 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:

“f) të zbatojnë kërkesat për mbrojtjen e shëndetit e të mirëqenies së kafshëve dhe të zbatojnë masat e biosigurisë.”.

b) pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) Të marrë masat e përshtatshme të biosigurisë sipas: i. llojeve dhe kategorive të kafshëve; ii. llojit të mbarështimit; iii. rreziqeve të mundshme, duke përfshirë vendndodhjen gjeografike, kushtet klimaterike dhe rrethanat e praktikave të zonës në fjalë.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “1/1. Ministri, me urdhër, miraton rregullat për masat e biosigurisë, që zbatohen në fermë.”.

3. Në pikën 2, togfjalëshi “me propozimin e autoritetit kompetent” hiqet.

### **Neni 24**

Neni 54 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 54**  
**Njësiti e vetëqeverisjes vendore**

1. Njësiti e vetëqeverisjes vendore duhet:

- a) të bashkëpunojnë me autoritetin kompetent dhe strukturat e shërbimit veterinar për zbatimin e masave profilaktike, për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë;
- b) të bashkëpunojnë me autoritetin kompetent dhe strukturat e shërbimit veterinar shtetëror për zbatimin e legjislacionit veterinar në funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoreve dhe kullotave;
- c) të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë kërkesat e këtij ligji për kontrollin e qenve e të maceve të rrugës, duke bashkëpunuar me shërbimin veterinar shtetëror; ç) të përcaktojnë vendet e asgjësimit ose të grumbullimit të kadavrave të kafshëve dhe të bashkëpunojnë për eliminimin e tyre;
- d) të marrin masa për rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve e të vendgroposjes të kadavrave dhe të ndalojnë hyrjen e kafshëve atje.

2. Mënyrat e bashkëpunimit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 25**

1. Në nenin 61, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Subjektet, që merren me organizimin e ekspozitave, të kopshteve zoologjike shëtitëse, transportin e kafshëve që udhëtojnë me trupat e cirkut, me organizimin e panairëve e të shitjeve të organizuara të kafshëve jashtë mjediseve të stallave e stabilimenteve, njoftojnë, paraprakisht, me shkrim shërbimin veterinar shtetëror për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë.

2. Autoriteti kompetent miraton ose refuzon kërkesën për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë nen.”. 2. Në pikën 3, pas fjalës “miraton” shtohet fjala “me urdhër”.

**Neni 26**

Në nenin 62, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Veterineri zyrtar urdhëron eliminimin e detyrueshëm në vend për kafshët me dëmtime të rënda e të pashërueshme dhe njofton shërbimin rajonal veterinar, i cili njofton autoritetin kompetent, SPV-në dhe njësiti e vetëqeverisjes vendore.”.

**Neni 27**

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 63**  
**Grumbullimi dhe tregtia e lëkurëve**

Personi fizik apo juridik, që grumbullon, përpunon apo tregton lëkurë kafshësh, vërteton dhe dokumenton origjinën e lëkurëve të blera nëpërmjet certifikatës veterinare të origjinës. Të dhënat mbahen në regjistrin sipas modelit të miratuar me urdhër nga ministri.”.

**Neni 28**

Pas nenit 64 shtohet neni 64/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 64/1**  
**Transporti i kafshëve të egra tokësore**

1. Transporti i kafshëve të egra tokësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose në një shtet tjetër, bëhet vetëm kur:

a) ato nuk vijnë nga një vendbanim i një zone që është subjekt i kufizimeve të lëvizjes, për shkak të një sëmundjeje të shfaqur, që prek këtë specie të kafshëve;

b) kafshët e egra shoqërohen me certifikatë shëndetësore në rast se certifikimi i shëndetit të kafshëve është i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e shëndetit të kafshëve për lëvizjet e parashikuara, ose dokumente të tjera veterinare, të miratuara me urdhër nga ministri;

c) autoriteti kompetent, së bashku me autoritetin kompetent të destinacionit, në rastin e një shteti tjetër, kanë rënë dakord për një lëvizje të tillë.

2. Çdo lëvizje e kafshëve të egra drejt Shqipërisë nga një shtet tjetër duhet të përmbushë të gjitha kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Rregullat e hollësishme për lëvizjen e kafshëve të egra brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë miratohen me urdhër të ministrit.”.

**Neni 29**

Në nenin 81, në pikën 4, togfjalëshi “shërbimi veterinar rajonal” zëvendësohen me togfjalëshin “autoriteti kompetent”.

**Neni 30**

Në nenin 85 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Komisioni Shtetëror i PMV-ve pranon për regjistrim PMV-të që kanë certifikatë tregtimi dhe

tregtohen në një nga vendet e BE-së dhe PMV-të e pajisura me certifikatë tregtimi, të lëshuar nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA).”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kryetari i Komisionit Shtetëror të PMV-ve nënshkruan certifikatën e tregtimit për secilin produkt të miratuar, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, brenda 10 ditëve pune pas pagesës nga kërkuesi të tarifës së përcaktuar për regjistrim.”.

### **Neni 31**

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 86  
Përdorimi në kafshë i PMV-ve

Asnjë produkt mjekësor veterinar nuk lejohet të tregtohet pa certifikatë tregtimi, me përjashtim të rasteve kur përdoret për qëllime të provave klinike të PMV-ve.”.

### **Neni 32**

Në nenin 87, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shqyrtimi i dosjes së PMV-ve, miratimi nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 85, dhe lëshimi i certifikatës së tregtimit kryhen brenda një afati prej 100 ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës dhe të dosjes së plotë nga kërkuesi.”.

### **Neni 33**

Neni 88 ndryshohet si më poshtë:

“ Neni 88  
Komisioni Shtetëror i PMV-ve

1. Ministri, me propozimin e SPV-së, urdhëron ngritjen e Komisionit Shtetëror të PMVve.
2. Komisioni Shtetëror i PMV-ve ka në përbërje:
  - a) dy përfaqësues nga SPV-ja;
  - b) dy përfaqësues nga instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë;
  - c) një përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës.”.

### **Neni 34**

Neni 102 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 102  
Sistemi i farmakovigjilencës

1. SPV-ja merr masa për ngritjen dhe administrimin e një sistemi të farmakovigjilencës.
2. SPV-ja merr masa për të siguruar njoftimin e reaksioneve të kundërta në kafshë, të dyshuara se ndodhin nga përdorimi i PMV-ve.
3. Autoriteti kompetent siguron shkëmbimin e informacionit nga sistemi i farmakovigjilencës, që lidhet me PMV-të, të cilat janë lejuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë.
4. Gjatë vlerësimit të të dhënave nga farmakovigjilencia, kur struktura përgjegjëse për veterinarinë në ministri konsideron se një certifikatë tregtimi e PMV-ve duhet tërhequr, përfunduar ose ndryshuar, njofton menjëherë mbajtësin e certifikatës së tregtimit të PMV-ve dhe Komisionin Shtetëror për PMV-të, i cili mund të vendosë me vendim të ndërmjetëm pezullimin e certifikatës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar. Agjencia Europiane e Medikamenteve njoftohet për vendimin e ndërmjetëm, për pezullimin e certifikatës ose vendimin përfundimtar për heqjen e licencës.
5. Në rast të një nevoje të menjëhershme për ruajtjen e shëndetit të njeriut ose të kafshëve, Komisioni Shtetëror për PMV-të, me propozimin e strukturës përgjegjëse për veterinarinë në ministri ose të autoritetit kompetent, mund të shfuqizojë certifikatën e tregtimit të PMV-ve. Në këtë rast, struktura përgjegjëse për veterinarinë njofton autoritetet e shëndetit publik, Agjencinë Europiane të Medikamenteve dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, me të cilët Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dypalëshe, si dhe palët e interesuara, jo më vonë se 1 ditë pune pas vendimit të shfuqizimit.
6. Kushtet dhe procedurat për mbledhjen, përmbajtjen dhe dërgimin e informacionit të farmakovigjilencës miratohen nga ministri.
7. Autoriteti kompetent për përdorimin e PMV-ve për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve bazohet në:
  - a) karakteristikat dhe profilin e sëmundjes;
  - b) përhapjen e sëmundjes në Shqipëri dhe në vendet fqinje nga ka ardhur sëmundja;
  - c) disponueshmërinë, efikasitetin dhe rreziqet që paraqesin këto PMV në mirëqenien e kafshëve;
  - ç) disponueshmërinë e testeve diagnostikuese për të zbuluar infeksionet të kafshët;
  - d) pasojat ekonomike, sociale dhe ndikimin mjedisor që sjell përdorimi i këtyre PMV-ve në krahasim me strategjitë e tjera për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve.
8. Rregullat për përdorimin e PMV-ve, sipas këtij neni, miratohen me urdhër të ministrit.
9. Autoriteti kompetent merr masat e duhura për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik në lidhje me përdorimin e PMV-ve për studime shkencore ose për qëllime të zhvillimit e testimit të tyre në kushte të kontrolluara.”.

### **Neni 35**

Në nenin 105, në titull, fjala “Zbatimi” zëvendësohet me fjalën “Ushtrimi”.

### **Neni 36**

Në nenin 106, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaritë veterinare kryhen nga:

- a) veterinerët zyrtarë të kontrollit, veterinerët zyrtarë të shërbimit dhe teknikët veterinarë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- b) mjekët veterinarë, teknikët veterinarë, teknikët e ndërzimit, personat fizikë ose juridikë në njësitë e shërbimit veterinar privat në:
  - i. klinikat dhe spitalet veterinare;
  - ii. qendrat për riprodhimin dhe ndërzimin artificial;
  - iii. njësitë e tregimit me shumicë të PMV-ve dhe farmacitë veterinare;
  - iv. laboratorët veterinarë;
  - v. fermat blegtorale, parqet dhe kopshtet zoologjike e të tjera.”.

### **Neni 37**

Në nenin 108, togfjalëshi “praktikës mjekësore veterinare” zëvendësohet me togfjalëshin “profesionit të mjekut veteriner”.

### **Neni 38**

Në nenin 109 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Mjekët veterinarë mund të ushtrojnë profesionin në shërbimin veterinar shtetëror ose sektorin veterinar privat në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë.”.

2. Në pikën 2, fjalët “autoriteti kompetent” zëvendësohen me fjalët “ministri, me urdhër”.

### **Neni 39**

Në nenin 112, në pikën 2, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “të miratuar me urdhër të ministrit”.

### **Neni 40**

Në nenin 113, pika 4 riformulohet:

“4. Në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar të Republikës së Shqipërisë anëtarësohen mjekët veterinarë, farmacistët veterinarë dhe regjistrohen teknikët veterinarë dhe teknikët e ndërzimit, të cilët ushtrojnë profesionin veterinar, në institucione shtetërore ose si subjekte private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke zbatuar të gjitha kërkesat e ligjeve në fuqi, Statutin dhe Kodin e Etikës Profesionale”.

#### **Neni 41**

Në nenin 114, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ministri miraton rregulloren për funksionimin e klinikës dhe të spitalit veterinar.”.

#### **Neni 42**

Neni 116 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 116

Shërbimi veterinar në raste emergjente dhe nevojash

Në raste emergjente dhe nevojash, kur situata nuk përballohet nga shërbimi veterinar shtetëror, ministri urdhëron kontraktimin nga autoriteti kompetent të veterinerëve privatë, teknikëve veterinarë, klinikave veterinare dhe njësisve të tjera të shërbimit veterinar privat, të përcaktuara në këtë ligj, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.”.

#### **Neni 43**

Neni 117 shfuqizohet.

#### **Neni 44**

Në nenin 122 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3, togfjalëshi “autoritetit kompetent” zëvendësohet me fjalën “ministrit”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Laboratorët, objektet dhe personat e tjerë fizikë ose juridikë, të cilët përdorin agjentë patogjenë me qëllim kërkimin shkencor, edukimin, diagnostikimin ose prodhimin e vaksinave apo të produkteve të tjera biologjike, përveçse të bazohen në standardet ndërkombëtare përkatëse, duhet:

a) të marrin masat për biosigurinë dhe izolimin biologjik, me qëllim ndalimin e përhapjes së agjentëve patogjenë dhe kontaktin e tyre me kafshët jashtë laboratorëve ose objekteve të tjera, ku këta agjentë përdoren;

b) të kujdesen që lëvizja e këtyre agjentëve patogjenë, vaksinave dhe produkteve të tjera biologjike nga laboratorët dhe objektet e tjera të mos shkaktojë rreziqe përhapjeje të sëmundjeve.”.



## **Neni 45**

Në nenin 123, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, që është Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare, kryen vlerësime shkencore në fushën e veterinarisë dhe është pjesë e rrjetit të shërbimit veterinar shtetëror. Organizimi dhe funksionimi i institutit përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.”.

## **Neni 46**

Në nenin 127, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shërbimi veterinar shtetëror organizohet dhe funksionon si sistem me varësi vertikale dhe ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të këtij ligji.”.

## **Neni 47**

Neni 128 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 128

Përbërja e shërbimit veterinar

1. Shërbimi veterinar përbëhet nga:

- a) struktura përgjegjëse për veterinarinë, në ministri;
- b) autoriteti kompetent, shërbimi veterinar rajonal;
- c) shërbimi veterinar privat.

“2. Organizimi dhe funksionimi i autoritetit kompetent dhe shërbimit veterinar rajonal përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Drejtuesi i autoritetit kompetent emërohet dhe lirohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.”.

## **Neni 48**

Neni 129 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 129

Kompetencat e strukturës përgjegjëse për veterinarinë në ministri

SPV-ja ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) harton politikat e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve të gjalla;

- b) harton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive veterinarë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- c) harton legjislacionin veterinar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke e përafuar e harmonizuar atë me legjislacionin e Bashkimit Europian;
- ç) harton programet e parandalimit, të kontrollit dhe eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- d) harton modulet dhe përmbajtjen teknike të sistemit të identifikim-regjistrimit të fermave dhe kafshëve.
- dh) monitoron dhe harton raporte për vlerësimin e riskut dhe të situatës epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat që kryejnë veprimtari veterinarë;
- e) informon institucionet shtetërore, strukturat e shëndetit publik, palët e interesuara në vend, OIE-në, BE-në dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) programon dhe planifikon buxhetin në fushën e mbrojtjes së shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, mbështetur në programet e kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për planifikimin e buxheteve;
- f) harton politika dhe strategji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve e fermave blegtorale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi;
- g) monitoron veprimtarinë e autoritetit kompetent për zbatimin e legjislacionit për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtarive të tjera veterinarë.”.

## **Neni 49**

Pas nenit 129 shtohet neni 129/1 me këtë përmbajtje:

### “Neni 129/1

#### Kompetencat e autoritetit kompetent

Autoriteti kompetent ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) drejton veprimtarinë e shërbimit veterinar në lidhje me kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtari të tjera veterinarë;
- b) administron mjetet financiare për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve;
- c) mbron shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve:
  - i. në mbarështimin e tyre;
  - ii. në prodhimin dhe ruajtjen e produkteve embrionale;
  - iii. në tregtimin, shkëmbimin dhe transportimin e kafshëve dhe të produkteve embrionale; iv. të shoqërimit; v. të laboratorit.
- ç) kontrollon biosigurinë, dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin dhe shkatërrimin e materialeve të infektuara;

- d) mban dhe përditëson regjistrat zyrtarë për:
- i. fermat dhe stabilimentet blegtorale;
  - ii. subjektet që tregtojnë kafshë;
  - iii. subjektet që prodhojnë, ruajnë dhe tregtojnë produkte embrionale;
  - iv. individët që transportojnë kafshë, produkte embrionale, nënprodukte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;
  - v. qendrat e grumbullimit të kafshëve ose pikat karantinore;
  - vi. subjektet që prodhojnë ose tregtojnë PMV;
  - vii. vendet ku zbatohet praktika mjekësore veterinare dhe mjekët veterinarë që punojnë atje;
  - viii. institucionet dhe personat që lejojnë kryejnë eksperimente me kafshë;
- dh) zbaton procesin e identifikimit e të regjistrimit të kafshëve e fermave blegtorale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi;
- e) raporton në mënyrë periodike dhe sa herë i kërkohet SPV-në për kryerjen e kontrollit zyrtar dhe të aktivitetit veterinar të kryer nga shërbimi veterinar shtetëror në zbatim të këtij ligji.”.

## **Neni 50**

Neni 130 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 130

#### Fusha e veprimtarisë së shërbimit veterinar shtetëror

1. Shërbimi veterinar shtetëror përbëhet nga veterinerët zyrtarë dhe e ushtron veprimtarinë në:
- a) fermat e rritjes dhe të mbarështimit të kafshëve;
  - b) pikat e grumbullimit dhe të pushimit të kafshëve;
  - c) qendrat e karantinës shtetërore;
  - ç) qendrat e riprodhimit dhe të ndërzimit artificial;
  - d) qendrat e grumbullim-përpunimit të produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor apo shtazor;
  - dh) njësitë e shërbimit veterinar privat, sipas përcaktimit të këtij ligji;
  - e) thertore;
  - ë) njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit e zbukurimit;
  - f) njësitë e tregtisë së kafshëve, të produkteve embrionale, produkteve mjekësore veterinare, nënprodukteve dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor.
2. Shërbimi veterinar shtetëror mbështet institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë gjatë kryerjes së procesit të gjurmimit, përgjatë të gjithë zinxhirit ushqimor të produkteve ushqimore me origjinë shtazore, të rasteve jokonforme ose të dyshimta, të evidentuara gjatë kryerjes së aktivitetit të tij të përcaktuar me ligj.”.

## **Neni 51**

Neni 131 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 131  
Veterineri zyrtar

Veterineri zyrtar kryen veprimtari kontrolli dhe shërbimi në territorin ku ushtron veprimtarinë.

1. Veprimtaritë e kontrollit përfshijnë:

- a) lëshimin e certifikatës shëndetësore veterinarë, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 55 të këtij ligji;
- b) marrjen e kampioneve dhe të materialeve patologjike për analiza, me qëllim kontrollin e shëndetit të kafshëve, në kuadër të planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve dhe në bazë të sëmundjeve infektive të përcaktuara në listën përkatëse, të cilat dërgon në laboratorët veterinarë;
- c) ndalimin e lëvizjes së kafshëve, të produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, të produkteve mjekësore veterinarë, të produkteve embrionale dhe të mbeturinave shtazore në rastet e sëmundjeve infektive, të përcaktuara në listën përkatëse;
- ç) kontrollin dhe pezullimin e veprimtarisë së fermave për mbarështimin, prodhimin dhe tregtimin e kafshëve, të produkteve embrionale, materialeve të papërpunuara me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, në rastet e mospërputhjes me standardet sanitaro-veterinarë dhe në rastet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;
- d) konfiskimin dhe urdhërimin për asgjësimin e produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, të papërshtatshme nga ana sanitaro-veterinarë, si dhe të produkteve mjekësore veterinarë;
- dh) mbikëqyrjen e veprimtarisë së shërbimeve veterinarë private, të cilave u pezullon veprimtarinë kur vëren mosrespektimin e kushteve të përcaktuara për licencimin e tyre;
- e) zbatimin e masave për parandalimin, zbulimin, kontrollin e çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të kafshëve dhe për mbrojtjen e shëndetit publik nga zoonozat;
- ë) zbatimin e masave veterinarë për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve;
- f) përputhjen me standardet sanitaro-veterinarë në fermat blegtorale, në rritjen e kafshëve të destinuara për eksperimente, në inkubatorët, rezervatet, qendrat e grumbullimit, tregjet e kafshëve të gjalla, qendrat e blerjeve dhe pikat e pushimit të kafshëve;
- g) përputhjen me standardet sanitaro-veterinarë të stabilimenteve të prodhimit e të ruajtjes së spermës së kafshëve e të vezëve të fekunduara;
- gj) përputhjen me standardet sanitaro-veterinarë të mjeteve të transportit, të përdorura për transportin e kafshëve dhe të mënyrës së transportit të kafshëve;
- h) mbetjet e substancave të dëmshme në kafshë;
- i) zbatimin e masave veterinarë në mbajtjen, prodhimin dhe tregtimin e kafshëve;
- j) identifikimin e kafshëve, regjistrimin e fermave blegtorale dhe veprimtarinë e personave fizikë ose juridikë, të autorizuar për identifikimin;
- k) prodhimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e produkteve mjekësore veterinarë;
- l) prodhimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e dezinfektantëve, dezinfektantëve, deratizuesve

- dhe përdorimin e mjeteve me anë të të cilave kryhen dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi;
- ll) dokumentacionin dhe regjistrat e fermave e të stabilimenteve blegtorale, klinikave dhe farmacive veterinarë, stabilimenteve të prodhimit dhe ruajtjes së spermës së kafshëve e të vezëve të fekunduara në lidhje me zbatimin e legjislacionit veterinar;
- m) dezinfektimin e mjeteve të transportit, të përdorura për dërgimin e ngarkesave të kafshëve dhe mbeturinave me origjinë shtazore;
- n) zbatimin e masave karantinore për kafshët dhe produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, në rastet e shpërthimeve të sëmundjeve infektive;
- nj) zbatimin e masave të tjera të përcaktuara, kur kërcënohen shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve;
- o) kryerjen e kontrollit veterinar të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit dhe lëshimin e certifikatës veterinarë, që shoqëron mishin dhe nënproduktet e kafshëve në mjediset e thertoreve. Kriteret dhe kushtet e kontrollit veterinar në mjediset e thertoreve miratohen me urdhër të ministrit;
- p) kryerjen e kontrollin veterinar në tregjet e kafshëve të gjalla e kullota dhe, në varësi të situatës epidemiologjike, ndalimin e përdorimit të tyre;
- q) kontrollin e njësisë të shitjes së kafshëve të shoqërimit e zbukurimit;
- r) mbikëqyrjen, mbledhjen, grumbullimin dhe groposjen e kadavrave të kafshëve;
- rr) marrjen e masave, kur vërehen kundërvajtje administrative, në zbatim të nenit 134 të këtij ligji.

## 2. Veprimtaritë e shërbimit përfshijnë:

- a) identifikimin dhe regjistrimin e fermës e të kafshëve blegtorale dhe lëshimin e certifikatës veterinarë të lëvizjes së kafshëve, sipas rregullores përkatëse;
- b) zbatimin praktik të programeve të profilaksisë shtetërore për sëmundjet në kafshë në një bashki ose njësi administrative të përcaktuar;
- c) zbatimin e masave për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, në vatrat e shpërthimeve.

3. Në rastet e sëmundjeve zoonotike, veterineri zyrtar informon strukturat përkatëse të shëndetit publik dhe institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

4. Veterineri zyrtar kryen veprimtari të tjera në kuadër të planeve të monitorimit të ngarkuara nga ministri.

5. Ministri, me urdhër, miraton formën e protokollit të kontrollit sipas fushave të veprimtarisë së veterinerit zyrtar.”.

## Neni 52

Në nenin 134, në pikën 1.3, në shkronjën “a” shtohet nënndarja “vii” me këtë përmbajtje: “vii. vepron në kundërshtim me nenet 15 e 92 të këtij ligji.”.

## Neni 53

Neni 134/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 134/1  
Procedura e kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 134 të këtij ligji, e ka veterineri zyrtar i kontrollit.
2. Kur veterineri zyrtar kërkon bashkëpunim, për shkak të zbatimit të detyrës së ngarkuar me ligj, ai mbështetet nga Policia e Shtetit dhe strukturat doganore e tatimore.
3. Ekzekutimi i masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.
4. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.
5. Të ardhurat nga vjelja e gjobave derdhen në masën 100 për qind në buxhetin e shtetit.”.

**Neni 54**

Neni 135 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 135  
Shqyrtimi i ankimit të masave administrative

1. Për shqyrtimin e ankimit për masat administrative të marra nga veterineri zyrtar i kontrollit, në ministri ngrihet komisioni për shqyrtimin e masave administrative, në përbërje të të cilit janë 5 anëtarë, tre përfaqësues të ministrisë dhe 2 përfaqësues nga shërbimi veterinar shtetëror rajonal.
2. Procedurat e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të masave administrative, përfshirë përbërjen, kryesimin, sekretariatit, ndryshimin e anëtarëve dhe masën e shpërblimit të tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 55**

Nenin 137 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 137  
Licencimi, anulimi dhe revokimi i veprimtarive

1. Veprimtaritë e kryera për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe të çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake, që parashikohen në këtë ligj, licencohen, anulohen e revokohen sipas kategorive e nënkategorive respektive të fushës II të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Veterineri zyrtar, në rast se gjatë kontrollit vëren se nuk plotësohen kërkesat e këtij ligji ose

konstaton se pas ndëshkimit për shkeljet e përcaktuara në nenet 15, 29, 30, 51, 83, 92, 94 e 96 nuk janë marrë masat korrigjuese brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e inspektimit, i dërgon menjëherë organit që ka dhënë lejen propozimin për marrjen e masave me vendime të ndërmjetme për pezullimin e licencës dhe/ose vendime përfundimtare për revokimin ose anulimin e licencës.”.

### **Neni 56** **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që:

a) brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në nenin 7, pika 2, nenin 47, pika 2, dhe nenin 54, pika 2;

b) brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në nenin 24, pika 2, dhe nenin 45.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për veterinarinë që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 1; 12, pika 2; 13, pikat 1 dhe 2; 16, pika 2; 23, pika 2; 25, pika 2; 27, 28, pika 3; 33, pika 1; 34, pikat 6 dhe 8; 38, pika 2; 39, 41, 51, pika 1, shkronja “o” dhe pika 5.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për veterinarinë dhe ministri përgjegjës për financat që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin e përbashkët nënligjor në zbatim të nenit 7, pika 3.

### **Neni 57** **Dispozita kalimtare**

Deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kompetent dhe shërbimit veterinar rajonal, detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore ushtrohen nga strukturat aktuale të ministrisë përgjegjëse për veterinarinë dhe vetëqeverisjen vendore.

### **Neni 58** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**  
**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 4.6.2020